



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”**

**TIRANË, PRILL 2021**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

**PËRMBAJTJA:**

<b>Nr.</b>	<b>Titulli</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMbledhje Ekzekutive</b>	<b>3-11</b>
<b>Ia</b>	Përshkrim i shkurtër i Projektraportit të Auditimit	<b>3-3</b>
<b>Ib</b>	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	<b>3-7</b>
<b>Ic</b>	Opinionit i auditimit	<b>7-11</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>12-16</b>
<b>1</b>	Objektivat dhe qëllimi	<b>12-12</b>
<b>2</b>	Identifikimi i çështjes	<b>12-13</b>
<b>3</b>	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	<b>13-13</b>
<b>4</b>	Përgjegjësitë e audituesve	<b>13-13</b>
<b>5</b>	Kriteret e vlerësimit	<b>13-14</b>
<b>6</b>	Standardet e auditimit	<b>14-15</b>
<b>7</b>	Metodat e auditimit	<b>15-16</b>
<b>8</b>	Dokumentimi i auditimit	<b>16-16</b>
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>17-121</b>
<b>1</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim</b>	<b>17-18</b>
<b>2</b>	<b>Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit</b>	<b>18-121</b>
<b>2.1</b>	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.	<b>18-21</b>
<b>2.2</b>	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.	<b>21-45</b>
<b>2.3</b>	<u>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë,</u> bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar (për pasqyrat financiare të vitit 2018), ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (për pasqyrat financiare të vitit 2019), si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.	<b>45-61</b>
<b>2.4</b>	Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.	<b>61-115</b>
<b>2.5</b>	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	<b>115-120</b>
<b>2.6</b>	Të tjera	<b>121-121</b>
<b>IV</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>122-144</b>
<b>V</b>	<b>ANEKSE</b>	<b>145-163</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

**I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektraportit të Auditimit:**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Këlcyrë, në bazë të Programit të Auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 612/4 datë 13.07.2020, me afat auditimi deri në datën 18.09.2020, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Këlcyrë. Projektraporti i Auditimit u hartua bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, Akt Verifikimet, vërejtjet e bëra nga subjekti “Bashkia Këlcyrë”, etj., sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 612/5, datë 17.11.2020, si dhe është konfirmuar njohja e tij nga subjekti i audituar, me shkresën përcjellëse nr. 3152, datë 15.12.2020, protokolluar në KLSH me nr.612/6, datë 17.12.2020.

**I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:**

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nuk është vepruar në përputhje me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr.170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar kapitulli II, kapitullit III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II pika 1, germa b dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa shtresa dhe ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015”, pasi ka mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnice, Sukë dhe Ballaban), <b>nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 11,000,000 lekë.</b>	<b>Pika 2.2</b> <b>Faqe</b> <b>21-45</b>	<b>E lartë</b>	Bashkia Këlcyrë, të marrë masa <b>për arkëtimin e detyrimit prej 11,000,000 lekë</b> , për 4 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pajisur me autorizim/licencë për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë: -Subjekti D.O., për vlerën prej 2,200,000 lekë. -Subjekti E. SHPK, për vlerën prej 4,400,000 lekë. -Subjekti D.P., për vlerën prej 3,300,000 lekë. -Subjekti A.C. SHPK, për vlerën prej 1,100,000 lekë.
2	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, me vlerë të kontratës (me TVSH) 34,858,247 lekë dhe kontraktor subjektin “J.” SHPK, rezultuan	<b>Pika 2.4</b> <b>Faqe</b> <b>61-115</b>	<b>E lartë</b>	Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>1,951,600 lekë pa TVSH</b> , nga kontraktori “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr. 1046, datë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

	<p>diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,951,600 lekë pa TVSH, në zërat “FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë, çmimi”, “Shtresë asfaltobetoni”, “Spërkatje me emulsion bituminoz 1 lt/m<sup>2</sup>”, “Shtresë stabilizanti t=10 cm”, “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm”, “Pllaka guri 40 x 40 cm ranor dhe gëlqeror për rrugë t=6-10 cm, çmimi”, “Gërmim dheu me krahë, kat IV, çmimi” dhe “Shtresë rëre nën dhe mbi tubacione”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1046, datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “J” SHPK.</p>			<p>07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, vlerë e cila përfaqëson, dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
3	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 27,384,647 lekë, me kontraktor “H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,280,596 lekë pa TVSH në zërat e punës “Gërmim kanali tokë e zakonshme” dhe “Beton C16/20 veshje kanal betoni”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1447, datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “H” SHPK.</p>	<b>Pika 2.4 Faqe 61-115</b>	<b>E lartë</b>	<p>Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>1,280,596 lekë pa TVSH</b> nga kontraktori “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
4	<p>Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, nuk janë aplikuar tarifat për kantier ndërtimi dhe pastrimi për 9 subjekte ndërtimi, sipas Tabelës anekse nr.2.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”, në vlerën totale prej 1,615,000 lekë. Vlera prej <b>1,165,000 lekë</b>, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave për kantier ndërtimi dhe tarifë pastrimi, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.</p>	<b>Pika 2.2 Faqe 21-45</b>	<b>E lartë</b>	<p>Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e shumës prej <b>1,165,000 lekë</b> si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifat e pastrimit për 9 subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë.</p>
5	<p>Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2019, detyrimet ndaj Bashkisë Këlcyrë, janë në vlerën gjithsej <b>60,386,981 lekë</b>. Kjo gjendje debitore është krijuar nga <b>220</b> subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për vlerën <b>22,853,022 lekë</b>, (e pa kontabilizuar), dhe <b>3,360</b> familje për detyrime të pa përlllogaritura për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej <b>37,533,959 lekë</b>. Nga krahasimi i të dhënave midis vlerës së detyrimeve të pashlyera sipas të dhënave që disponon</p>	<b>Pika 2.2 Faqe 21-45</b>	<b>E mesme</b>	<p>Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë të marrë masat për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, <b>për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 220 subjekte për vlerën 22,853,022 lekë dhe 3,360 familje për vlerën gjithsej 37,533,959 lekë</b>, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar,</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

<p>Sektori i Tatim Taksave vendore, me vlerën që paraqet Sektori i Financës në pasqyrat financiare, (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”) nuk paraqet vlerën reale të detyrimeve. Sipas bilancit të vitit 2018, detyrimet janë në shumën 6,078,000 lekë, e pandryshuar edhe në bilancin e vitit 2019, dhe sipas përlllogaritjeve të bëra nga Grupi i Auditimit referuar të dhënave të marra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, gjendja reale e debitorëve është në vlerën prej 60,386,981 lekë, pra konstatohet një diferencë e dukshme në vlerën prej <b>54,308,981 lekë, vlerë kjo e cila është e pa kontabilizuar.</b></p> <p>-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për 48 bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.</p> <p>-Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 220 subjekte debitorë (fizik/juridik) në vlerën <b>22,853,022 lekë</b>, janë aktiv 172 subjekte ose 78% e totalit të debitorëve të evidentuar, të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa.</p> <p>Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe <b>asnjë procedurë tjetër</b>, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezultoi në dështuar, sidomos për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.</p>			<p>duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare;</li><li>- Ti dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);</li><li>- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;</li><li>- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</li></ul>
<p><b>6</b> Nga auditimi rezultoi se, në <b>6 procedura</b>, sipas Tabelës anekse nr. 4.5 “Efektet financiare”, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në kundërshtim me aktet rregullative, është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomicitet dhe efikasitet, në shumën <b>23,967,868 lekë</b>. Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të Operatorëve Ekonomikë (OE) të shpallur fitues, në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014</p>	<p><b>Pika 5 Faqe 61-115</b></p>	<p><b>E lartë</b></p>	<p>Autoriteti Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e “Kritereve të veçanta për kualifikim”, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kritereve të vendosura në DT.</p>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

	<p>“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. OE, janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DT, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i AK, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kontratës, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT. Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar efekt negativ, përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe efijçencë i fondeve publike.</p>			
7	<p>Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për dy vitet 2018 dhe 2019, është në shumën 4,950,000 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 1,417,000 lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, planifikimi për vitet 2018 dhe 2019 duhej të ishte në shumën 10,854,000 lekë dhe për vitin 2020 duhej të ishte në shumën 5,904,500 lekë. Sa më sipër, rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, është planifikuar më pak e ardhura nga këto taksa e tarifa për vlerën 9,914,750 lekë, në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.</p>	<p><b>Pika 2.2</b> <b>Faqe</b> <b>21-45</b></p>	<p><b>E lartë</b></p>	<p>Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej <b>9,914,750 lekë</b>, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.</p>
8	<p>Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në RPA, nga Zyra e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet jo në mënyrën e duhur dhe llogarinë e duhur, kryesisht:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Në mënyrë të gabuar shpenzimet e kryera për investime dhe që rezultojnë në proces (llog. 23), janë kontabilizuar në llog. në llog.21, duke i konsideruar ato si shpenzime të përfunduara, të marra në dorëzim dhe të kapitalizuara. Efektet janë në shumën 157,122,726 lekë për vitin 2018 dhe 66,600,470 lekë për vitin 2019.</li><li>- Për vitet 2018 dhe 2019 nuk janë përfshirë në inventarizim llogaritë: 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215, si dhe për këto llogari nuk ekziston një regjistër kontabël, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.</li><li>- Nuk është përfshirë në kontabilitet vlera e aksioneve që zotëron në Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë, për</li></ul>	<p><b>Pika 2.3</b> <b>Faqe</b> <b>45-61</b></p>	<p><b>E lartë</b></p>	<p>Për shkeljet e konstatuara është lënë rekomandim që me mbylljen e bilancit kontabël të vitit pasardhës (viti 2020), nga ana e Zyrës së Financës së Bashkisë Këlcyre, të bëhen sistemimet kontabël, për çdo rast të evidentuar në mënyrë analitike në PRA.</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

<p>vlerën 21,259,000 lekë.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Nuk është pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlera prej 53,051,426 lekë për vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019.</li><li>- Nuk janë pasqyruar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, vlera prej 69,955,690 lekë për vitin 2018 dhe vlera prej 237,523,073 lekë, si detyrime të shtetit kundrejt subjektit, për anagazhime buxhetore të ndërmarra gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, me kundërparti llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti.”</li><li>- Nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për vlerën 6,052,070 lekë për vitin 2018 dhe 4,335,775 lekë për vitin 2019 në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, etj.</li></ul>			
--	--	--	--

#### I.c. Opinioni i auditimit.

##### Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

###### **Për drejtimin e Bashkisë Këlcyrë.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Këlcyrë, për vitin ushtrimor 2018 dhe 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

###### **Opinion i modifikuar, i kundërt<sup>1</sup>:**

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705<sup>2</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>3</sup>, pasqyrat financiare, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të Bashkisë Këlcyrë, në datën 31 dhjetor 2019, referuar Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, pasi mbartin gabime materiale dhe të përhapura, të cilat janë trajtuar në Bazën për opinionin e kundërt.

###### **Baza për opinionin e modifikuar, të kundërt:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Këlcyre, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e

<sup>1</sup> **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

<sup>2</sup> Objektiv i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raportit të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>3</sup> Objektiv i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA-700/ISSAI-1700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2019 (materialiteti 497,038 lekë), dhe janë gabime materiale të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të kundërt (ISA-705/ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

#### **Përshkrimi i çështjeve:**

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Zyra e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

- Në mënyrë të gabuar shpenzimet e kryera për investime dhe që rezultojnë në proces (llog. 23), janë kontabilizuar në llog. në llog.21, duke i konsideruar ato si shpenzime të përfunduara, të marra në dorëzim dhe të kapitalizuara. Efektet në vitin 2018 janë në shumën 157,122,726 lekë dhe në vitin 2019 në shumën 66,600,470 lekë.
- Për vitet 2018 dhe 2019, nuk janë përfshirë në inventarizim llogaritë: 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215, si dhe për këto llogari nuk ekziston një regjistër kontabël, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.
- Nuk është përfshirë në kontabilitet, llogaria 26, vlera e aksioneve që zotëron në Ujësjellës Kanalizime SHA Këlcyrë, për vlerën 21,259,000 lekë.
- Nuk është pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlera prej 53,051,426 lekë për vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019.
- Nuk janë pasqyruar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, vlera prej 69,955,690 lekë për vitin 2018 dhe vlera prej 237,523,073 lekë, si detyrime të shtetit kundrejt subjektit, për angazhime buxhetore të ndërmarra gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, me kundër parti llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti.”
- Nuk janë pasqyruar detyrimet e prapambetura për vlerën 6,052,070 lekë për vitin 2018 dhe 4,335,775 lekë për vitin 2019 në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, rezultat i të cilave është dhe deklarimi i pasaktë i detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Këlcyrë.**

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Këlcyrë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me aktet ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

#### **Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë:**

##### **Për drejtimin e Bashkisë Këlcyrë.**

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara, si dhe zbatimin e kontratave të realizuara, gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2019-30.06.2020. Kemi vlerësuar zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore, mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit e në veçanti planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të veta, kemi vlerësuar zbatimin e strukturës së pagave dhe nivelin e pagave referuar akteve rregullative, si dhe kemi vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit brendshëm dhe auditit të brendshëm, për periudhën objekt auditimi.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave nga ana e subjektit. Në auditimin e prokurimeve me fonde publike, zbatimin e procedurave ligjore në planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit në tërësi dhe të ardhurave të veta të njësisë në veçanti, në zbatimin e strukturës dhe nivelit të pagave, ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi.

##### **Opinion i modifikuar, i kundërt<sup>4</sup>:**

Sipas mendimit tonë, ne kemi marrë siguri të arsyeshme, për të dhënë opinion, se veprimtaria e subjektit të audituar, nuk është zhvilluar në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative, pasi gabimet dhe shkeljet e evidentuara, rezultojnë të jenë materiale dhe të përhapura, në të gjitha drejtimet e audituara, duke shërbyer kështu si bazë për dhënien e një opinionit të kundërt.

##### **Baza për opinion e modifikuar, të kundërt:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>5</sup> për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Bashkia Këlcyrë, nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit në prokurimin e fondeve publike. Shkeljet e evidentuara janë të përhapura pothuajse në të gjithë popullatën dhe kampionin e testuar.

Nga 9 procedura të kryera për periudhën objekt auditimi, u audituan 8 prej tyre dhe rezultuan mangësi dhe shkelje, në 6 procedura prokurimi. Si rezultat i veprimeve në kundërshtim me kriteret e vlerësimit (Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Udhëzime dhe Urdhra të APP-së), pra veprimeve joligjore të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është shkaktuar përdorim pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet e fondeve publike në shumën **23,967,868 lekë** dhe dëm ekonomik në shumën **353,600 lekë**, ndërsa nga auditimi i zbatimit të kontratave, është evidentuar dëm ekonomik, në shumën **3,823,459 lekë**. Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale dhe të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

##### **Përshkrimi i çështjeve:**

*Mbi zhvillimin e procedurave dhe vlerësimin e OE.*

- Nga auditimi rezultoi se, në 6 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit në shumën 156,014,634 lekë, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga KVO, në kundërshtim me aktet

<sup>4</sup> **Opinion i modifikuar, i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, dhe të përhapura.

<sup>5</sup> ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: "Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme"



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

rregullative, pra në mënyrë joligjore, është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficencë, në shumën **23,967,868 lekë dhe dëm ekonomik në shumën 353,600 lekë**. Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të OE të shpallur fitues, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 24, 46 dhe 53 dhe VKM nr. 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" datë 29.12.2014, neni 66. Diferenca midis Operatorit Ekonomik (OE) me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, **në kushtet e paligjshmërisë**, ku asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar efekt negativ, përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe eficencë i fondeve publike.

- Nga ana e KVO-së, është vepruar më dy standarde për vlerësimin e OE. Nga auditimi u evidentuan 5 raste, ku nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për të njëjtin kriter të përmbushur apo jo, janë mbajtur qëndrim të ndryshme, për OE të ndryshëm, pjesëmarrës në garë.

*Mbi zbatimin e kontratave për punë publike:*

- Nga auditimi me zgjedhje i zbatimit të punimeve, për tre kontrata të përfunduara, me vlerë 98,596,211 lekë me TVSH, u evidentuan shkelje të cilat janë shoqëruar me shkaktim të **dëmit ekonomik në vlerën 3,823,459 lekë pa TVSH**. Kjo si rezultat i likuidimit të punimeve, të cilat sipas matjeve dhe vlerësimit në terren, nuk ishin realizuar në masën e duhur.

*Mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe auditit të brendshëm:*

- Në Bashkinë Këlcyrë, nuk ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm, nuk ka njohuri mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe nuk ka funksionuar struktura e auditit të brendshëm, në kundërshtim me ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjin “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”. Kjo është pasqyruar në mungesën e strategjisë dhe regjistrin të riskut, mungesës së aktiviteteve të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre, në mungesën e rregullave, udhëzimeve apo urdhrave për rregullimin e aktiviteteve kryesore të veprimtarisë së subjektit, mungesë e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, etj.

*Mbi respektimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave:*

- Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit, si dhe pozicioni i auditit të brendshëm, ka rezultuar të jenë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune;
- Bashkia Këlcyrë, nuk ka miratuar në strukturë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, strukturë kjo e rëndësishme për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve;
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se në të gjitha rastet e testuara, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës;
- Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione për Nëpunës Civil, dhe rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin. Është respektuar niveli i pagave, sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

*Mbi planifikimin, zbatimin e planit të buxhetit dhe realizimin e të ardhurave:*

- Nga Bashkia Këlcyrë nuk është vepruar në përputhje me aktet ligjore në procesin e planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të planit të buxhetit.
- Nga auditimi është evidentuar realizim i ulët i të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana e Bashkisë Këlcyrë, gjë e cila flet për punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre. Mosarkëtimi i të ardhurave, ka sjellë si pasojë që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018 dhe në buxhetin e vitit 2019, të mbeten pa burim financimi, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin
- Nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nuk është vepruar në përputhje me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr.170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar kapitulli II, kapitullit III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II pika 1, germa b dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa shtresa dhe ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015”, pasi ka mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnice, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 11,000,000 lekë**, vlerë e cila konsiderohet e dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

- Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën për ngritje kantier ndërtimi (investime publike), tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit deri në 5 milionë lekë, tarifë për ngritje kantier ndërtimi tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit mbi 5 milionë lekë, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Njësitë Administrative në vartësi. Nga përllogaritjet e kryera rezultoi se nuk janë aplikuar tarifatat për kantier ndërtimi dhe pastrimi për 9 subjekte ndërtimi, sipas Tabelës anekse nr.2.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”, në vlerën totale prej 1,615,000 lekë. Vlera prej **1,165,000 lekë**, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave për kantier ndërtimi dhe tarifë pastrimi, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Këlcyrë:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Këlcyrë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Këlcyrë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktivitetëve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>6</sup>, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

<sup>6</sup> ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomalitë materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 612/4, datë 13.07.2020 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.07.2020 deri në datë 18.09.2020 në subjektin Bashkia Këlcyrë për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2018 deri ne 30.06.2020 u krye auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë nga **Grupi i Auditimit me përbërje:**

- Brunilda Zeneli, Përgjegjës Grupi
- Albert Hoxhalli, Auditues
- Enea Caushaj, Auditues
- Shkëlzen Hoxha
- Alush Zaçe

**Titulli:** Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

**Marrësi:** Bashkia Këlcyrë

### **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA:**

#### **Objektivat dhe qëllimi.**

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimi që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2018, 2019 dhe 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt, me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2018 deri në datë 30.06.2020, si dhe do të ketë si fushëveprimi zbatimin e rekomandimeve, auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm si dhe procedurat e prokurimit me fonde publike të zhvilluara gjatë periudhës së veprimtarisë nën auditim.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 612/4, datë 13.07.2020, si më poshtë:

- Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar (për pasqyrat financiare të vitit 2018), ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (për pasqyrat financiare të vitit 2019), si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.
- Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

#### Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. (Trajtuar në Opinionin e auditimit)

#### Përgjegjësitë e audituesve. (Trajtuar në Opinionin e auditimit)

#### Kriteret e vlerësimit.

- Standardet e Auditimit:
  - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
  - Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
  - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
  - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
  - Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
  - Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
  - Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Akte ligjore:
  - Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
  - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
  - Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
  - Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me ndryshime;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.
- Akte nënligjore
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;
- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar;
- VKM nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, Institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit", i ndryshuar;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, etj.
- Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore
- Udhëzimi MF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi MF nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj.
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH<sup>së</sup>”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Këlcyrë, etj.

**Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.** Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

#### **ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”**

Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit:

- Grupi i auditimit, ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;
- Grupi i auditimit, në mënyrë individuale dhe kolektive ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Grupi i punës, është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për t’u siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

#### **ISSA 130 “Kodin Etik”**

Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar:

- Integritet.
- Pavarësi, objektivitet, paanshmëri.
- Ruajtjen e sekretit profesional.
- Kompetencat dhe kujdesin e duhur.
- Sjelljen profesionale.

#### **ISSAI 1315 “Risku”**

Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ( $RA=RB \cdot RKB \cdot RMZ$ ), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;
- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;
- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- U përcaktua e rreziku i mos zbulimit;
- U aplikua Modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

#### **ISSAI 1320-1450 “Materialiteti”**

Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar si sasior, po ashtu edhe cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

#### **ISSAI 1500 “Dokumentimi”**

Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit
- Rëndësia e evidencës së auditimit
- Burimet e evidencës së auditimit
- Llojet e evidencës së auditimit, etj.

#### **Metodat e auditimit.**

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, koston dhe efikasitetin së auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësisia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA).

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista me shkrim dhe verbale, ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, konkretisht 5 komponentët përbërës si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi, nuk kanë funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe janë konsideruar me risk të lartë, për këtë arsye:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë (përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik (zona e llogarisë 23), u gjykua që të kryhen teste thelbësore (të detajeve) për të gjitha procedurat e auditimit të kryera nga subjekti në periudhën objekt auditimi.  
Përzgjedhja e metodës u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Meqenëse RA u vlerësua i lartë, numri i transaksioneve ishte i kufizuar (8 procedura për dy vite) por që përfaqësojnë vlerë të lartë monetare (në shumën 391 milionë lekë) u gjykua që të testohen 100 % e procedurave. Kjo mbështetur në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, pika 5.7 “Marrja e kampioneve dhe mjete të tjera që përdoren për të përzgjedhur elementet/artikujt që do të testohen”, ku cilësohet se: *“Përzgjedhja e 100% të artikujve është e përshtatshme në ato raste kur, ka numër të vogël artikujsh në vlerë të madhe dhe kur risku është i lartë. Kjo metodë është më e përshtatshme në rastet e përzgjedhjes së testeve thelbësore (të detajeve) se sa në testet e kontrolleve”.*
- Për të ardhurat, janë përdorur teste thelbësore (substanciale), duke u nisur nga vlerësimi paraprak që ka treguar se kontrollat dhe sistemet e kontrolleve të brendshme të subjektit janë të dobëta dhe nuk funksionojnë (trajtuar më hollësisht te letrat e punës).  
Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimin të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, teknikat e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.  
Testet e detajeve, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, për të marrë evidencë auditimi për pohimet (ekzistenca e një ngjarje ekonomike, ligjshmëria dhe vlerësimi i saj).
- Për pasqyrat nën gjykimin profesional të audituesit, është përcaktuar pragu i materialitetit, sipër të cilit janë testuar llogaritë kontabël, si dhe është përcaktuar materialiteti sasior, bazuar në Manualin e auditimit financiar, me metodën e përqindjes mbi shpenzimet korente dhe kapitale, dhe përkatësisht në vlerën 413,717 lekë për vitin 2018 dhe 497,038 lekë për vitin 2019. Përsa i përket, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së shpenzimeve dhe transaksioneve të kryera, bazuar në analizën e RA, i cili është konsideruar i lartë, për zonën e llogarive 23, është kryer auditim i plotë, për shkak të vlerës së lartë dhe transaksioneve të kufizuara. Ndërkohë u audituan me zgjedhje, veprimtaritë dhe ngjarjet e tjera ekonomike, të cilat sipas gjykimit profesional të audituesit rezultojnë me risk më të ulët.

**Dokumentimi i auditimit,** është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

## III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

### 1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Bashkia Këlcyrë, është Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, e cila ka në përbërje të saj 4 Njësi Administrative: Këlcyrë, Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 304 km<sup>2</sup> dhe ka një popullsi sipas Regjistrit të Gjendjes Civile prej 12,537 banorë.

#### Bashkia Këlcyrë



#### Njësitë administrative, qytetet dhe fshatrat

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë Administrative	Qyteti dhe fshtrat nën juridiksionin e Bashkisë Këlcyrë
Gjirokastrë	Këlcyrë	Këlcyrë	Qyteti Këlcyrë, Fshatrat: Fshat Këlcyrë, Mbrezhdan, Maleshovë, Limar, Leskaj
		Ballaban	Fshatrat: Ballaban, Vinokash, Vinokash Fushë, Komarak, Mazhar, Kondas, Psar, Ball, Kajcë, Pavar, Toshkëz, Bubës 1, Bubës 2, Beqaraj
		Sukë	Fshatrat: Sukë, Goricë, Fshat i Ri, Rodenjë, Podgoran, Podgoran Fushë, Ujmirë, Zhepovë, Shelq, Topojan, Luar, Delilaj, Çorogunj, Taroninë
		Dishnicë	Fshatrat: Beduqas, Tolar, Panarit, Riban, Varibop, Kuqar, Mërtinjë, Xhanaj, Bënjë, Fratar, Senican, Katundishtë, Leskovec, Gërdas, Kodrishtë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, etj. Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga 15 anëtarë;

Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë;

Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njësive Administrative;

#### **Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Këlcyrë fokusohen kryesisht në:**

- Shërbimin publik;
- Shërbimin social;
- Shërbimin kulturor dhe sportet;
- Biznesin.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.*

*Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.*

## **2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:**

### **1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.**

#### **1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.**

#### **1.2. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi.**

#### **1.2. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.**

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se edhe pse është hartuar rregullore e brendshme, nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si regjistri i riskut, gjurma e auditimit, harta e proceseve etj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**Titulli i Gjetjes 1: Mungesa e një kuadri të plote rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit, mos ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik, Mungesa e strategjisë për menaxhimin e riskut, Mungesa e rregullores si dhe mangësitë ne rekrutimin e punonjësve.**

**Situata:**

1. Në Bashkinë Këlcyrë nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe ka mangësi të plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

2. Institucioni për vitet 2018-2019 ka operuar pa rregullore të miratuar, dhe për vitin 2020 ka paraqitur dokumentin me nr. 359, datë 19.02.2020 “Rregullore të detyrave dhe përgjegjësive të strukturave të Bashkisë Këlcyrë për vitin 2020”.

3. Nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2018, 2019 dhe 2020 edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.

4. Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së *Përgjegjësit të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit*, ky pozicion rezulton të jetë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune.

5. Bashkia Këlcyrë, nuk ka miratuar në strukturë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, strukturë kjo e rëndësishme për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve, por edhe për mbrojtjen e territorit duke qenë se pranë këtij qyteti shtrihet edhe lugina e lumit Vjosë.

6. Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

7. Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, Ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

8. Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se në të gjitha rastet e testuara, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës.

9. Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione për Nëpunës Civil, dhe rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin.

**Kriteri:**

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 pika 8/b “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”, neni 21 pika 2 “Menaxhimi i riskut”, neni 22 pika 1 “Veprimtaritë e kontrollit”

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.1/b dhe neni 64 germa (a) dhe (j);

Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, neni 4.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 2 dhe 19.

VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura”, i ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mos plotësimi i strukturës me personelin e duhur, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, sjell risk të lartë për institucionin.

**Shkaku:** Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandim:**

- Bashkia Këlcyrë, të hartojë një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante si: Përgjegjës i zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pozicionin e Juristit të njësisë, si pozicione të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit në mënyrë ligjore.
- Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme.
- Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e gjitha dosjeve të punonjësve me kontratën individuale të punës, konform përcaktimeve të “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë”.
- Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për punonjësit, pozicionet e të cilëve janë të evidentuar si punonjës, duhet të rregullohet me statusin e nëpunësit civil, të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, si dhe për çdo rekrutim të ri për këto lloj pozicioneve, të zbatohen procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N., në cilësinë e Titullarit të institucionit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### **1.4/5 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm, vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

#### **Titulli i Gjetjes 2: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.**

<b>Situata:</b>	<p>Bashkia Këlcyrë, ka miratuar në strukturën organike të saj me vendimin nr. 16, datë 13.02.2018, në strukturën organike me vendimi nr. 1, datë 03.01.2019 si dhe strukturën organike me vendimin nr. 9, datë 24.01.2020 të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, ku është përcaktuar një pozicion pune për Auditues të Brendshëm të Njësisë me emërtesën Specialist i lartë Audit i Brendshëm. Pavarësisht miratimit në strukturë të këtij pozicioni pune, për vitet objekt auditimi, nuk është rekrutuar asnjë punonjës, me argumentimin për mungesë burimesh njerëzore. Megjithatë, nuk u paraqit asnjë dokumentacion i cili të provojë se nga ana e Institucionit, të jetë shpallur vend vakant për rekrutimin e punonjësve për pozicionin e punës së audituesit të brendshëm</p> <p>Titullari i institucionit, në mungesë të Njësisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka lidhur marrëveshje me njësi tjera publike të cilat kanë njësi auditit të brendshëm, si dhe kapacitete të nevojshme për kryerjen e auditit të brendshëm në sektorin publik. Sa më sipër:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Bashkia Këlcyrë, nuk ka strukturë funksionale për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm, edhe pse është parashikuar ngritja e saj në strukturën organizative të njësisë.</li><li>2. Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, në mungesë të strukturës funksionale të auditit të brendshëm, nuk ka marrë masa për të lidhur marrëveshje me njësi tjera publike që kanë audit të brendshëm, për të realizuar kryerjen e shërbimit të auditimit të njësisë.</li></ol>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10 germa (a) dhe (c). VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, neni 6 germa (a).</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Sistem jo funksional i kontrollit të brendshëm, duke mos dhënë siguri titullarit për aktivitetet kryesore të veprimtarisë së institucionit.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mosnjohje e ligjit nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik. Mos shpallja e vakancës për vendin e punës së audituesit të brendshëm.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E lartë</p>
<b>Rekomandim:</b>	<p>Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.</p>

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 1 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 5 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/5, datë 18.09.2020 dhe Aktkonstatimi nr. 6, datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/6, datë 18.09.2020, si dhe është trajtuar në PRA faqe 9-12. Nga subjekti nuk**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.

**2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.**

**2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2018, 2019 dhe 2020.**

Tabela nr. 2.1.1. “Plani i buxhetit 2018-2020” në 000/lekë

Nr	Emertimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Plani i vitit 2018		Plani i vitit 2019		Plani i vitit 2020	
		Të ardhurat	Shpenzimet	Të ardhurat	Shpenzimet	Të ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga viti parardhës	2,110		2,416		552	
2	Transferte e pakushtëzuar trashëguar viti parardhës	66,622		35,640		11,220	
3	Transferta specifike (Fonde)	44,177		44,913		45,099	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	19,386		20,047		23,438	
5	Granti nga FZHR dhe Ministri Linje						
6	Transferte e pakushtëzuar e vitit ushtrimor	57,955		58,984		60,191	
7	Paga (600)		76,023		82,175		80,725
8	Sigurime shoqërore (601)		13,435		13,900		13,736
9	Shpenzime operative (602)		33,122		37,255		33,019
10	Transferta (604) Fondi rezervë		1,420		1,420		3,020
11	Investime (230 ; 231) nga ardhurat e transf e pakushtëzuar		66,250		27,250		10,000
12	Investime nga FZHR dhe M.Linje						
	<b>TOTALI</b>	<b>190,250</b>	<b>190,250</b>	<b>162,000</b>	<b>162,000</b>	<b>140,500</b>	<b>140,500</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë

Punoi: KLSH

**Nga auditimi u kostuan mangësitë e mëposhtme:**

**Titulli i gjetjes 1:** Në Bashkinë Këlcyrë u konstatuan parregullsi të dukshme në hartimin dhe miratimin e programeve buxhetore afatmesëm (PBA) për vitet 2018-2020, 2019-2021 dhe 2020-2022

**Situata:** **Programimi i PBA 2018-2020**

-Nga ana e Titullarit të Institucionit nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS);

-Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda muajit dhjetor 2017;

-Nga Kryetari i Bashkisë nuk është paraqitur për shqyrtim dhe miratim raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda datës 15 Mars (të vitit paraardhës);

-Nuk janë miratuar nga Këshilli Bashkiak vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve;

-Nuk janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile;

-Nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2017, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumenti i programit buxhetor afatmesëm (PBA);

-Nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (të vitit paraardhës);



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

-Nga Njësitë shpenzuese të Bashkisë nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore të rishikuara si dhe Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashkinë Këlcyrë nuk ka kryer analizat e kërkesave buxhetore;

-Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak programi buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor brenda datës 25 dhjetor (të vitit paraardhës).

#### **Programimi i PBA 2019-2021**

-Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë tavanet buxhetore brenda datës 15 mars si dhe raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars;

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor 2018;

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve;

-Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës).

#### **Programimi i PBA 2020-2022**

-Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë tavanet buxhetore brenda datës 15 mars si dhe raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave jo më vonë se data 1 mars;

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor 2019;

-Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve;

-Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës).

#### **Kriteri:**

- Ligji nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”:

#### **Neni 33 ku cilësohet:**

*“ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.*

**Neni 34 ku cilësohet:** *Pika 1. Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore..”.*

**Neni 35 ku cilësohet:** *Pika 1. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.*

**Neni 36 ku cilësohet:** *Pika 4. Programi buxhetor afatmesëm vendor përfshin informacionin për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore për: a) secilën kategori të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore ;b)*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*shpenzimet sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik për çdo program buxhetor; c) qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore; ç) vlerësimin e kostove të politikave aktuale dhe atyre të reja, të planifikuara për financim nëpërmjet shpenzimeve buxhetore vendore vjetore dhe afatmesme; d) informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe niveli i përmbushjes së tyre.*

*Pika 5. Brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm.*

*Neni 37 ku cilësohet: Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.”*

*-Udhëzimi nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, shtojca 5 e udhëzimit ku cilësohet: Gjurma e Auditit për procedurat e përgatitjes së PBA (njësitë e qeverisjes së përgjithshme).*

*-Udhëzimi nr.22, datë 30.07.2017 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”, shtojca 1 e udhëzimit ku cilësohen: “Afatet kohore për monitorimin e buxhetit”.*

*-Udhëzimi nr.6/3, datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”*

*-Udhëzimi nr.7, datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, kapitulli 1 ku cilësohet: Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, shtojca 4 “Grupi për menaxhimin strategjik, ekipi i menaxhimit të programeve”, shtojca 5 “Pema e programit dhe roli i saj në mbështetje të rishikimit të politikave të programit dhe planifikimin e shpenzimeve të programit”.*

**Impakti:** Në hartimin dhe planifikimin e programeve buxhetore afatmesëm, treguesve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, i udhëzimeve për hartimin e programeve buxhetore afatmesëm, mos funksionimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesa e organizmit të grupeve të punës dhe ndarjes së detyrave, mungesa e një kalendari për funksionimin e programit buxhetor afatmesëm.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa të menjëhershme, për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik, për zbatimin e të gjitha procedurave për programimin e buxheteve vjetore dhe afat mesme, duke krijuar grupet e punës sipas projekteve të financimit, si dhe të zbatohet kalendari i programimit të buxhetit sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- 1.Z.K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë si Nëpunës Autorizues
- 2.Znj.V.K., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit
- 3.Znj.A.S., specialiste e lartë Inspektor Financë dhe Buxheti

**Titulli i gjetjes 2:** Në Bashkinë Këlcyrë u konstatua se, ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të veta.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, buxheti viteve 2018 e 2019 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesat të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

- Buxheti vjetor 2018, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 26.01.2018 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, me shkresën nr. 339/1, datë 06.02.2018

- Buxheti vjetor 2019, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 04.01.2019 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, me shkresë nr. 21/1, datë 17.01.2019.

Tabela 2.1.2. Realizimi i shpenzimeve dhe të ardhurave të veta.

Viti	Të ardhura të veta-000/lekë				Shpenzimet buxhetore-000/lekë			
	Plan	Fakt	Diferenca	%	Plan	Fakt	Diferenca	%
2018	19,386	13,115	-6,271	67	394,861	363,438	-31,423	92
2019	20,047	10,290	-9,757	51	378,868	356,362	-22,506	94

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, gjë e cila ka ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë.

**Kriteri:** -Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr.10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr.10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

**Impakti:** Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, krijohen premisa për marrjen e angazhimeve buxhetore, pa patur burime financimi reale.

**Shkaku:** Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

viteve të audituara.

**Rëndësia:**

**E lartë**

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim analizimin dhe evidentimin e faktorëve, që kanë sjellë mos realizim të planit të të ardhurave, si dhe të marrë masa të menjëhershme për koordinimin e punës midis sektorëve, për planifikimin e një buxheti objektiv mbi të ardhurat e veta dhe shpenzimet që financohen prej tyre.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z. K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë si Nëpunës Autorizues
2. Znj. V.K., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit
3. Znj. A.S., specialiste e lartë Inspektor Financë dhe Buxheti

## 2.2. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Tabela nr. 2.2.1 “Realizimi i buxhetit 2018”

Nr	Emertimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Viti 2018		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	78,543	61,985	79%
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	15,721	10,346	66%
3	602 Shpenzime operative	33,122	28,010	85%
4	604+609 Ndihmat ekonomike	2,497	1250	50%
5	606 Shpërblim lindje+ emetgjencë civile	66,550	65,916	99%
6	230 +231 Studime projektme	196,526	194,029	99%
7	466 Mjete në ruajtje	1,697	1,250	74%
	<b>TOTALI</b>	<b>394,861</b>	<b>363,438</b>	<b>92</b>

Tabela nr. 2.2.2 “Realizimi i buxhetit 2019”

Nr	Emertimi i Shpenzimeve/Burimet e fondeve	Viti 2019		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	84,090	75,026	89%
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	14,250	12,505	88%
3	602 Shpenzime operative	38,804	33,591	87%
4	604+609 Ndihmat ekonomike	1,300	0	0
5	606 Shpërblim lindje+ emetgjencë civile	64,581	63,819	99
6	230 +231 Studime projektme	173,616	169,194	97%
7	231 Investime objekte			
8	466 Mjete në ruajtje	2,227	2,227	100%
	<b>TOTALI</b>	<b>378,868</b>	<b>356,362</b>	<b>94%</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Titulli i gjetjes 3: Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitet 2018 dhe 2019, programimi i pagesave për detyrimet e prapambetura, vendimet gjyqësore.**

**Situata:**

**1. Për vitin 2018, shlyerja e detyrimeve të prapambetura, nuk është programuar si zë më vete i tregueseve të buxhetit.**

- Në vitin 2017, është prokuruar objekti: “Rijetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër” me vlerë 148,783,112 lekë me TVSH, me burim financimi nga FZHR, ku



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

likuidimi i këtij investimi në 31.12.2017 paraqitet në vlerën 37,227,210 lekë dhe likuidimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën prej 107,222,064 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin 2018 dhe 2019 është në vlerën prej 4,333,838 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.

- Në vitin 2018, është prokuruar objekti: “Rikonstruksion i urës në qendër të qytetit Këlcyrë” me vlerën 4,943,420 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku likuidimi i këtij investimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,240,550 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin ushtrimor 2018 është në vlerën prej 1,702,870 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.
- Në vitin 2018 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë, me nr. ekzekutimi 64 datë 14.11.2018, me vlerë 150,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2019 dhe PBA 2019-2021.
- Në vitin 2019 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë me nr. ekzekutimi 1249 datë 28.10.2019, me vlerë 429,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2020 dhe PBA 2020-2022.
- Gjithashtu, është konstatuar se në vitin 2019, është prokuruar objekti “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit” me vlerë 34,858,247 lekë me TVSH dhe objekti “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran” me vlerë 36,353,317 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e Bashkisë, pa miratuar si objekt në Këshillin e Bashkisë.

#### Kriteri:

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 34 dhe neni 40 cituar më lart.

-Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 ku cilësohet: “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”. Pika 102 ku cilësohet: “Njësitë e qeverisjes vendore, zbatojnë edhe detyrimet financiare që rrjedhin nga vendime gjyqësore e formës së prerë në ngarkim të tyre”.

-Udhëzimi nr. 29, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr. 37 ku citohet: “Titullari është kreu i organit qendror të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.” Pika nr. 38 ku citohet: “Titullari monitoron zbatimin e buxhetit nëpërmjet kërkesës së llogarisë ndaj nëpunësit autorizues, duke vendosur mënyrën e raportimit mbi bazë performance si dhe frekuencën e raportimit.” Neni nr.39 ku citohet: “Titullari merr pjesë aktive në vendimet strategjike të menaxhimit nëpërmjet kryesimit të mbledhjeve periodike të Grupit të Menaxhimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*Strategjik të njësisë së qeverisjes së përgjithshme”.*

- Impakti:** Në hartimin dhe zbatimin e buxheteve vjetore, treguesve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet.
- Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, i udhëzimeve për hartimin e buxheteve vjetore, shkelje e disiplinës financiare mbi detyrimet e prapambetura dhe vendimeve gjyqësore
- Rëndësia:** **E lartë**
- Rekomandimi:**
- Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të buxheteve vjetore, të planifikojë mbulimin me buxhet, së pari për detyrimet e papaguara dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.
  - Gjatë zbatimit të buxheteve vjetore, për investimet që financohen nga të ardhurat e veta të merret paraprakisht miratimi në Këshillin Bashkiak, të zbatohen të gjitha procedurat ligjore bazuar në udhëzimet vjetore dhe standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxheteve vjetore.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z.K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë si Nëpunës Autorizues
2. Znj.V.K., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit
3. Znj.A.S., specialiste e lartë Inspektor Financë dhe Buxheti

#### **Konkluzion:**

Nga auditimi i hartimit të programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujori i parë i vitit 2020, arrijmë në konkluzionin se:

1. Nga auditimi i programimit të buxheteve afatmesëm dhe i procedurave për përgatitjen PBA 2018-2020, 2019-2021 dhe 2020-2022 rezultoi se, nuk janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik ku mungon Urdhri i Titullarit, organizimin dhe mbledhjen e këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.
2. Nuk janë përcaktuar qartë tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve si dhe të jenë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse për investimet nuk janë paraqitur në mënyrë të detajuar, referuar burimeve të financimit, pra cilat janë nga të ardhurat e veta dhe nga transfertat e pakushtëzuar.
3. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet buxhetimit në pjesëmarrje. Buxhetet nuk janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ujësjellësi etj, situatë e cila vërteton se nuk janë marrë në konsideratë nevojat reale dhe ato më prioritare.
4. Në planifikimin e buxheteve nuk janë përcaktuar vlera e detyrimeve të prapambetura për mallra dhe shërbime sipas programeve që do të përballohen me fondet e vitit buxhetor. Peshën më të madhe në buxhet e kanë shpenzimet për investime, të cilat për vitin 2018 paraqiten në vlerën prej 194,029 mijë lekë me 53% të totalit të shpenzimeve dhe për vitin 2019 paraqiten në vlerën prej 169,194 mijë lekë me 47% të totalit të shpenzimeve.
5. Detyrimet e papaguara të paraqitura të grupuara sipas raporteve vjetore dërguar MFE paraqiten në fund vitin 2018 në shumën 386,712 lekë për fund vitin 2019 në shumën



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

450,628 lekë. Në raportimin e vitit 2018 u konstatuan pasaktësi, pasi vlerat e mësipërme nuk përkojnë me shumatat e paraqitura në bilanc dhe me pagesat e kryera në vitet pasardhëse fatura të pa likuiduara të vitit ushtrimor. Detyrimi i prapambetur i vitit ushtrimor 2018, përsa i përket angazhimeve për investimet është në vlerën prej 6,052,070 lekë, detyrim që nuk është paraqitur tek pasqyrat financiare vjetore si dhe tek plani i buxhetit vjetor 2019 dhe PBA 2019-2021 për investimet: -“Rijetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër” me vlerën me TVSH 148,783,112, detyrim i mbetur për vitin ushtrimor 2018 në vlerën 4,333,838 lekë; - “Rikonstruksion i urës në qendër të qytetit Këlcyrë” me vlerën me TVSH 4,943,420 lekë, detyrim i mbetur në vlerën prej 1,702,870 lekë. Vendimet gjyqësore nuk janë planifikuar në buxhetin e vitit 2019 dhe në buxhetin e vitit 2020, si dhe në PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 13 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/17, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në Projektraportin e Auditimit (PRA) faqe 12-38. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.**

### **2.3. Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe borxhi tatimor.**

#### **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Menaxhimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Këlcyrë, kryhet nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, ku për vitin 2018 me vendim nr.16, datë 13.02.2018 nga Kryetari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N. është miratuar struktura me 5 punonjës, nga të cilët 1 (një) përgjegjës, 3 (tre) inspektor, 1 (një) specialist dhe 6 agjent.

Për vitin 2019 me vendim nr.1, datë 03.01.2019 është miratuar struktura me 5 punonjës, nga të cilët 1 (një) përgjegjës, 3 (tre) inspektor, 1 (një) specialist dhe 5 agjent.

Për vitin 2020 me vendim nr.9, datë 24.01.2020 është miratuar struktura me 5 punonjës nga të cilët 1 (një) përgjegjës, 3 (tre) inspektor, 1 (një) specialist dhe 5 agjent.

Tabela nr. 2.3.1 “Struktura”

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr, datë	Urdhri largimit Nr, datë	Pozicioni i punës
A	b	1	2	3	4	5	6
1.	RH	Përgjegjës Zyra T.T	Finance-Kontabilitet	I larte	02.06.2016		Përgjegjës
2.	S.V.	Inspektor i Tarifave vendore	Agronomi	I larte	01.10.2015		Inspektor
3.	Marineo Çato	Inspektor i Tarifave vendore	Finance-Kontabilitet	I larte	01.09.2016		Inspektor
4.	Igli Kasaj	Inspektor i Tarifave vendore	Finance-Kontabilitet	I larte	01.12.2017		Inspektor
5.	Bekdash Allamani	Agjent T.T	Teknik Ndertimi	I mesem	11.07.2011	04.02.2020	Agjent

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

Punoi: KLSH

- Për vitin 2018, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr.1, datë 10.01.2018 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Këlcyrë të vitit 2018”.
- Për vitin 2019, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr.117, datë 12.12.2018 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Këlcyrë të vitit 2019”.
- Për vitin 2020, paketa fiskale është miratuar me VKB-në nr.86, datë 26.12.2019 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Këlcyrë të vitit 2020”.

**Për auditimin e burimit të krijimit të ardhurave dhe përdorimit të tyre u auditua dokumentacioni i paraqitur nga sektori i taksave dhe tarifave vendore si:**

- evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifave vendore;
- akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore;
- evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve;
- administrimi i aseteve;
- procedura e lëshimit të licencave dhe autorizimeve;
- dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

**Nga auditimi u konstatuan mangësitë e mëposhtme:**

**Titulli i gjetjes nr. 1: Gjendja e subjekteve për taksat dhe tarifave vendore**

Tabela nr. 2.3.2 “Gjendja e subjekteve të regjistruara”

Nr	Lloji i Biznesit	Viti	Gjendja ne fillim	Regjistrime te Reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund
1	Biznesi i Vogël	2018	184	1	27	158
		2019	158	2	18	142
2	Biznesi i Madh	2018	17	0	0	17
		2019	17	4	0	21
3	Gjithsej	2018	201	1	27	175
		2019	175	4	18	163
				5	45	

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Situata:** Nga të dhënat e tabelës konstatohet se për vitet objekt auditimi, ka 5 regjistrime të reja dhe 45 subjekte mbyllje aktiviteti, nga të cilat për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 201 subjekte (184 subjekte të biznesit të vogël, 17 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione), për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 163 subjekte (142 subjekte të biznesit të vogël, 21 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione).

Përsa më sipër konstatohet se:

Kjo situatë sipas Bashkisë Këlcyrë tregon nivelin e ulët ekonomik të kësaj Bashkie, por sipas gjykimit të Grupit të KLSH-së, është edhe puna



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

e pamjaftueshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave.

-Numri i bizneseve ka ardhur duke u zbritur nga viti 2018 në vitin 2019, me 27 subjekte të vegjël dhe me një rritje me 4 subjekte të mëdhenj;

-Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore; nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur;

-Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk janë administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore.

-Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimi fizik i dokumentacionit, rezulton se nga Zyra e Taksave Vendore, nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohet dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik).

-Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, 36 subjekte të biznesit të vogël, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Bashkinë Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, Sukë, Ballaban, Dishnice, nuk janë regjistruar në QKB, kjo ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për detyrimin e këtyre subjekteve që të regjistrohen në QKB, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre.

#### Kriteri:

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 4 ku cilësohet: *“Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”*, pika 7 *Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar. Neni 16 ku cilësohet: “Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është i detyruar që, deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t’u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga Ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Deklarata dorëzohet në bankat, me të cilat administrata tatimore ka marrëveshje për pranimin e deklaratave dhe të pagesave dhe ajo shoqërohet me çdo kërkesë për rimbursim apo me çdo shumë për t’u paguar -Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.*

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 ku cilësohet: *“Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar” 1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomik tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 121, të këtij ligji. 2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKB, përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, për mallrat që disponon, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencës/autorizimit për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmujore.

**Impakti:** Mungesa e kontrollit të territorit nga strukturat e zyrës së tatim taksave për evidentimin e subjekteve aktive dhe të ardhurat që realizojnë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe mos veprim i zyrës së taksave

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të paregjistruar në QKB. Bashkia Këlcyrë duhet të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. R.H., Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore

**Titulli i gjetjes nr. 2: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujori 2020.**

Tabela nr. 2.3.3 “Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujori 2020”

(në mijë lekë)

Nr	Lloji I Taksës	Viti 2018			Viti 2019			6 mujori 2020		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	B	1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>I</b>	<b>Te ardhura nga Tatimet</b>	<b>100</b>	<b>269</b>	<b>269</b>	<b>250</b>	<b>20</b>	<b>8</b>	<b>135</b>	<b>35</b>	<b>26</b>
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	100	269	269	250	20	8	135	35	26
<b>II</b>	<b>Te ardhura nga Taksat</b>	<b>12,084</b>	<b>7,506</b>	<b>64</b>	<b>12,254</b>	<b>5,806</b>	<b>47</b>	<b>7,559</b>	<b>3,024</b>	<b>40</b>
1	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	3,775	3,283	87	2,258	1,772	78	1,210	405	33
2	Taksa mbi token Bujqësore	2,400	1,449	60	2,550	1,082	42	1,417	313	22
3	Taksa mbi regj e Automjete	1,100	1,484	135	1,550	1,701	110	990	874	88
4	Taksa e ndikimit në Infrastrukturë	3,500	199	6	4,437	109	2	3,240	173	5
5	Taksa Tabele për qëllime identifikimi	19	12	63	19	20	105	12	0	0
6	Taksa Tabele për qëllime reklamimi	350	236	67	350	297	85	180	25	14
7	Taksa Trualli	100	193	193	200	339	170	110	1164	
8	Taksa e fjetjes në hotel	10	0	0	10	7	70	10	0	0
9	Taksa zënie hapësire publike (takse tregu)	630	650	103	680	479	70	290	70	24
10	Taksa të tjera të përkohshme	200	0	0	200	0	0	100	0	0
<b>III</b>	<b>Te ardhura nga Tarifat</b>	<b>7,202</b>	<b>5,340</b>	<b>74</b>	<b>7,543</b>	<b>4,464</b>	<b>59</b>	<b>4,113</b>	<b>2,655</b>	<b>65</b>
1	Tarifë Pastrimi	1,515	1,098	72	1,638	1,490	91	985	475	48
2	Tarifë ndriçimi rrugor	360	386	107	400	585	146	210	200	95
3	Tarifë e gjelbërimit	470	365	78	497	477	96	280	186	66
4	Tarifë për prerje lëndë drusore	450	34	8	280	62	22	160	4	3
5	Tarifë e kullojtjes	1,052	966	92	1,310	397	30	670	381	57
6	Tarifë për dhënie trualli me qëra (antena)	600	1,913	319	800	0	0	600	904	151
7	Të tjera tarifa (leje, autorizime, K.U.Z. infrastr, vaditje)	2,755	578	21	2,618	1,453	56	1,208	505	42
<b>GJITHSEJ (I+II+III)</b>		<b>19,386</b>	<b>13,115</b>	<b>68</b>	<b>20,047</b>	<b>10,290</b>	<b>51</b>	<b>11,807</b>	<b>5,714</b>	<b>48</b>

Burimi i të dhënave: Sektori i të Ardhurave





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Punoi: KLSH

#### Situata:

**a. Për vitin 2018**, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **19,386,000** lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën **13,115,000** lekë ose **68 %** me një diferencë në vlerën **6,271,000** lekë. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 4,409,000 lekë, ose 46% të planifikimit, të ardhurat nga tarifave nuk janë realizuar në vlerën 1,862,000 lekë, ose 26% të planifikimit, nga të ardhurat e tjera nuk janë planifikuar dhe realizuar, të ardhura nga debitorët nuk janë planifikuar dhe realizuar.

**b. Për vitin 2019** të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **20,047,000** lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën **10,290,000** lekë, ose **51%**, me një diferencë në vlerën **9,757,000** lekë. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 6,678,000 lekë, ose 53% të planifikimit, të ardhurat nga tarifave nuk janë realizuar në vlerën 3,079,000 lekë, ose 41% të planifikimit, të ardhura nga debitorët nuk janë planifikuar dhe realizuar.

**Situatë e cila tregon një nivel të ulët dhe punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018 dhe në buxhetin e vitit 2019 të mos financohen sipas parashikimeve duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin.**

Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër vjen në ulje, ku për vitin 2018 paraqitet në shumën 13,115,000 lekë, ndërsa në vitin 2019 paraqitet në shumën prej 10,290,000 lekë ose më pak në shumën prej 2,825,000 lekë ose 12% më pak. Kjo tregon punë pamjaftueshme të administratës së tatimit taksave të Bashkisë Këlcyrë në menaxhimin e tyre.



Përsa më sipër konstatohet se:

*-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin*, për vitin 2019 planifikimi është për vlerën 250 mijë lekë, ndërsa realizimi ka ulje nga njëra periudhë në tjetër, ku nga 269 mijë lekë arkëtime në vitin 2018 në vitin 2019 arkëtimet paraqiten në vlerën 20 mijë lekë ose më pak për vlerën 230 mijë lekë. Nga të dhënat konstatohet se nuk ka akt-rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimore.

Gjithashtu dhe në fazën e planifikimit nuk është marrë në konsideratë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

numri i subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos marrë në konsideratë numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të xhiros do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, etj.

- Nga verifikimi rezulton se nuk është rakorduar (çdo 6-muaj) me Drejtorinë e Tatimeve të Qarkut Gjirokastrë për realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, në cilësinë e agjentit tatimor.

- Niveli i arkëtimit të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifave vendore ka ardhur në ulje nga viti 2018 në vitin 2019, në vlerën 2,825,000 lekë ose **12%** më pak.

- Për vitin 2019 vlerën më të lartë të mos realizimit të të ardhurave vendore e zënë të ardhura nga Taksat Vendore në shumën **6,678,000** lekë.

- Nga planifikimi i të ardhurave nga arkëtimi i debitorëve të ndryshme nuk është realizuar asnjë e ardhur nga ky zë, për të dy vitet objekt auditimi.

- Të ardhura nga taksat kombëtare për vitin 2018 nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Këlcyrë, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.

- Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike, pra nuk ka një data bazë të saktë për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Këlcyrë.

- Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj.) në Bashkinë Këlcyrë të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, sipas nenit 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar. Nga auditimi rezulton se nuk është kryer rakordim me zyrat e gjendjes civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë.

#### **Kriteri:**

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”;

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

#### **Impakti:**

Mos realizimi i të ardhurave, mosvjelja e detyrimeve etj., ka impakt negativ në burimet e financimit dhe për rrjedhojë në realizimin e shpenzimeve, për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

#### **Shkaku:**

Punë e pamjaftueshme e administratës së Bashkisë Këlcyrë, si dhe mosrakordim me strukturat e tjera, si QKB, Drejtoria e Tatimeve Gjirokastrë, Zyrat e Gjendjes Civile etj. me qëllim evidentimin e subjekteve të paregjistruara, zbatimin e masave shtrënguese për vjeljen e detyrimeve etj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve, bashkëpunimin me struktura të tjera si QKB, Drejtoria e Tatimeve Gjirokastrë, Zyrat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj me qëllim:

1. Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

2. Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

3. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;

4. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

### **Titulli i gjetjes nr. 3: Planifikimi i gabuar dhe jo i saktë për taksën e tokës bujqësore për vitet 2018 dhe 2019.**

Taksa mbi tokën bujqësore, për vitet 2018 dhe 2019 paraqitet me mosrealizim ku:

- Për vitin 2018 realizimi paraqitet në masën 60% ose nga 2,400 mijë lekë të planifikuar, është arkëtuar vlera prej 1,449 mijë lekë.
- Për vitin 2019 realizimi paraqitet në masën 42% ose nga 2,550 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 1,082 mijë lekë.
- Niveli i arkëtimeve nga viti 2019 në vitin 2018 ka një ulje prej 367 mijë lekë.

Tabela nr. 2.3.4 “Pasqyra e arkëtimit”

Nr	Bashkia Këlcyrë dhe NJA	2018		2019		6 mujori 2020	
		Sip/Ha	Vlera	Sip/Ha	Vlera	Sip/Ha	Vlera
1	Këlcyrë	430	244,000	430	132,000	430	162,000
2	Sukë	1,343	306,000	1,343	95,000	1,343	29,000
3	Ballaban	1,342	497,000	1,342	233,000	1,342	50,000
4	Deshnicë	1,537	402,000	1,537	622,000	1,537	72,000
<b>Shuma Këlcyrë</b>		<b>4,652</b>	<b>1,449,000</b>	<b>4,652</b>	<b>1,082,000</b>	<b>4,652</b>	<b>313,000</b>

Burimi i të dhënave: Sektori i të Ardhurave  
Punoi: KLSH

Tabela nr. 2.3.5 “Mbi sipërfaqen e tokës gjithsej të ndarë sipas ligjit”

Nr	Bashkia Këlcyrë dhe NJA	Tokë bujqësore gjithsej	Nga e cila				Familjet që kanë marrë tapi	
			Arë	Pemëtore	Vreshta	Ullishte	Nr.	Ha
1	Këlcyrë	790	778.5	3	7	1.5	436	430
2	Sukë	2172	2161	5	6	0	1021	1343
3	Ballaban	2398	2393		4	1	1005	1342
4	Deshnicë	2365	2352	6	5	2	898	1537
<b>Totali</b>		<b>7725</b>	<b>7684.5</b>	<b>14</b>	<b>22</b>	<b>4.5</b>	<b>3360</b>	<b>4652</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

Punoi: KLSH

Referuar të dhënave të Sektorit të Menaxhimit të tokës Bashkia Këlcyrë, por edhe nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej 7725 Ha, është ndarë 4652 Ha dhe janë pa ndarë 3073 Ha.

Nr	Bashkia Këlcyrë dhe NJA	Sip e tokes gjithsej ha	Numri i familjeve gjithsej	Marre toke nga AMTP sip.ha	Marre toke e AMTP familje gjithsej
1	Këlcyrë	790	436	430	436
2	Sukë	2172	1021	1343	1021
3	Ballaban	2398	1005	1342	1005
4	Deshnicë	2365	898	1537	898
<b>Bashkia Këlcyrë Totali</b>		<b>7725</b>	<b>3360</b>	<b>4652</b>	<b>3360</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Referuar të dhënave të mësipërme konstatohet se në Bashkinë Këlcyrë janë posedues të tokës bujqësore sipas ligjit, gjithsej **3,360** familje, të cilat duhet ti nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme sipas kuadrit ligjor.

**Tabela nr. 2.3.6 “Fondi i tokës bujqësore klasifikuar sipas kategorisë”**

Nr	Nj. Administrative	Kategoria 4	Kategoria 5	Kategoria 6	Kategoria 7	Kategoria 8	Sip. Tot. Ha
1	Këlcyrë	-	254	-	101	75	430
2	Sukë	-	97	505	305	436	1,343
3	Ballaban	-	108	394	229	611	1,342
4	Deshnicë	-	294	1,072	171	-	1,537
	<b>Shuma/hektar</b>	-	<b>753</b>	<b>1,971</b>	<b>806</b>	<b>1,122</b>	<b>4,652</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Në Bashkinë Këlcyrë rezulton se toka bujqësore u përket kategorive IV deri VIII, sipas përkatësisë, Kategoria e V 753 Ha, kategoria VI 1,971 Ha, kategoria VII 806 Ha dhe kategoria e VIII 1,122 Ha. Gjithsej fondi i tokës bujqësore për Bashkinë Këlcyrë është **4,652** Ha.

**Tabela nr. 2.3.7 “Vlerësimi i tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit”**

Nr.	Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqja/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit	
1	Kategoria IV	1,350 lekë	0	0	2018	2019
2	Kategoria V	1,250 lekë	753	941,250		
3	Kategoria VI	1,200 lekë	1971	2,365,200		
4	Kategoria VII	1,100 lekë	806	886,600		
5	Kategoria VIII	1,100 lekë	1122	1,234,200		
6	<b>Totali</b>	-	<b>4,652 hektar</b>	<b>5,427,250</b>	<b>2,400,000</b>	<b>2,550,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

- Nga sa më sipër diferenca në planifikim është **3,027,250** lekë për vitin 2018 (5,427,250 - 2,400,000), dhe **2,887,250** lekë për vitin është 2019 (5,427,250 - 2,550,000), gjë e cila ka sjellë të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për të dy vitet të marra së bashku në vlerën **5,904,500** lekë.

**Situata 1:** Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Këlcyrë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatohet se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki, për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave Vendore, konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për vitet 2018 + 2019 paraqitet në shumën 4,950,000 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 1,417,000 lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, planifikimi për vitet 2018 dhe 2019 duhej të ishte në shumën 10,854,000 lekë ose më pak për shumën **5,904,500 lekë**, ndërsa për vitin 2020 është planifikuar në shumën 1,417,000 lekë ose më pak për shumën **4,010,250 lekë**. Këto veprime kanë çuar në mos planifikim të taksës së tokës për diferencën prej **9,914,750 lekë**.

**Kriteri:** - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23, “Taksa mbi tokën bujqësore” ku cilësohet:

*Pika 1 “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nën kategorizime.*

*Pika 2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji.*

*Pika 3. Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.*

*Pika 4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë ose komunës, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme”.*

**Impakti:** Mos planifikim i saktë i taksës mbi tokën bujqësore.

**Shkaku:** Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe mos koordinim i duhur midis sektorëve në marrjen e informacionit.

**Rëndësia:** **E lartë**

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **9,914,750 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. R.H., Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### **Titulli i gjetjes nr. 4: Mos aplikimi i saktë i tarifave vendore mbi subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike**

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 1, datë 10.01.2018, (Paketa Fiskale 2018), Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

112, datë 12.12.2018, (Paketa Fiskale 2019). Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.86, datë 26.12.2019, (Paketa Fiskale 2020) të Bashkisë Këlcyrë, përsa i përket realizimit të të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore të subjekteve të ndërtimit që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike nga Bashkia Këlcyrë. Bazuar në evidencën e prokurimeve ku subjektet që janë kualifikuar si oferta e vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë për periudhën e viteve 2018, 2019 dhe 6 mujori 2020 pasqyrohen në vijim:

**Tabela nr. 2.3.8 Viti 2018**

Nr,	Operatori fitues	Data e lidhjes kontratës	Vlera e kontratës
1	Salillari SHPK & ROSI SHPK	14.08.2017	148,783,112
2	AGIMI SHPK & H. SHPK	06.10.2017	14,985,891
3	E SHPK & Alba Konstruksion SHPK.	16.08.2018	4,943,420
4	E SHPK & Alba Konstruksion SHPK	26.01.2018	19,143,021
5	J. Sh.p.k	25.10.2018	12,671,105

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Tabela nr. 2.3.9 Viti 2019**

Nr,	Operatori fitues	Data e lidhjes kontratës	Vlera e kontratës
1	E SHPK Permet & Alba Konstruksion SHPK	15.02.2019	56,404,874
2	J. SHPK	07.05.2019	34,858,247
3	H. SHPK	10.06.2019	36,353,317
4	H. SHPK	01.07.2019	27,384,647
5	J. SHPK	25.10.2018	12,671,105

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nga përlogaritjet e kryera për çdo subjekt sipas kohës së kryerjes së punimeve si dhe me tarifën përkatëse të miratuara në paketat fiskale të Bashkisë Këlcyrë për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujori i parë 2020 rezultojnë në pasqyrën si më poshtë:

**Tabela nr. 2.3.10 "Tarifat për subjektet me investime në vlerë mbi 5 milionë"**

Nr	Operatori Fitues	Data e lidhjes se kontrates	Vlera e kontrates	Marre ne dorezim viti	Tarifë per ngritje kantieri ndërtimi (investime publike)	Tarifa pastrimi për subjektet fituese të investimit deri në 5 milione leke	Tarifa pastrimi për subjektet fituese të investimit mbi 5 milione leke	Totali
1	Salillari shpk & ROSI shpk Permet	14.08.2017	148,783,112	2019	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
2	AGIMI shpk Permet & HITO 94 shpk Permet.	06.10.2017	14,985,891	2018	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
3	Eurostil shpk Permet & Alba Konstruksion sh	16.08.2018	4,943,420	2019	35,000 leke/vit	50,000 leke/vit		85,000
4	Eurostil shpk Permet & Alba Konstruksion sh	26.01.2018	19,143,021	2018	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
5	JOGI Sh.p.k	25.10.2018	12,671,105	2019	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
6	"Eurostil": sh.p.k Permet & "Alba Konstruksion"	15.02.2019	56,404,874	2019	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
7	JOGI Sh.p.k	07.05.2019	34,858,247	2020	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
8	HITO 94	10.06.2019	36,353,317	2020	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
9	HITO 94	01.07.2019	27,384,647	2019	35,000 leke/vit		100,000 leke/vit	135,000
								<b>1,165,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

#### Situata:

-Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Këlcyrë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën për ngritje kantier ndërtimi (investime publike), tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit deri në 5 milionë lekë, tarifë për ngritje kantier ndërtimi tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit mbi 5 milionë lekë, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Njësi



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

administrative në vartësi. Nga përlogaritjet e kryera rezulton se nuk janë aplikuar tarifatat për kantier ndërtimi dhe pastrimi për 9 objekte ndërtimi në vlerën totale prej 1,615,000 lekë. Vlera prej **1,165,000 lekë**, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave të kantieri ndërtimi, tarifën e pastrimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, *konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.*

#### Kriteri:

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35 ku cilësohet:

1. “Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur: a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.

2. Tarifatat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifatat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifatat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent.

-VKB nr.1, datë 10.01.2018 “Paketa Fiskale 2018”, Pika B “Tarifat vendore”. Tarifa Pastrimi për subjektet jashtë Bashkisë (Fituese të Investimeve).

Nënpika B.1.17, me fonde deri në 5 milionë lekë, për çdo kantier ndërtimi tarifa është 50,000 lekë/vit;

Nënpika B.1.18, me fonde mbi 5 milionë lekë, për çdo kantier ndërtimi tarifa është 100,000 lekë/vit;

Nënpika B.1.a. Tarifë për ngritje kantieri (për tendera e investime publike), për çdo kantier ndërtimi nga operatorët tarifa është **35,000 lekë/vit**

-VKB nr. 112 datë 12.12.2018 “Paketa Fiskale viti 2019” Pika 2. Tarifatat vendore:

Nënpika B.1.16, Tarifa Pastrimi për subjektet jashtë Bashkisë (Fituese të Investimeve);

Nënpika B.1.16.a, me fonde deri në 5 milionë lekë, për çdo kantier ndërtimi tarifa është 50,000 lekë/vit;

Nënpika B.1.16.b, me fonde mbi 5 milionë lekë, për çdo kantier ndërtimi tarifa është 100,000 lekë/vit;

Nënpika B.1.4, Tarifë për ngritje kantieri (për tendera e investime publike), për çdo kantier ndërtimi nga operatorët tarifa është 35,000 lekë/vit.

#### Impakti:

Dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë, nga mos aplikimi i tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifatat e pastrimit mbi subjektet që kanë kryer punime publike dhe që janë të identifikuar.

#### Shkaku:

Mos zbatimi i paketave fiskale dhe kuadrit ligjor

#### Rëndësia:

**E lartë**

#### Rekomandimi:

Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **1,165,000**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**lekë**, si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifave të pastrimit për 9 objektet, nga 6 operatorë ekonomikë, që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. R.H., Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### **Titulli i gjetjes nr. 5: Mbi aplikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.**

Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnicë, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet.**

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë karburante në Bashkinë Këlcyrë për vitet 2018, 2019 dhe 6 mujori i parë i vitit 2020, paraqiten 4 subjekte si më poshtë:

NR	Emërtimi i Subjektit	ADRESA	NIPT	Data e fillimit të Aktivitetit	Autorizim / Licencë
1	D.O.	KËLCYRË	L52230020G	20.10.2015	Nuk është pajisur me licencë
2	E SHPK	KËLCYRË	L19801201K	01.12.2011	Nuk është pajisur me licencë për 5 vjecarin e I-parë deri 12/2016 si dhe nuk është bërë rinovim për 5 vjecarin e II-dytë deri 12/2021
3	DF.P.	KËLCYRË	L58712201S	12.01.2015	Nuk është pajisur me licencë për 5 vjecarin e I-parë deri 01/2020 si dhe nuk është bërë rinovim për 5 vjecarin e II-dytë deri 01/2025
4	ANEL & CO SHPK	KËLCYRË	L82505601P	05.01.2018	Nuk është pajisur me licencë

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim, për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas pasqyrës si më poshtë:

Tabela nr.2.3.11 “Pasqyra përmbledhëse e subjekteve që nuk ka likuiduar tarifën e licencimit/autorizimit”

NR	Emërtimi i Subjektit	Data e fillimit të Aktivitetit	Afati i përdorimit të licencës	Periudha e shfrytëzimit të Aktivitetit	Pagesa sipas VKM nr. 970, dt. 02.12.2015		Pagesa sipas VKM nr.344, dt. 19.04.2017		Diferenca për pagesë
					Pikë shitje	Stac Shitje	Pikë shitje	Stac Shitje	
1	D.O.	20.10.2015	10/2020	5 vjet	200,000	2,000,000			2,200,000
2	E.	01.12.2011	12/2016 dhe 12/2021	9 vjet	400,000	4,000,000			4,400,000
3	D.P.	12.01.2015	01/2020 dhe 01/2025	6 vjet	200,000	2,000,000	100,000	1,000,000	3,300,000
4	A.C.	05.01.2018	01/2023	3 vjet			100,000	1,000,000	1,100,000
					<b>800,000</b>	<b>8,000,000</b>	<b>200,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>11,000,000</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Situata:** -Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnicë, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 11,000,000 lekë**, vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

#### Kriteri:

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35 ku cilësohet:

*“1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:*

*a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;*

*b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.*

*2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifrat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifrat do të mbliidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent”.*

- VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4, ku cilësohet:

#### *II. Procedura për dhënien e autorizimeve*

*Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.*

#### *III. Pagesat*

*Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Tarifrat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:*

*1. për lejet e tregtimit të llojit " A " 500 000 lekë*

*2. për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë*

*3. për lejet e tregtimit të llojit "C" 200000 lekë*

*4. për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikante dhe të stacioneve të mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm 100 000 lekë*

*5. për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50000 lekë.*

*Tarifrat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.*

- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës "b" ku cilësohet:

*II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë*  
*1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:*

*b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.*

*9. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.*

*- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"9. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."*

*10. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.*

*- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"10. Paga për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera."*

*"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."*

*-VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM nr. 970,*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.”*

**Impakti:** Dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë, identifikuar si mungesë në arkëtimin e të ardhurave për realizimin e investimeve, në vlerën 11,000,000 lekë, shkaktuar nga aktiviteti i paligjshëm i 4 subjekteve dhe mospagim të detyrimeve.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **11,000,000 lekë**, për subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:  
-Subjekti **D.O.**, për vlerën prej **2,200,000 lekë**.  
-Subjekti **E. SHPK**, për vlerën prej **4,400,000 lekë**.  
-Subjekti **D.P.**, për vlerën prej **3,300,000 lekë**.  
-Subjekti **A.C.SHPK**, për vlerën prej **1,100,000 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z.K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë
2. Znj.R.H., Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

**Titulli i gjetjes 6: Mos rakordimi me agjentët tatimorë për arkëtimin e detyrimeve**

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi aktivitetin e agjentëve tatimorë për të ardhurat që arkëtohen dhe kalojnë në Bashkinë Këlcyrë, u konstatua se:

- Nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore, midis Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Këlcyrë dhe Agjentëve Tatimorë. Pra të ardhura nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) Dega Gjirokastër, nuk derdhen automatikisht brenda datës 5 të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Këlcyrë, nisur nga fakti se në vitet 2018 dhe 2019, nuk ka asnjë arkëtim.

- Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, në lidhje me TFTH nuk janë mbajtur rregullisht në fund të çdo muaji dhe nuk ka informacion sa subjekte duhet të paguajnë dhe sa jo.

**Kriteri:** - Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, neni 117 ku cilësohet: “Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme: a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. b) Gjobë në masën 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën; c) Gjobë në masën 100 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk deklaron e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën e mbledhur.*

#### Impakti:

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë, nga mos arkëtimi dhe derdhja në buxhet e detyrimeve, duke afektuar në këtë mënyrë realizimin e shpenzimeve për kryerjen e shërbimeve dhe investimeve me burim financimi të ardhurat e veta.

#### Shkaku:

Mos zbatimi i legjislacionit tatimor.

#### Rëndësia:

**E mesme**

#### Rekomandimi:

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë, sipas llojit të taksës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë, si dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë.
- Të krijohet baza e të dhënave për subjektet, tarifat dhe taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera dhe të kryejë rakordimet në fund të çdo muaji, sipas formularit përkatës, të miratuar nga Ministria e Financave.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. RH, Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

#### Titulli i gjetjes 8: **Gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në datë 31.12.2019**

##### Situata:

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2019, detyrimet ndaj Bashkisë Këlcyrë, janë në vlerën gjithsej **60,386,981** lekë. Kjo gjendje debitorë është krijuar nga **220** subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për vlerën **22,853,022** lekë, **(e pa kontabilizuar)**, dhe **3,360** familje për detyrime të papërlllogaritura për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **37,533,959** lekë.

Nga krahasimi i të dhënave midis vlerës së detyrimeve të pashlyera sipas të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave vendore, me vlerën që paraqet Sektori i Financës në pasqyrat financiare, (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”) nuk paraqet vlerën reale të detyrimeve. Sipas bilancit të vitit 2018, detyrimet janë në shumën 6,078,000 lekë, e pandryshuar edhe në bilancin e vitit 2019, dhe sipas përlllogaritjeve të bëra nga Grupi i Auditimit referuar të dhënave të marra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, gjendja reale e debitorëve është në vlerën prej 60,386,981 lekë, pra konstatohet një diferencë e dukshme në vlerën prej **54,308,981** lekë, **vlerë kjo e cila është e pa kontabilizuar.**

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për 48 bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

-Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 220 subjekte debitorë (fizik/juridik) në vlerën **22,853,022 lekë**, janë aktiv 172 subjekte ose 78% e totalit të debitorëve të evidentuar, të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa.

Spektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe **asnjë procedurë tjetër**, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezultoi e dështuar, sidomos për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.

#### Kriteri:

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 88 deri 104, Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Pagesa e shumës së qarkullimit të sekustruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga Spektori i Taksave dhe Tarifave, nuk është bërë kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

#### Impakti:

Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Këlcyrë dhe mos kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare, paraqet një situatë financiare ndryshe nga sa është në realitet.

#### Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët.

#### Rëndësia:

**E lartë**

#### Rekomandimi:

Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë të marrë masat e duhura, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për **220** subjekte, për vlerën **22,853,022 lekë** dhe **3,360** familje, për vlerën gjithsej **37,533,959 lekë**, konkretisht:

- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë, urdhër bllokime të llogarive bankare të subjekteve;
- Ti dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e krijuara në vite, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori Juridik, të marrë masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të RSH, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z. K.N., Kryetar i Bashkisë Këlcyrë.
2. Znj. R.H., Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Znj. V.K., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 12 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/16, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 12-38. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.**

3.

**lerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018-2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i shfuqizuar (për pasqyrat financiare të vitit 2018), ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (për pasqyrat financiare të vitit 2019), si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.**

#### **3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

**Titulli i Gjetjes 1: Mbi penalitetet që lindin si pasojë e dorëzimit të situacioneve të mëvonshme nga datat e faturave përkatëse, me efekt të drejtpërdrejt në shumën e detyrimit tatimor (TVSH-së) të paguar nga investitorët për vitet 2018 dhe 2019.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Situata:

Nga auditimi i kampionit të zgjedhur të urdhër shpenzimeve, me objekt investimet kapitale të vitit 2018 dhe 2019 rezultoi se, nga ana Bashkisë Këlcyrë, nga likuidimi i shpenzimeve kapitale për investimet, në përgjithësi faturat tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përkatës.

Për paraqitjen e faturave tatimore, në data të mëvonshme nga datat e situacioneve të punimeve, parashikohet një penalitet për investitorët, për mospagim në afat të TVSH-së. Sipas përlogaritjeve ky penalitet në total është në shumën 455,084 lekë, dhe përbën një të ardhur jo tatimore, të munguar në buxhetin e shtetit. (Paraqitur në mënyrë analitike sipas urdhër shpenzimeve, në Tabelën anekse nr. 3.1 “Mbi deklarimet me vonesë të faturave” bashkëlidhur këtij materiali).

Nga ana tjetër, sipas testeve analitike, të kryera për shpenzimet e investimeve si për vitin 2018, ashtu dhe për vitin 2019, është paraqitur dokumentacion i parregullt, në rastin konkret nga ana e investitorëve janë paraqitur situacione pa data. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18, si dhe udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar” dhe i ngarkohet investitorëve përgjegjësia për këtë veprim.

Pranimi i dokumentacionit vërtetues, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 6 e udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues siç shprehet edhe neni 12 pika 3 germa (dh) dhe (e) e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

#### Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 49,50 51 dhe 114;

- Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë neni 99;

Udhëzimi i MF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” neni 20;

ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7,12, dhe 18 si dhe;

udhëzimi nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar”.

#### Ndikimi/Efekti:

Pranimi i dokumentacionit të paplotë, përbën risk për sa i përket vërtetësisë së shpenzimit kapital. Gjithashtu vlera totale e penalitetit ku faturat janë paraqitur shumë më vonë se sa koha e situacionit në shumën 455,084 lekë përbën një të ardhur jo tatimore të munguar në buxhetin e shtetit.

#### Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, Udhëzim i MF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit etj.

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

- Nga Bashkia Këlcyrë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital.
- Nga Nëpunësi Autorizues të komunikohet me shkresë me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, ku të vihet në dijeni për gjendjen e debitore të subjekteve “ROSI” SHPK me NIUS J69102223E dhe “B.S.” SHPK, me NIUS K71412003A, shkaktuar si rezultat i mospagimit në afat të TVSH-së, në vlerën **455,084 lekë** (sipas Tabelës anekse nr. 3.1).

**Konkluzion:** Nga auditimi u evidentua se Nëpunësi Zbatues nuk ushtronte kontroll të plotë mbi saktësinë e dokumentacionit të paraqitura nga OE, për likuidimin e shpenzimeve kapitale (investime në punë publike).

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Nëpunësi Zbatues znj. V.K. si dhe ngarkohen me pagesën e detyrimit për TVSH-në, subjektet “R” SHPK me NIUS J69102223E dhe “B.I.” SHPK me NIUS K71412003A.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 3 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 14 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/18, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 39-56. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.**

### **3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë.**

Në subjektin e auditimit Bashkia Këlcyrë, mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet, si dhe udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Duhet theksuar se vazhdon mbajtja e kontabilitetit pa një program kontabël, por çdo gjë regjistrohet në excel, që përbën dhe risk në ruajtjen e të dhënave. Pasqyrat financiare janë paraqitur në formatin e tyre të plotë, siç e parashikojnë dhe anekset e udhëzimit të MF nr.8, datë 09.03.2018. Auditimi është kryer bazuar në vlerësimin e riskut, materialitet dhe kufirit të lejueshëm të tij (pragut). Nën gjykimin tonë është përcaktuar pragu i materialitetit, sipër të cilit janë testuar llogaritë kontabël, si dhe është përcaktuar materialiteti sasior, bazuar në Manualin e Auditimit Financiar, me metodën e përqindjes mbi shpenzimet korente dhe kapitale, i cili rezulton në vlerën **413,717 lekë**, për vitin 2018 dhe në vlerën **497,038 lekë**, për vitin 2019.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**Titulli i Gjetjes 1:** Mbi klasifikimin si shpenzimeve kapitale 231 dhe kapitalizmin e shpenzimeve në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” për vitet 2018 dhe 2019.

**Situata:** Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Këlcyrë dhe për 3 ish Komunat, në fund të vitit 2017, rezulton me një kosto historike 338,554,415 lekë dhe në fund të vitit 2018, rezulton me një kosto historike 345,229,792 lekë, ose me rritje në vlerë neto prej 6,675,377 lekë. Në fund të vitit 2019 kostoja historike shkon në vlerën 381,849,296 lekë, pra ka një rritje vjetore prej 36,619,504 lekë. Rritjet e vlerës historike të aktivitetit si gjatë vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019 janë të njëjta me rritjet e tij në pasqyrat e ndryshimit të gjendjes së aktiveve afatgjata me kosto historike. Por duhet theksuar se jo çdo shpenzim investimi mund të kapitalizohet në aktivin përkatës për të cilin po bëhet investimi, për sa kohë nuk janë dorëzuar situacionet përfundimtare dhe nuk janë marrë në dorëzim investimet. Shtesa në tabelën e gjendjeve të ndryshimit të aktiveve afatgjata materiale (kosto historike) për llogarinë 212 Ndërtime e Konstruksione ka qenë në vlerën 6,675,377 lekë, ndërsa sipas dokumentacionit shoqëruar në urdhërshpenzimet e verifikuara në ditarët e bankës, kjo vlerë prej 6,675,377 lekë përbën shpenzime kapitale për projektin “Përmirësimin e Kushteve të banimit për Komunitete të pa favorizuara”, projekt i cili në fund të vitit 2018, nuk ishte mbaruar si investim dhe nuk ishte marrë në dorëzim, që do të thotë është një investim në proces. Pra vlera e investimit duhet të regjistrohet në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën 6,675,377 lekë dhe jo në llogarinë e aktivitetit 212 “Ndërtime e Konstruksione”.

**Kriteri:** Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku citohet:  
*Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike:*

- *Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e AAGJ-ve.*
- *Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.*
- *Këto janë investime në proces, pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar.*
- *Grupi 23 “Investime” ndahet në dy llogari tre shifrore që më tej klasifikohen në nivele shtate shifrore, sipas karakteristikave të këtyre aktiveve.*
- *Llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale”, të analizuar në llogari shtatë shifrore; dhe*
- *Llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, të analizuar në llogari shtatë shifrore.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara.

**Ndikimi/Efekti:** Rritja në mënyrë të padrejtë e aktivitetit, sjell rritje të vlerës totale të aktiveve dhe pasqyron një vlerë asetesh të rritur artificialisht.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivitetit në njësi.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandime:** Nga ana e Përgjegjëses së Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë, të bëhet sistemimi në kontabilitet, në kredi të llogarisë 212 “Ndërtime e Konstrukione” dhe në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **6,675,377 lekë**, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit pasardhës.

**Konkluzion:** Sa më sipër, është evidentuar se nuk janë pasqyruar në llogarinë e duhur, investimet në proces, duke i konsideruar ato, si investime të përfunduara dhe kapitalizuara.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Përgjegjësia e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, zj. V.K.

**Titulli i Gjetjes 2:** **Mbi klasifikimin si shpenzimeve kapitale 231 dhe kapitalizimin e shpenzimeve në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vitet 2018 dhe 2019.**

**Situata:** E njëjta situatë paraqitet edhe për llogarinë 213 Rruge, rrjete, vepra ujore. Vlera prej 150,447,389 lekë e vitit 2018 dhe 66,600,470 lekë e vitit 2019 për investime kapitale, nuk janë regjistruar në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për investimet e projekteve të papërfunduara dhe jo të kolauduara apo marrë në dorëzim nga bashkia Këlcyrë, por janë kapitalizuar direkt në llogarinë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”. Shpenzimet kapitale prej 150,447,389 lekë për vitin 2018 dhe 66,600,470 lekë për vitin 2019, të cilat janë kryer gjatë vitit 2018 dhe 2019 dhe nuk janë marrë në dorëzim gjatë vitit përkatës, që do të thotë se duhet të ishin klasifikuar si 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3.2

#### Llogaria 213 "Rruge, Rrjete e Vepra Ujore" Viti 2018

28	2131100	Rijetezim i pedonaleve dhe hapësirave qender	107,222,064	2018
11	2313300	Rikonstr i rrjetit te brendsh te ujesjell Kelcyre	33,030,964	2018
5	2313200	Rikonstruks Ura ne qender te qytetitj Kelcyre	3,240,550	2018
5	2313400	Skema ujitese Ballaban, Ujitja e fush.Ballaban	6,983,811	2018
<b>Totali</b>			<b>150,477,389</b>	

Tabela nr. 3.2



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

#### Llogaria 213 "Rruge , Rrjete e Vepra Ujore" 2019

Nr	Llogaria	Emertimi	Vleftha	Viti
26	2131000	Rikonstruksion I rrugeve te lagjes se Spitalit	5,000,000	2019
27	2131000	Sistemim asfaltim rruga Suke-Podg.Fushe, rruga Goric	15,454,629	2019
13	2133000	Ndertim i rrjetit te Jashtem te ujesjell Kelcyre	36,146,202	2019
7	2134000	Skema ujtese Ballaban, Ujitja e fush.Ballaban	9,999,639	2019
<b>Total</b>			<b>66,600,470</b>	

Këto vlera duhet të ri klasifikohen si 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vitet përkatëse dhe ti zbritet vlera aktivitetit të qëndrueshëm të trupëzuar.

#### Kriteri:

Ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" të cituar më lart.

#### Ndikimi/Efekti:

Paraqitja e aktivitetit 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" më shumë në vlerën **150,477,389 lekë**, në vitin 2018 dhe **66,600,470 lekë** për vitin 2019, si dhe paraqitja më pak, e po këtyre vlerave në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" sjell pasqyrim jo të saktë të AQT-ve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

#### Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit si dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivitetit në njësi

#### Rëndësia:

E Mesme

#### Rekomandime:

Nga ana e Përgjegjëses së Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë, të bëhet sistemimi në kontabilitet në kredi të llogarisë 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore" dhe në debi të llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" për shumën **150,477,389 lekë** në vitin 2018 dhe **66,600,470 lekë** për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit 2020, nëse kjo vlerë vazhdon të jetë e pa kapitalizuar edhe gjatë këtij vitit ushtrimor.

**Konkluzion:** Nga Përgjegjësjë e Financës, në mënyrë të gabuar për vitin 2018 dhe 2019, investimet e pa përfunduara, të pa marra në dorëzim janë pasqyruar në llogarinë 213 dhe jo në llogarinë 231, duke rritur vlerën e aktiveve të kapitalizuara dhe duke ulur vlerën e aktiveve në proces, për shumën 150,477,389 lekë në vitin 2018 dhe 66,600,470 lekë në vitin 2019.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Përgjegjësjë e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, znj. V.K.

**Titulli i Gjetjes 3: Mbi rivlerësimin e aktiveve materiale afatgjata jo materiale.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Situata:

Nga verifikimi i të dhënave analitike të llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” konstatohet se, në fund të vitit 2018 dhe 2019, disa studime e projektme të trashëguara nga njësia Ballaban, paraqiten me vlera zero lekë, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Tabela nr. 3.4

Llogaria 230 “*Studime dhe kërkime*”

Nr	Llogaria	Emertimi	Vlefata
<b>A</b>			
<b>Studime</b>			
1	2020100	Projekt zhvillimi Komuna Ballaban	0
2	2020100	Preventiv objekti shkolla e mesme Ballaban	0
3	2020100	Projekt objekti shkolla e mesme Ballaban	0
4	2020100	Projekt i kendi sportiv shk.e mesme Ballaban	0
5	2020100	Projekt KUZ fshati Ballaban	0
6	2020100	Studim gjeologjik ura Sallaj	0
7	2020100	Projekt i ura metalike Sallaj	0
8	2020100	Projekt i rruges Posta e vjeter - Karat	0
9	2020100	Projekt i preventi Ujesh Kondas-Pavar (cop 2)	300,000
<b>Shuma A</b>			<b>300,000</b>

Kjo situatë ka rezultuar me nënvlerësim të AAGJMM të paraqitur në Pasqyrën e pozicionit financiar, ku llogaria 230 “*Studime dhe Kërkime*” nuk paraqet “*vlerën reale*” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Këlcyrë, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi, duke qenë se këto aktive të trashëguara, janë paraqitur me vlerë zero dhe nuk janë bërë hyrje në magazinë.

Gjithashtu, është evidentuar se disa AAGJM- Ndërtesa e Konstruksione në fund të vitit 2019, kanë vlera të ulëta (nën 100.000 lekë) dhe joreale në krahasim me vlerat e tregut për aktivet përkatëse, si më poshtë:

Llogaria 212 “*Ndërtesa*”

Nr	Llogaria	Emertimi	Vlefata	Viti
8	2120103	Shkolla fillore Vinokash II	55,000	1984
9	2120103	Shkolla Psarr	10,000	1973
10	2120103	Shkolla Komarak	47,000	1985
11	2120103	Shkolla fillore Ballaban	18,000	1970
12	2120103	Shkolla Pavar	23,000	1973
13	2120103	Shkolla Beqaraj	46,000	1986
14	2120103	Shkolla Kenaj	23,000	1984
15	2120103	Shkolla Karat	47,000	1985
16	2120103	Kopshti Ballaban	3,000	1983

#### Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018:

-Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara”, pika 105.

Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar janë:

“...Vlerësohen dhe kontabilizohen aktivet e pavlerësuar...”

-Aneksi 1 “Analizë e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Hyrjet e Aktiveve Afatgjata Materiale dokumentohen për:

“Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).

-Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt- marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitet.

-Për përfitimet nga dhurime, ku si dokument është akti i dhurimit dhe akti i marrjes në dorëzim.

-Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim

-Për rivlerësimet, shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve”.

Gjithashtu, duhet të kryhen veprimet kontabël në rast të diferencave nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale:

-Debi llog. 21 në kredi llog.109 (Diferenca nga rivlerësimi në rritje);

-Kredi llog. 21 në debi llog. 109 (diferenca nga rivlerësimi në ulje).

SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”.

**Ndikimi/Efekti:** Paraqitja në kontabilitet e studimeve dhe projekteve pa vlerë reale duke ulur kështu vlerën totale të aktiveve të zotëruara nga subjekti si dhe mungesa e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale (212 Ndërtesa dhe Konstruksione), sjell një pasqyrim jo real të vlerës së tyre në pasqyrat financiare,

**Shkaku:** Bashkia Këlcyrë nuk ka vlerësuar dhe analizuar si duhet gjendjen e aktiveve, dhe për rrjedhojë nuk ka ndërmarrë kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut).

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandime:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për ndërmarrjen dhe kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi.

**Konkluzion:** Nga ana e Bashkisë Këlcyrë, nuk janë marrë masa për vlerësimin dhe rivlerësimin e aktiveve (AAGJM dhe AAGJJM), gjë e cila ka sjellë mos pasqyrim të tyre me vlerën reale, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Nëpunësi Autorizues z. K.N. dhe Nëpunësi Zbatues, znj. V.K.

**Titulli i Gjetjes 4:** Mungesa e një regjistri kontabël për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale si dhe mangësi në inventarizimin e tyre.

**Situata 1:** Në Bashkinë Këlcyrë, në vitet 2018 dhe 2019 nuk janë përfshirë për inventarizim llogaritë, 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje Plantacione”, 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”, 214 Instalime teknike, makineri e pajisje, 215 “Mjete transporti” dhe aktivet afatshkurtra.

**Situata 2:** Për llogaritë e mësipërme, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, si: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia.

**Situata 3:** Gjatë vitit 2019, mbështetur dhe në udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr. 81 datë 03.12.2019



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

“Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale të Bashkisë Këlcyrë, përfshirë këtu dhe njësitë administrative (Dishnice, Sukë, Ballaban) si dhe institucionet në varësi të bashkisë, për vitin 2017”. Pasi është mbajtur relacioni i vlerësimit, janë identifikuar materiale për nxjerrje jashtë përdorimit për: llogaria 327 Inventar i imët; llogaria 218 Inventari ekonomik si dhe llogaria 214 Instalime teknike makineri e pajisje. Nuk ka një urdhër për ngritjen e komisionit për nxjerrje jashtë përdorimi, por procedohet bazuar në një projekt vendim nr. 295 datë 10.02.2019, për nxjerrje jashtë përdorimi të materialeve të inventarizuara dhe identifikuar për nxjerrje jashtë përdorimi, si dhe pa një urdhër për ngritje komisioni të asgjësimit.

**Situata 4:** Procedura e Inventarizimit të aktiveve nuk është ndjekur për vitin 2018, dhe nuk evidentohet asnjë dokumentacion mbi urdhrin e kryetarit për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2018.

**Kriteri:** Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata, e cila paraqet parregullsi është, ligji nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103.

**Ndikimi/Efekti:** Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë inventarizimin e përvitshëm të tyre, sjell mos pasqyrim të saktë të këtyre vlerave, si rrjedhojë e mungesës së informacionit në mënyrë analitike, për secilin aset si pasojë e mungesës së një regjistri kontabël.

**Shkaku:** Mosnjohje e moszbatim i udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa të menjëhershme:

- Për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
- Për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizimin e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 “Toka, troje terrene”, 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione” 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe “215 “Mjete transporti”, si dhe për ngritjen e komisioneve të posaçme për asgjësimin e aktiveve.

**Konkluzion:** Mungesa e regjistrit të aktiveve dhe mos respektimi i udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” për sa i përket inventarizimit të aktiveve çdo vit, ka sjellë pasiguri në paraqitjen e vlerës së tyre reale në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2018 dhe 2019. Ngritja e urdhrave për inventarizim si



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

dhe krijimi i regjistrit të aktiveve, përbën hapin kryesor në menaxhimin e tyre nga Nëpunësi Autorizues.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Nëpunësi Autorizues z. K.N. dhe Nëpunësi Zbatues V.K.

#### **Titulli i Gjetjes 5: Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitet 2018 dhe 2019.**

**Situata:** Bashkia Këlcyrë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 02/11/2016 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësllës Kanalizime Këlcyrë SHA me NUIS “K492252041” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 21,259,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 21,259,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë në “Ujësllës Kanalizime Këlcyrë SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2018 dhe 2019, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Në rastin tonë investimi përfaqëson aksionet me vlerë kontabël (kosto) 21,259,000 lekë dhe investitori është Bashkia Këlcyrë.

**Kriteri:** Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Urdhri i Ministrit të Financave nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

**Ndikimi/Efekti:** Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, gjendje kjo e nën vlerësuar me 21,259,000 lekë.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” dhe Standardit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investime në Pjesëmarrje”.

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandime:**

Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Këlcyrë” SHA, me vlerë kontabël **21,259,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Konkluzion:** Nga ana e Zyrës së Financës së Bashkisë Këlcyrë, nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë Standardet Kontabël, gjë e cila ka sjellë mos pasqyrim të pjesëmarrjes së kapitalit të vet, si rezultat i pjesëmarrjes 100% të saj në aksionet e UK Këlcyrë SHA, për vlerën e aksioneve në shumën 21,259,000 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. V.K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë edhe të NZ.

**Titulli i Gjetjes 6:** Mbi kontabilizimin e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogaria e 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatime” për vitet 2018 dhe 2019.

**Situata:** Gjatë viteve 2018 dhe 2019 balanca e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton në vlerën 6,078,720 lekë për penaltete dhe kamatëvonesa. Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike, si për vitin 2018 dhe 2019, debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Nga rakordimi me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar detyrimet për vitet 2018 dhe 2019, të cilat janë dërguar me shkresa përcjellëse me nr. 259, datë 01.02.2019, për vitin 2018 dhe nr. 331, datë 14.02.2020 për vitin 2019, Zyrës së Financës dhe sipas tyre, detyrimi paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 3.5 “Debitorët 2018 dhe 2019”

Debitore Bashkia Kelcyre dhe NJA	Gjendje ne 31.12.2018	Gjendja ne 31.12.2019	Pasqyrat Financiare 31.12.2019 (llog.468 Debitore te ndryshem)
Debitore Biznesi i madh	6,738,570	7,759,944	
Debitore Biznesi i vogel	14,040,101	15,093,078	
Debitore nga Taksa e tokes bujqesore	28,855,020	33,207,564	
Debitore nga Taksa e familjes	3,417,735	4,326,395	
<b>Totali</b>	<b>53,051,426</b>	<b>60,386,981</b>	<b>6,078,000</b>

**Pra nuk është pasqyruar vlera e saktë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe kundër partinë Klasa 7 e llogarive “Të ardhurat”, për rrjedhojë nuk janë njohur si të ardhura për vitin 2018, në vlerën 53,051,426 lekë dhe për vitin 2019 në vlerën 60,386,981 lekë.**

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është: ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 10 dhe 11; ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

“Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” ku citohet:

*“Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:*

*Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.*

*Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.*

*Të drejtat. Funkcionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohen (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).*

*Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).*

*Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë:*

*a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:*

**- Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit);**

*Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);*

**- Kreditohet klasa 7 me analiza;**

*Kreditohej 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).*

*b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:*

**- Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;**

**- Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.**

*c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:*

**- Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);**

**- Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;**

**- Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)”**

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformimi i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të taksave dhe tarifave të arkëtueshme paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

#### **Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

#### **Rëndësia:**

E lartë

#### **Rekomandime:**

Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke e debituar për vlerën 53,051,426 lekë për vitin 2018 dhe për vlerën 60,386,981 lekë për vitin 2019. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifave vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyre me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**Konkluzion:** Nga auditimi është evidentuar se, nuk janë pasqyruar saktë detyrimet e subjekteve kundrejt Bashkisë Këlcyre, për vitin 2018 dhe 2019, gjë e cila ka sjellë ndikim në pasqyrimin e të ardhurave për dy vitet respektive.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. V.K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë edhe të NZ.

**Titulli i Gjetjes 7: Mbi kontabilizimin e kontratave të investimit dhe njohjes së të drejtës për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit për këto investime publike për vitet 2018 dhe 2019.**

**Situata:** Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 6,714,053 lekë në vitin 2018 dhe në shumën 7,622,212 lekë në vitin 2019. Në mënyrë analitike kjo llogari ka përfshirë në debi, gjendjet e llogarive kreditore të detyrimeve 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” dhe 435 “Sigurime Shoqërore” për secilin vit përkatës. Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019. Nisur nga Tabela 3.6 “Mbi financimin e pritshëm nga buxheti”, e paraqitur në anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit, në mënyrë grafike janë paraqitur kontratat e lidhura, vlerat me TVSH, detyrimi i prapambetur (468) dhe të drejtat nga operacionet me shtetin (4342). Për sa i përket të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyre, për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit, në lidhje me këto angazhime të ndërmarra gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet duke u bazuar në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32 e tij, ky kontabilizim nuk është bërë, gjë që ka sjellë mos pasqyrimin e detyrimeve të buxhetit kundrejt Bashkisë Këlcyre për shumën 69,955,690 lekë në vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë në vitin 2019, në llogarinë 4342 Operacione me shtetin dhe kundërpartisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

**Kriteri:** Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është: ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, të ligji nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij ku citohet:

*“Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, subjektit i lind e drejta e regjistrimit të pjesës së mbetur të kontratës në vitin përkatës, pasi i ka zbritur likuidimet e vitit, të regjistroj te drejtën në 4342 Operacione me*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*shtetin me kundërparti të ardhurën 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

**Ndikimi/Efekti:** Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyrë ndaj shtetit për angazhimet e ndërmarra me fondet nga buxheti i shtetit, të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, neni 10 dhe 11; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i shfuqizuar, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për shumën 69,955,690 lekë për vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë për vitin 2019. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.

**Konkluzion:** Të drejtat që lindin për financime të pritshme për angazhimet buxhetore të ndërmarra nga subjekti Bashkia Këlcyrë dhe me burim financimi buxhetin e shtetit, nuk janë paraqitur dhe reflektuar në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe Pasqyrën e Performancës Financiare për vitet 2018 dhe 2019. Nga ana e subjektit duhen marrë masa me mbylljen e vitit ushtrimor 2020 për sistemimet e financimeve të pritshme nga angazhimet e ndërmarra.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. V.K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë edhe të NZ.

**Titulli i Gjetjes 8:** **Mbi kontabilizimin e shpenzimeve të periudhave të ardhshme për kontratat e investimeve publike për vitet 2018 dhe 2019.**

**Situata:** Sipas konstatimit dhe analizës që i është bërë këtyre kontratave të tabelës 1 (paraqitur në anekset e këtij projekt raporti), kemi përpunuar të dhënat e subjektit për të evidentuar gjendjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale, si për vitin 2018 ashtu edhe për vitin 2019. Ky përpunim të dhënash është realizuar me qëllim testimin e saktësisë së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” si llogari debitore dhe testimin e saktësisë së llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” si llogari kreditore, të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve (në rastin tonë, për shpenzime kapitale). Duke e bazuar procedurën e testeve të kryera në pikën 42 të udhëzimit nr. 8 datë datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, po paraqesim më poshtë tabelën e kontratave së bashku me gjendjen e detyrimit të prapambetur, i cili



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

duhej të ishte regjistruar në bilancin kontabël 2018 dhe 2019.

**Tabela nr. 3.7**

Viti	Kontrata	Financimi ne PBA					Detyrimi prapambetur 486		
		2017	2018	2019	2020	2021	2017	2018	2019
2017	Rijetëzimi i Pedonaleve dhe hapësirave rekreative ne sheshin gender. (5%G.PUNIMI)	37,227,210	111,555,902				-	4,333,838	4,333,838
	Shtrim i pjeseve te veshtrira te rrugeve rurale dhe permiresim i	14,985,891					12,285,891	7,794	7,794
2018	"Rikonstruksion i Ures ne gender te qytetit Këlcyre" dhe		4,943,420					1,702,870	-
	"Rikonstruksion i rrjetit te brendshem te ujesjellesit Këlcyre, Bashkia Këlcyre, Faza I"		33,038,531	63,952,395				7,567	(7,567)
	permiresimin e kushteve te banimit per komunitete te pafavorizuara,		6,675,378	5,995,727				1	(1)
	Rehabilitim I skemes ujites te rezervuareve		19,143,021					-	-
2019	"Rikonstruksion Shkolla e Mesme Këlcyre" dhe 5% garanci punimi			30,625,000	25,779,874				713
	"Rikonstruksion i rrugeve te lagjes se Spitalit" dhe 5% garanci punimi			5,000,000	29,858,247				-
	rruga, Suke-Podgoran			15,455,000	20,898,317				371
	Ujtitja e fushes Ballaban,			10,000,000	17,384,647				361
	"Ndertim i rrjetit te jashtem te ujesjellesit Këlcyre"			35,625,220	53,437,829	88,403,598			266
	"Supervizim punimesh per Ndertim i rrjetit te jashtem te ujesjellesit			521,248	781,871	977,692			-
<b>Total</b>		<b>52,213,101</b>	<b>175,356,252</b>	<b>167,174,590</b>	<b>148,140,785</b>	<b>89,381,290</b>	<b>12,285,891</b>	<b>6,052,070</b>	<b>4,335,775</b>

Në Bilancin Kontabël për vitin 2018 dhe 2019 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundër partia 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2018 paraqitet në vlerën 386,712 dhe për vitin 2019 paraqitet në vlerën 630,628 lekë. Pra shihet qartë se detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën **6,052,070 lekë**, për vitin financiar të mbyllur 2018 dhe **4,335,775 lekë**, për vitin financiar të mbyllur 2019.

Duhet thënë se këto llogari, gjithashtu nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre për vitin 2019, për shkak edhe të mos njohjes së detyrimit që ka lindur në vitin 2019, referuar datës së faturës, por që është likuiduar (lëvizja cash) në vitin 2020, për vlerën **20,109,193 lekë**.

Në rastet e mësipërme, është shkelur një nga parimet kryesore të kontabilitetit “të drejtat dhe detyrimet e konstatuara”, pra evidentimi i shpenzimeve në kontabilitet në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

**Kriteri:**

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është: neni 6 i ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; neni 10 dhe 11, i ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; neni 5, 6, 7, 9 dhe 10 i Urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

financiare” ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve; ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42 e tij ku citohet:

*“Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjtit të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”), subjektit i lind e drejta e regjistrimit të pjesës së mbetur të kontratës në vitin përkatës, pasi i ka zbritur likuidimet e vitit, të regjistroj te drejtën në 4342 Operacione me shtetin me kundër parti të ardhurën 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të shpenzimeve të periudhave të ardhshme në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare si dhe mos regjistrimi i faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2020 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2019

#### **Shkaku:**

Mos njohja dhe mos zbatimi i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ligjit nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe i udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

#### **Rëndësia:**

E lartë

#### **Rekomandim:**

- Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 6,052,070 lekë për vitin financiar të mbyllur 2018 dhe 4,335,775 lekë për vitin financiar të mbyllur 2019, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej 20,109,193 lekë e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2020, por që detyrimi ka lindur në vitin 2019, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.
- Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyre me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**Konkluzion:** Sa më sipër, arrijmë në konkluzionin se Përgjegjësi i Financës së Bashkisë Këlcyre, nuk ka koncepte të drejta mbi momentin e regjistrimit të shpenzimeve, referuar akteve ligjore, parimeve dhe standardeve të fushës, duke sjellë mos evidentim të saktë të detyrimeve të prapambetura të njësisë, si dhe mos raportim të saktë dhe real të këtyre detyrimeve, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Znj. V.K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë edhe të NZ.

**Titulli i Gjetjes 9:** **Mbi kontabilizimin e llogarisë 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime” dhe llogarisë 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” për vitet 2018 dhe 2019.**

**Situata:** Për të dyja vitet ushtrimore 2018 dhe 2019, këto llogari paraqiten në vlerat zero lekë. Duke marrë informacion në lidhje me vendimet gjyqësore të formës së prerë, specifikisht vendimin nr. 604 datë 14.11.2018 të paditësit Spiro Çoma dhe vendimin nr. 2068 datë 01.07.2019 të paditësit Mysafer Kasaj, vendime të cilat kanë kaluar shkallën e parë të gjyqësorit dhe nuk janë apeluar, konstatojmë se nuk janë kontabilizuar dhe paraqitur në bilancin kontabël 2018 dhe 2019. Sipas udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 34 dhe sipas Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” përcaktohet qartë njohja në kontabilitet e provigjionit që lind për shkak të një vendimi gjyqësor të formës së prerë në momentin fillestar.

**Kriteri:** Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është: ligji 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 34, ku cilësohet: *“Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t’u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë...”* Urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”.

**Ndikimi/Efekti:** Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar, të llogarisë 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime” për vitet 2018 dhe 2019 dhe llogarisë së Pasqyrës së Performancës Financiare, llogaria 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” për vitet 2018 dhe 2019.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”.

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet, në kredi të llogarisë 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime” dhe debi të llogarisë 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” në momentin e njohjes së tyre, për vitet 2018 dhe 2019, respektivisht për vlerat 150,000 lekë dhe 579,000 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

**Konkluzion:** Nga Bashkia Këlcyrë, nuk janë marrë masa për evidentimin e rasteve të detyrimeve për shkak të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke sjellë vështirësi në të ardhmen në aftësitë likuiduese.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Nëpunësi Zbatues znj. V.K.

Për sa është trajtuar më lart (pika 3 e Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 15 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/19, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 39-56. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.

#### 4. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

Për vlerësimin, dhënien e një konkluzioni dhe opinionin për përputhshmërinë në procedurat e prokurimit publik me objekt “Punët publike” nga grupi i auditimit u auditua:

- 4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrave të prokurimeve;
- 4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;
- 4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit:
  - 4.3.1. Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit, hartimi i DT dhe miratimi i tyre;
  - 4.3.2. Mbi përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit);
  - 4.3.3. Mbi vlerësimin e OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO);

##### 4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

**Titulli i Gjetjes 1:** Mbi programimin e nevojave.

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se, nuk ka patur bashkëpunim dhe bashkërendim, midis strukturave përkatëse, për kryerjen e procedurave dhe ndjekjen e hapave për planifikimin e fondeve referuar nevojave. Nuk ka patur bashkëpunim si brenda Bashkisë Këlcyrë, po ashtu edhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- me Njësitë administrative, përsa i përket mbledhjes së kërkesave nga strukturat dhe sektorët përkatës, përpunimin e tyre në nivel institucional, me qëllim planifikimin burimeve të financimit, nëpërmjet planifikimit të tyre në PBA dhe Planeve vjetore të buxhetit.
- Kriteri:** Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standard të përgatitjes së PBA-së, të njësisive të vetëqeverisjes vendore”.
- Ndikimi/Efekti:** Mos zbatimi i hapave të nevojshëm në planifikimin e nevojave dhe mbulimin e tyre me financim, sjell planifikim jo real të fondeve buxhetore dhe rrezikun e mos përfshirjes të gjithë nevojave dhe për rrjedhojë rritjen e mundësisë së mos arritjes së objektivave.
- Shkaku:** Njohje e përcipte e legjislacionit, mos angazhim i stafit, mungesë e funksionimit të MFK, GMS, si dhe e Titullarit në cilësinë edhe të NA, si personi i cili duhet të drejtojë dhe monitorojë këtë proces.
- Rëndësia:** E mesme
- Rekomandime:** Nga Titullari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, me qëllim përmirësimin e procedurave dhe procesit të planifikimit të buxhetit, si atë afatmesëm dhe buxheteve vjetore, duhet të marrë masa që në të ardhmen të nxjerrë urdhra/udhëzime të brendshme, për përcaktimin e hartimin e PBA dhe planeve vjetore të buxhetit, duke nisur me përllogaritjen sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse të nevojave, për çdo veprimtari të njësisive të vetëqeverisjes vendore, në nivel programi dhe për çdo zë të shpenzimeve buxhetore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues.

#### **Mbi regjistrat e prokurimeve publike.**

Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar Regjistri i parashikimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitet 2018 dhe 2019.

Regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe realizimit për vitin 2018 është dërguar në Degën e Thesarit Përmet dhe në APP me shkresën përcjellëse nr. 510, datë 12.03.2018 dhe për vitin 2020 i është dërguar Degës së Thesarit Përmet, me shkresën nr. 162, datë 28.01.2020. Mungonte shkresa përcjellëse për dërgimin e regjistrit të parashikimit për vitin 2019.

Juristi i prokurimeve dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 1 ku cilësohet: “Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së”.

Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM neni 4, pika 3, ku cilësohet: “Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet shtetërore apo çdo autoritet kontraktor tjetër jo buxhetor përgatitin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse”.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit nuk ka patur ndryshim të regjistrit të parashikimeve, për të cilat nevojitet buxhetim i tyre. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 4, pika 4 ku cilësohet: “Autoriteti





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara. Çdo ndryshim i regjistrin të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem...”*

#### **4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.**

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit për investime publike për vitin 2018 dhe 2019, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Programi buxhetor Afatmesëm 2016-2018; 2017-2019 dhe 2018-2020;
- Plani Buxhetit për vitin 2018 dhe 2019;
- Fakti i buxhetit për vitin 2018 dhe 2019;
- Regjistri i Parashikimeve për periudhën 2018-30.06.2020;
- Regjistri i Realizimeve për periudhën 2018-2019.

**Tabela nr. 4.1 “Projektet dhe burimi i financimit”**

Nr.	Emërtimi	Viti 2018			
		Parashikim	Burimet e financimit		
			PBA 2018-2020	Buxheti i shtetit 2018	Të ardhurat e veta
1	Rikonstruksion i Rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Këlcyrë	81,041,904	-	MFE	-
2	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit	13,907,037	-	MFE	-
3	Rikonstruksion Ura në Qendër të Qytetit Këlcyrë	4,166,666	3,000,000	-	5,000,000
4	Rikonstruksion i shkollës së Mesme Këlcyrë	47,767,144	-	MFE	-
5	Sistemim asfaltim Rruga Sukë- Goricë, Podgorie, Fushë, Komarak, Vinok	37,211,972	-	MFE	-
6	Rikonstruksion i Rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë	151,169,770	-	MFE	-
7	Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit	29,653,301	-	-	5,000,000
8	Skema ujitëse Ballaban Ujitja e fushës Ballaban	23,308,514	-	MFE	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë

Punoi: KLSH

#### **1. Rikonstruksion i Rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Këlcyrë**

Burimi i financimit është buxheti i shtetit për vitin 2018, miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4790/16, datë 23.05.2018 me vlerë të plotë 97,515,589 lekë.

Viti 2018-33,038,531 lekë

Viti 2019-67,184,2018 lekë

Ky projekt është miratuar me VKB nr. 89, datë 25.07.2018 “Për miratim projekti për kryerje investimesh”. Urdhri i prokurimit datë 24.05.2019.

#### **2. Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit**

Burimi i financimit është buxheti i shtetit. Fond i alokuar nga Ministria e Financave në kuadër të thirrjes së MF nr. 13526 datë 13.07.2018, për dorëzimin e projekteve nga NJVV, përmirësimin të kushteve të strehimit në total 16,688,445 lekë, Financimi sipas viteve:

Viti 2018-6,657,378 lekë

Viti 2019-e papërcaktuar

Urdhër prokurimi datë 27.07.2018.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### **3. Rikonstruksion Ura në Qendër të Qytetit Këlcyrë**

Burimi i financimit të ardhurat e veta. Planifikimi i fondeve për financimin e këtij objekti ka mospërputhje. Në PBA 2018-2020, është planifikuar fondi prej 3,000,000 lekë dhe në Planin e vitit 2018 është planifikuar vlera e plotë në shumën 5,000,000 lekë, e cila është miratuar me VKB nr. 29, datë 26.01.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018”. Urdhri prokurimit 22.05.2018.

#### **4. Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Këlcyrë**

Burimi i financimit është buxheti i shtetit. Në PBA dhe në planin vjetor të buxhetit të vitit 2018, nuk janë planifikuar fonde buxhetore për këtë objekt. Në vitin 2019 me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2656/1, datë 23.03.2019 janë alokuar fonde në shumën 30,625,000 lekë. Ky projekt është miratuar me VKB nr. 89, datë 25.07.2018 “Për miratim projekti për kryerje investimesh”. Urdhër prokurimi datë 11.11.2018.

#### **5. Sistemim asfaltim Rruga Sukë, Goricë, Podgorie, Fushë, Komarak, Vinok**

Burimi i financimit është buxheti i shtetit, referuar shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 17585, datë 26.12.2016 në shumën 75,000,000 lekë. Urdhri i prokurimit datë 24.12.2018.

#### **6. Rikonstruksion i Rrjetit të jashtëm të ujësjetës Këlcyrë**

Burimi i financimit është buxheti i shtetit sipas shkresës së MFE dhe AKUK nr. 1632, datë 31.05.2019 me vlerë të plotë objekti në shumën 181,128,096 lekë për t’u financuar si më poshtë:

Viti 2019-35,625,220 lekë

Viti 2020-53,437,829 lekë

Viti 2021-89,063,089 lekë

Urdhri i prokurimeve datë 04.07.2019.

#### **7. Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit**

Burimi i financimit është nga të ardhurat e veta, të planifikuara në buxhetin e vitit 2019, miratuar me VKN nr. 4, datë 04.01.2019 për shumën 5,000,000 lekë dhe pjesa tjetër në vitet pasardhëse. Urdhri i prokurimit datë 26.02.2019.

#### **8. Skema ujitëse Ballaban ujitja e fushës Ballaban**

Burimi i financimit buxheti i shtetit. Financimi i këtij objekti është bërë sipas VKM nr. 170 datë 27.03.2019 për shumën totale 27,970,217 lekë, ndarë sipas viteve:

Viti 2019-10,000,000 lekë

Viti 2020-17,970,217 lekë

Urdhri i prokurimit datë 24.04.2019.

**Konkluzion:** Fillimi (nxjerrja e urdhër prokurimeve) dhe kryerja e procedurave të prokurimit publik, është realizuar pas miratimit dhe angazhimit të fondeve publike, për financimin e projekteve për punë publike, të zhvilluara gjatë vitit 2018 dhe 2019, me burim financimi nga buxheti i shtetit apo nga të ardhurat e Bashkisë Këlcyre.

#### **Titulli i Gjetjes 2: Mbi rregullshmërinë e angazhimit të fondeve.**

##### **Situata:**

- Me qëllim disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, si dhe eliminimin e rasteve të fillimit të procedurave të prokurimit publik, pa patur fonde në dispozicion është kërkuar që Njësia e Prokurimit, duhet të posedojë përpara fillimit të procedurës së prokurimit “Kërkesën për marrje angazhimi”. Nga auditimi rezultoi se në asnjë prej procedurave të zhvilluara nuk ndodhej në dosjet përkatëse “Kërkesa për marrje angazhimi” dhe konfirmimi i saj nga NA dhe NZ.
- Nga AK nuk është depozituar në Degën e Thesarit, Urdhri i Prokurimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

përpara hapjes së procedurës së prokurimit me qëllim, konfirmimin e Degës së Thesarit, për disponibilitetin e fondeve përkatëse për çdo procedurë prokurimi.

#### Kriteri:

- Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 153-155, ku cilësohet: *“Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë/nën programit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.*

*Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatues.*

*Nëpunësi zbatues bën krahasimin me nivelin e planifikuar të shpenzimeve për aktivitetin/nen programin/programin buxhetor respektiv, kryen gjithashtu kontrollin e përputhshmërisë ligjore dhe paraqet opinionin pranë nëpunësit autorizues. Opinioni mund të paraqitet me shkrim veçmas nga kërkesa për shpenzim, ose mund të nënshkruhet direkt nga nëpunësi zbatues në rast se është konform rregullave...”.*

- Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 154 ku cilësohet se: *“Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për Urdhrin e Prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit”;*

- Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me ndryshime “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” pika 7 ku cilësohet: *“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, kontabilitetin dhe raportimin e buxhetit të njësisë publike me qëllim përdorimin me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike. Çdo transaksion që lidhet me shpenzimet publike duhet të procedohet mbi bazën e të paktën tre niveleve të kontrollit (nënshkrimeve), respektivisht të kërkuesit të shpenzimit, nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues të çdo niveli të njësisë shpenzuese”.*

#### Ndikimi/Efekti:

Mosrespektimi i disiplinës, buxhetore sjell fillimin e procedurave dhe marrjen e angazhimeve buxhetore, pa patur në dispozicion fondet buxhetore për financimin e shpenzimeve. Kjo situatë shkakton



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

vështirësi financiare dhe rritjen e detyrimeve të Bashkisë Këlcyrë kundrejt OE.

**Shkaku:** Njohje e përciptë e legjislacionit, mungesë stafi.

**Rëndësia:** E ulët

**Rekomandime:** Titullari i Autoritetit Kontraktor në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues, NJP dhe Nëpunësi Zbatues me qëllim eliminimin e mundësive, për marrje angazhimesh pa fonde në dispozicion, të marrin masa të menjëhershme që:

- NJP, fillimin e çdo procedure prokurimi, duhet së pari ta mbështesë në Kërkesën për marrje angazhimi, nga struktura përkatëse dhe konfirmimin e saj nga NZ dhe NA;

- NJP, duhet të përcjellë Urdhër Prokurimin tek Nëpunësi Zbatues me qëllim që ky i fundit të kryejë depozitimin e tij Degën e Thesarit, përpara fillimit të procedurës, për të konfirmuar disponibilitetin e fondeve në Degën e Thesarit, për çdo objekt investimi.

**Konkluzion:** Njësia Shpenzuese “Bashkia Këlcyrë”, përsa i përket zbatimit të disiplinës buxhetore dhe fillimit të procedurave pas marrjes së kërkesave dhe konfirmimit mbi disponibilitetin e fondeve, nuk ka treguar kujdesin e duhur, gjë e cila rrisht fillimin e procedurave pa fonde dispozicion.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Titullarit të Autoritetit Kontraktor, referuar Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Përgjegjësia e Titullarit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme”, pika 40 ku cilësohet: “*Nëpunësi Autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat dhe programet buxhetore, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë së qeverisjes së përgjithshme*”.

#### **4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).**

**Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan:**

- Dosjet e procedurave;
- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni që plotësohet nga AK;
- Korrespondenca me APP dhe KPP;
- Dokumentacioni mbi angazhimin e fondeve buxhetore, etj.
- Dokumentacioni i hedhur në SPE.

**Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

**Titulli i Gjetjes 3: Mbi funksionimin e strukturës së prokurimeve.**

**Situata:** Nga ana e Titullarit të AK nuk është përcaktuar “Personi përgjegjës për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Kriteri:** prokurimet publike”. Nuk ka shkresë drejtuar APP-së për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimet. Juristi i NJP është person i kontraktuar dhe jo punonjës i Bashkisë Këlcyrë. Nga auditimi ka rezultuar se administrimi i Dosjeve të prokurimit është bërë nga Juristi. Ky veprim është në kundërshtim me VKM neni 57, pika 1, ku cilësohet:
- “Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/ personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik. Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t’u zhvilluar, autoriteti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin”.*
- Ndikimi/Efekti:** Aktualisht nuk ka patur ndikim, pasi nga ana e juristit të kontraktuar është kryer administrimi i dosjeve të prokurimit, por mos përcaktimi i një personi përgjegjës për prokurimit, pjesë e stafit të Bashkisë përveç se është detyrim ligjor, do të rriste përgjegjshmërinë.
- Shkaku:** Mosveprim i Titullarit të AK, si rezultat i mungesës së stafit.
- Rëndësia:** E ulët
- Rekomandime:** Titullarit të AK të marrë masa për përcaktimin e “Personit përgjegjës për prokurimet publike”, si dhe dërgimin e shkresës emëruese në APP.

**Konstatim:** Pothuajse në të gjitha procedurat e zhvilluara dhe të audituara ka rezultuar se, urdhrat e Titullarit të AK, të përcaktuar në VKM 914, datë 29.12.2014 me ndryshime neni 57, duke filluar nga, Urdhri për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Urdhri i Prokurimit, Urdhri për ngritjen e KVO-së, Procesverbali për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Procesverbali për miratimin e DT i hartuar nga NJP, në të cilin janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, mbajnë të njëjtën datë, gjë për të cilën gjykojmë se afati prej 1 dite është kohë e cila praktikisht është e pamjaftueshme për kryerjen e këtyre procedurave.

#### **Mbi administrimin e dosjeve nga NJP:**

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se:

**Konkluzion:** Në përgjithësi nga Juristi i prokurimeve, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për t’u plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar dhe ka reflektuar të gjitha rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj.

Nga ana e Juristit të prokurimeve janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve (me përjashtim të kërkesës për angazhim të fondeve, si dhe mungesës së vulave të Degës së Thesarit në Urdhrin e prokurimit) ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.

Sa më sipër, Juristi i prokurimeve ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

#### 4.3.1. Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi 2018-2019 ka rezultuar se, kriteret për përmbushjen e kapacitetit teknik dhe ekonomik financiar janë përcaktuar në përputhje me objektin e prokurimit, vlerën limit të kontratës, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

**Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:**

- Titulli i Gjetjes 4:** Mbi përcaktimin dhe argumentimin e kriterëve kualifikues nga NJP
- Situata 1:** - Në "Kriteret e veçanta për kualifikim", përsa i përket numrit të punonjësve dhe stafit teknik, që duhet të disponojë OE për realizimin e kontratës, nga ana e NJP në asnjë prej procedurave nuk është dhënë asnjë argument mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve dhe të stafit teknik. Për këtë shkak nuk mund të gjykohet nëse kjo kërkesë është në raport të drejtë me objektin, volumet dhe vlerën e kontratës.
- Situata 2:** - Përsa i përket përmbushjes së kriterit mbi punët e të njëjtës natyrë apo ngjashme të realizuar në sektorin privat, në të gjitha procedurat, është kërkuar që OE përveç dokumentacionit i cili vërteton kryerjen me cilësi dhe në kohë të kontratës, të paraqesë edhe Lejen e ndërtimit për objektin e realizuar. Kjo kërkesë nuk ka të bëjë me qëllimin e përmbushjes së këtij kriteri nga OE në garë, si dhe është në kundërshtim me kërkesat ligjore të fushës së prokurimeve.
- Situata 3:** - Në DT është kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin kontratë paraprake furnizimi për materiale sipas specifikimeve teknike, të shoqëruar nga katalogët përkatës. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesin:  
Kontratë paraprake;  
Certifikatë ISO 9001:2015 të furnitorit apo distributorit të autorizuar;  
Certifikatën e cilësisë dhe origjinës së materialeve të furnitorit.  
Kërkesa për paraqitje të certifikatave ISO nga prodhuesi, i cili nuk është pjesëmarrës në konkurrim, nuk është e nevojshme. Kjo është argumentuar edhe nga APP me Njoftimin nr. 8197, datë 03.09.2018 "Rekomandime", pika 2.
- Kriteri 1:** Ky veprim është në kundërshtim me VKM neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2 ku cilësohet: "*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit*".
- Kriteri 2:** Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nenin 26 pika 6 germa b ku cilësohet: "*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

*punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve".*

#### **Kriteri 3:**

Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 30 "Kërkesat e cilësisë", pika 1 ku cilësohet: "Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, **mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit".**

#### **Ndikimi/Efekti:**

Përcaktimi i kriterëve jo të qarta, jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe kriterëve të panevojshme, ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë, por dhe në mos përmbushjen e kriterëve nga ana e tyre për shkak të pa qartësive.

#### **Shkaku:**

Moszbatim i kërkesave ligjore, nënligjore dhe DST nga ana e NJP.

#### **Rëndësia:**

E mesme

#### **Rekomandime:**

Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP), për çdo rast në përcaktimin e kriterëve kualifikuese, duhet të:

- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kriterë të veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, dhe për çdo rast duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës që mbahet për këtë qëllim;

-nuk duhet të vendosë kërkesa, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në DT.

#### **Titulli i Gjetjes 5: Mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese në disa procedura prokurimi**

##### **Situata 1:**

Në procedurën e prokurimit me objekt "Skema ujitëse Ballaban, ujitja e fushës Ballaban (vazhdimi)", në pikën 2.3.6 nuk është cilësuar saktë dokumentacioni i cili duhet të paraqitet për përmbushjen e kriterit mbi dokumentacionin që duhet të paraqesin OE për makineritë dhe pajisjet. Në DT cilësohet: "Leje transporti që lëshohet nga njësia vendore", ndërkohë që duhet të cilësonin saktë këtë kërkesë duke kërkuar "Leje transporti për përdorim për të tretë". Për mos përmbushje të kësaj kërkesë është s' kualifikuar OE "M.S." SHPK.

##### **Situata 2:**

Në procedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë", AK ka bërë ftesë për 5 OE, për pjesëmarrje në garë, në zbatim të LPP nenit 34 "Kërkesa për propozime", nenit 36 "Rregullat e zbatueshme të prokurimeve elektronike" dhe VKM neni 39. Megjithatë theksojmë se, pavarësisht ftesës për pjesëmarrje të 5 OE nëpërmjet SPE nga ana e NJP, nuk janë dokumentuar dhe argumentuar kriteret e përzgjedhjes së 5 OE, për pjesëmarrje në këtë garë.

#### **Kriteri 1**

-Ky veprim është në kundërshtim me VKM, neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5 ku cilësohet: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

#### **Kriteri 2:**

Ky veprim është në kundërshtim me LPP, neni 34 “Kërkesa për propozim”, pika 2 ku cilësohet: “Kur autoriteti kontraktor përdor komunikimin elektronik, ai duhet të publikojë një njoftim elektronik, sipas nenit 39 pika 4 të këtij ligji dhe të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik” dhe VKM neni 39, pika 4 ku cilësohet: “Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë”.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Përcaktimi i kriterëve jo të qarta, jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe kriterëve të panevojshme, ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë, por dhe në mos përmbushjen e kriterëve nga ana e tyre për shkak të pa qartësisë.

#### **Shkaku:**

Mosbatim i kërkesave ligjore, nënligjore dhe DST nga ana e NJP.

#### **Rëndësia:**

E mesme

#### **Rekomandime:**

Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP) në përcaktimin e kriterëve kualifikuese, duhet të përcaktojë dhe cilësojë saktë dokumentacionin i cili duhet të paraqitet nga OE, për përmbushjen e kriterëve kualifikuese.

#### **Konkluzion:** Përsa është trajtuar në këtë pikë, rezulton se:

- Në lidhje me administrimin e dosjeve të prokurimit dhe ndjekjen e procedurave, NJP ka vepruar në përputhje me detyrat e përcaktuara në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”;
- Në lidhje me përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim përgjithësisht është vepruar në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime nenin 26 “Kontrata për punë publike” dhe nenin 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, por u evidentuan disa raste (të përshkruara më lart) të përcaktimit të kriterëve jo të qarta, jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe kriterëve të panevojshme, gjë e cila ndikon në pjesëmarrjen e OE në garë, por dhe në mos përmbushjen e kriterëve nga ana e tyre për shkak të pa qartësisë në DT.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Njësia e Prokurimit, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime nenin 57 , “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.3 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 3 datë 16.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/2, datë 16.09.2020, si dhe është trajtuar në PRA faqe 56-113. Mbi këtë pjesë të PRA, janë paraqitur observacionet nga Juristja e NJP, znj. AQ, me shkresën nr. 3150 datë 15.12.2020, protokolluar në KLSH me nr. 612/6, datë 17.12.2020, për sa më poshtë:**

#### **Pretendimi i subjektit të audituar.**

1. NJP, ka kryer njoftimin e 5 OE në përputhje me dispozitat ligjore, mbi proceduarën e prokurimit “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë”, e llojit “Kërkesë për





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

propozim”, si dhe ka përzgjedhur operatorë ekonomikë të cilët e kanë në fushë veprimtarie.

2. Mbi kërkesën e certifikatave ISO 9001:2008 dhe 14001:2004, nga NJP është vepruar në përputhje me kërkesat ligjore. NJP, ka vepruar në përputhje me LPP, neni 46, pika 2 përsa i përket kërkesës për paraqitje të certifikatave ISO 9001:2015, nga OE pjesëmarrës në garë si dhe nga prodhuesi apo distributori, për furniturat.
3. NJP pretendon se, Urdhri për përcaktimin e grupit të punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, përcaktimin e specifikimeve teknike, Urdhri i prokurimit, Urdhri për përcaktimin e KVO-së, Procesverbali i NJP për miratimin e DT, Procesverbali për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk kanë përcaktim afatesh në aktet ligjore.
4. NJP, pretendon se përcaktimi i numrit të punonjësve dhe stafit teknik është bërë në përputhje me objektin e kontratës dhe volumin e punimeve.
5. NJP, pretendon se kërkesa për përmbushjen e kriterit mbi punët e ngjashme nga OE pjesëmarrës në garë, e cila ka të bëjë me paraqitjen e lejeve të ndërtimit kur kontratat janë realizuar me OE privatë është në përputhje me aktet ligjore, si dhe është diskrecion i NJP.
6. NJP, pretendon se ka përcaktuar kërkesën për kualifikim mbi paraqitjen e “Lejes së transportit” nga NJVV në përputhje me kriteret ligjore.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit**

1. NJP, nuk ka dokumentuar përzgjedhjen e 5 OE dhe nuk e ka dokumentuar atë, sipas kërkesave të VKM neni 39, pika 4 ku cilësohet: “Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë”.

Pretendimi juaj nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.

2. Në bazën ligjore (neni 46 i LPP-së) të cituar nga NJP, si argument për të kundërshtuar konstatimin e Grupit të auditimit, citohet: “2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. 3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik. Pra ligji kërkon përmbushjen e kriterëve nga OE pjesëmarrës. Gjithashtu, në nenin 30 “Kërkesat e cilësisë”, citohet: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit” dhe pika 2. “Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”. Pretendimi i NJP, nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.
3. Pretendimi i NJP qëndron dhe nga Grupi i auditimit nuk është cituar ndonjë bazë ligjore, pasi nuk ka një afat mbi gjenerimin e këtyre akteve, por gjykojmë se nuk ka asnjë mundësi praktike që brenda të njëjtës ditë, të vlerësohen specifikimet teknike, të kontrollohet preventivi me çmimet dhe analizat përkatëse, të hartohet procesverbali përkatës, ku të përcaktohet fondi limit nga Grupi i punës, i cili është përcaktuar me urdhër po në të njëjtën ditë. Gjithashtu, po në të njëjtën ditë të hartohet Urdhri i prokurimit. Po në të njëjtën ditë NJP, të hartojë dhe përcaktojë kriteret kualifikuese, pasi është njohur me objektin e kontratës, specifikimet etj., si dhe të hartojë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

procesverbalin përkatës. Të gjitha këto procedura kërkojnë ndjekjen e një radhe, si dhe kohën për t'u përgatitur, gjë e cila nuk është e mundur të kryhet brenda një dite. Për këtë arsye, tërheqim vëmendjen NJP.

4. Argumentet e NJP, nuk ka të bëjë më atë ç' ka është konstatuar nga Grupi i auditimit. Në PRA, ne kemi evidentuar faktin se, nga NJP nuk është dhënë asnjë sqarim dhe argumentim, mbi përcaktimin e numrit të punonjësve dhe stafit teknik, kjo referuar Procesverbalit të mbajtur mbi miratimin e kriterëve dhe DT. Pretendimi i NJP nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.
5. Siç kemi sqaruar edhe në fazën e PRA, nga NJP nuk mund të vendosen kërkesa të cilat nuk kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterit të veçantë kualifikues, i cili është përcaktuar qartë se ç' farë kërkon. Për më tepër referuar ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 neni 8, detyrimi mbi pajisjen me leje ndërtimi, është jo vetëm për subjektet private, por edhe ato publike, pra kërkesa juaj është diskriminuese. NJP nuk mund të veprojë si agjente për llogari të strukturave të tjera të cilat kanë detyrë funksionale zbatimin e ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për punimet në ndërtim”. Pretendimi i NJP nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.
6. Argumenti i paraqshtruar nga NJP, se kjo procedurë ka qenë në monitorim nga APP dhe nuk e ka konsideruar këtë kriter si të pa qartë, nuk merret në konsideratë. Grupi i auditimit në gjykimin e tij i është referuar kërkesave të ligjit, si dhe faktit që NJQV lëshojnë licenca transporti për qëllime të ndryshme (për përdorim vetjak dhe për përdorim për të tretë). Për këtë arsye kërkesa duhet të jetë e qartë dhe e specifikuar kërkesa për dokumentacionin që duhet të paraqitet. NJP duhet të cilësonte “Leje transporti për përdorim për të tretë” dhe jo thjesht “Leje transporti”. Pretendimi i NJP nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.

#### **4.3.2. Mbi përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondi limit)**

Nga Grupi i auditimit u analizua përlllogaritja e vlerës limit të kontratës (sipas tabelave anekse

nr. 4 “Mbi testet e kryera mbi përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës”, bashkëngjitur RPA-së) për 5 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2018 dhe për 3 procedura prokurimi të zhvilluara në vitin 2019.

#### **Konkluzion:**

- Nga AK është vepruar sipas përcaktimit të bërë në LPP neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, ku një prej mënyrave të përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës, është referimi tek manualët e çmimeve.
- Në përputhje me këtë kriter ligjor nga AK, përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është bërë referuar manualeve të çmimeve të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.
- Nga testimet e kryera për zërat kryesorë të punimeve, rezultoi se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës në të gjitha procedurat ishin respektuar çmimet përmbledhëse për njësi, si dhe ishin shoqëruar me analizë çmimi në të gjitha rastet kur ato nuk ishin përfshirë në manualët përkatës.
- Nga krahasimi i çmimeve të preventivuara me çmimet e Manualeve të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, nuk rezultuan diferenca, me përjashtim të rastit të mëposhtëm:

**Titulli i Gjetjes 6: Mbi përlogaritjen e vlerës limit të kontratës me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Bashkia Këlcyrë”.**

**Situata:** Përsa i përket zërit të punimeve 2.197 “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”, u konstatua:

- Për zërin e punimeve “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”, në kapitullin “**Punime për dhomën e shërbimit personeli**”, çmimi për njësi është vendosur gabimisht në shumën 12,312 lekë/m<sup>2</sup>, nga 1,232 lekë/m<sup>2</sup> që e ka manuali nr. 2, duke krijuar një diferencë në shumën 249,300 lekë, e preventivuar më shumë.  $(1,232 \times 22.5 = 27,720) - (12,312 \times 22.5 = 277,020) = 249,300$  lekë preventivuar më shumë.

- Për zërin e punimeve “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”, në kapitullin “**Punime për dhomën e pompave**”, çmimi për njësi është vendosur gabimisht në shumën 12,312 lekë/m<sup>2</sup>, nga 1,232 lekë/m<sup>2</sup> përcaktuar në Manualin nr. 2, duke krijuar një diferencë në shumën 277,000 lekë, e preventivuar më shumë.

$(1232 \times 25 = 30,800) - (12312 \times 25 = 307,800) = 277,000$  lekë.

- Për zërin e punimeve “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”, në kapitullin “**Punime për dhomën e komandimit +Rikonstruktion depo 700 m<sup>3</sup>**”, çmimi për njësi është vendosur gabimisht në shumën 12,312 lekë/m<sup>2</sup>, nga 1,232 lekë/m<sup>2</sup> përcaktuar në Manualin nr. 2, duke krijuar një diferencë në shumën 277,000 lekë, e preventivuar më shumë.

$(1232 \times 25 = 30,800) - (12312 \times 25 = 307,800) = 277,000$  lekë.

**Vlera limit e kontratës është përlogaritur 803,300 lekë më shumë.**

**Kriteri:** Manualet e miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Preventivi është i shoqëruar me analizat e çmimeve, analizat e kostos për çdo zë të preventivit për punimet civile dhe hidraulike, në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime pika 3.1 ku cilësohet: *Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” (pika 9). Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv.*

**Ndikimi/Efekti:** Ka ndikuar në rritjen fiktive të vlerës limit të kontratës për shumën



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

803,300 lekë pa TVSH, si dhe referuar ofertës fituese është paraqitur me një ulje më pak se kjo shtesë e vlerës limit të kontratës.

**Shkaku:**

Rezulton sipas gjykimit më shumë si gabim njerëzor. (1,232/12,312)

**Rëndësia:**

E mesme

**Rekomandime:**

Titullari i AK, të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **353,600 lekë**, si diferencë midis vlerës së fondit limit të përlllogaritur më tepër, në shumën 803,300 lekë, me diferencën midis këtij fondi dhe ofertës fituese, e cila është në shumën 449,700 lekë. (803,300 – 449,700 = 353,600 lekë).

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Komisioni i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit, i përcaktuar me Urdhrin datë 24.05.2019 dhe i përbërë nga z. S.V. dhe B.I., të cilët nuk kanë bërë verifikimet e duhura mbi preventivin e paraqitur nga OE “Z.C” SHPK.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.3.2 të Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/9, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 56-113 . Mbi këtë pjesë të PRA janë paraqitur observacionet nga z. B.I. dhe z. S.V., me shkresë nr. 3149, datë 15.12.2020, protokolluar në KLSH me nr. 612/6, datë 17.12.2020, në cilësinë e personave të ngarkuar me përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, sa më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit:**

Grupi i auditimit në aktin e konstatimit si dhe në projekt raport citojnë se rezultuan diferenca të zërit të punimeve nr.2.197 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa k katërma, duke bërë që vlera limit e kontratës të përlllogaritet 803,300 lekë më shumë si dhe duke lënë përgjegjësinë komisionit të përlllogaritjes të fondit limit për shkak se nuk ka bërë verifikimet e duhura të preventivit të projektuesit “Z.C.” sh.p.k.

Lidhur me pretendimin e ngritur më lart citojmë se në fushën e studimit dhe të projektimit të një objekti janë shoqëritë të liçensuara sipas vendimit nr.759, datë 12.11.2014 ato që hartojnë projektin, specifikimet teknike, preventivin për një objekt të caktuar.

Përsa cituam më lart është shoqëria projektuese ajo e cila duhej të përlllogariste saktë fondin limit të procedurës me objekt” Ndërtimi i Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë”. Për rrjedhojë ky pretendim i grupi të auditimit nuk qëndron dhe nuk duhet të përfshihet si shkelje për komisionin e përlllogaritjes të fondit limit në hartimin e raportit përfundimtar.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Me Urdhrin datë 24.05.2019, Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka përcaktuar Grupin e punës “Për përlllogaritjen e fondit limit”, të përbërë nga: S.V. dhe B.I.

Në Procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim më datë 24.05.2019, Grupi i punës (S.V. dhe B.I.) ka cilësuar se personat e ngarkuar (OE “Z.C. SHPK) me përlllogaritjen e fondit limit për prokurimin me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë, Rikonstruksion i depos ekzistuese, Rikonstruksion i stacionit të pompave+Linja e dërgimit dhe sistemimi i rrugëve të aksesit”, janë mbështetur në Manualet e miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Preventivi është i shoqëruar me analizat e çmimeve, analizat e koston për çdo zë të preventivit për punimet civile dhe hidraulike, në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime pika 3.1.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Sa më sipër, Grupi i punës i ngarkuar me përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, sipas urdhrorit të cituar më lart, por dhe referuar Procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, ka konfirmuar se preventivi i paraqitur nga OE “Z.C.” SHPK, është përlllogaritur në përputhje me manualin e çmimeve, gjë që nuk rezulton të jetë e saktë. Pretendimi subjektiv nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.

#### **4.3.3. Mbi vlerësimin e OE nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO).**

Për auditimin e kësaj nën çështjeje u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Urdhurat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga KVO;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni i hedhur në SPE.

Procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor “Bashkia Këlcyrë” dhe të audituara, për kontratat për punë publike gjatë vitit 2018-2019, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

**Tabela nr. 4.2 “Prokurime të zhvilluara dhe audituara, viti 2018”**

Nr.	Emërtimi	Viti 2018		
		Parashikim	Realizim	Diferenca
1	Rikonstruksion i Rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Këlcyrë	81,041,904	80,825,772	216,132
2	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit	13,907,037	10,559,254	3,347,783
3	Rikonstruksion Ura në qendër të Qytetit Këlcyrë	4,166,666	4,119,517	47,149
4	Rikonstruksion i shkollës së Mesme Këlcyrë	47,767,144	47,510,162	256,982
5	Sistemin asfaltim Rruga Sukë-Goricë, Podgorie, Fushë, Komarak, Vinok	37,211,972	30,294,476	6,917,496
6	<b>Fonde të audituara në total</b>	<b>184,094,723</b>	<b>173,309,181</b>	<b>10,785,542</b>
7	<b>Fonde të prokuruar në total</b>	<b>187,066,669</b>	<b>176,188,661</b>	<b>10,878,008</b>
8	<b>Mbulimi me auditim në përqindje</b>		<b>98.4 %</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Tabela nr. 4.3 “Prokurime të zhvilluara dhe audituara, viti 2019”**

Nr.	Emërtimi	Viti 2019		
		Parashikim	Realizim	Diferenca
1	Rikonstruksion i Rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë	151,169,770	150,720,070	449,700
2	Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit	29,653,301	29,048,539	604,762
3	Skema ujëtase Ballaban Ujitja e fushës Ballaban	23,308,514	22,820,539	487,975
4	<b>Fonde të audituara në total</b>	<b>204,131,585</b>	<b>202,589,148</b>	<b>1,542,437</b>
5	<b>Fonde të prokuruar në total</b>	<b>204,131,585</b>	<b>202,589,148</b>	<b>1,542,437</b>
6	<b>Mbulimi me auditim në përqindje</b>		<b>100 %</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Nga auditimi i procedurave të realizuara në vitin 2018 ka rezultuar:**

#### **1. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë”**

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë”		
Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 22.05.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 1, datë 22.05.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrorit nr. 2, datë 22.05.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	AQ, Jurist BI, Anëtar S.V., Anëtar	A.L., Kryetar AQ, Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 4,166,666 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 4,119,517 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 47,149 lekë
Data e hapjes së procedurës:	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit për	Operatorët ekonomikë



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

04.06.2018, ora 08. <sup>30</sup>	vitin 2018, miratuar me VKB nr. 29, datë 26.01.2018, në shumën 5,000,000 lekë.	a. Pjesëmarrës në tender: 5 (pesë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S' kualifikuar: 4 (katër)
Ankimime: S'ka	Përgjigje ankesës nga AK:	Përgjigje ankesës nga APP/KPP:

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave**

- AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “Kërkesë për propozim”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 5 OE, nga të cilët është kualifikuar 1 OE dhe janë s' kualifikuar 4 OE.

- Nga KVO sipas Procesverbalit nr. 2, datë 06.11.2018 është kryer shqyrtimi i ofertave dhe sipas vlerësimit të KVO-së, ka rezultuar se nga 5 OE pjesëmarrës në tender, 4 prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 1 OE i ka plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	S- SHPK	3,159,017
2	SH- SHPK	3,431,358
3	J- SHPK	3,926,720
4	BOE- “T” SHPK & “A.K.” SHPK	3,987,978
5	<b>BOE- “E” SHPK &amp; “A.B.” SHPK</b>	<b>4,119,517</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nr.	OE të s' kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	S-SHPK	3,159,017
2	SH- SHPK	3,431,358
3	J- SHPK	3,926,720
4	BOE- “T” SHPK & “A.K.” SHPK	3,987,978

**Titulli i Gjetjes 1: Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga OE i shpallur fitues BOE “E” SHPK & “A.K” SHPK dhe rezultuan këto mangësi:

- Në Shtojcën nr. 10 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe ose në proces”, OE “E” SHPK ka deklaruar kontratën me objekt “Rikonstruksion i Qendrës Kulturore Multifunkionale” Këlcyrë me vlerë 14,877,324 lekë me TVSH, ndërkohë që kjo kontratë është e mbyllur e realizuar gjatë periudhës 06.06.2017-06.09.2017, gjë për të cilën është plotësuar edhe Shtojca nr. 8 “Formular vlerësimi”, nga Bashkia Këlcyrë dhe është paraqitur nga OE “E” SHPK, si dokument për përmbushjen e kriterit 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i OE”, mbi punët e ngjashme të realizuara në procedurën që është në shqyrtim. Nga ana e OE “E” SHPK, është deklaruar informacion i pasaktë, *ose i rremë*.

- Nga këqyrja në sistem e dokumentacionit rezultoi se OE “AK” SHPK, nuk ka përmbushur kërkesat për plotësimin e kriterit kualifikues mbi pagesën e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Nga OE është paraqitur vërtetim i cili konfirmon se, nuk ka detyrime të pashlyera deri në 31 mars 2018, ndërkohë që procedura e prokurimit zhvillohet në muajin qershor 2018. Muaji i maturuar i fundit i takon muaji Prill 2018, i cili ka afat pagese deri në fund të muajit Maj 2018, referuar vendimit të ERE nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit më energji elektrike të klientëve jo familjarë”, neni 9 ku cilësohet se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”. Për rrjedhojë OE “AK” SHPK duhet të paraqiste vërtetim mbi shlyerjen e detyrimeve deri në Prill 2018. Nga OE është paraqitur vërtetimi nr. 3532, datë 30.04.2018, ku cilësohet se detyrimet deri më Mars 2018 janë 0. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e DT, por edhe VKM neni 26 “Kontratat e punëve publike”, pika 7, germa c ku cilësohet: “...një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. **Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për s’ kualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik...**”.

#### Kriteri:

KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “E” SHPK & “AK” SHPK, në kundërshtim me LPP nenin 46 dhe 53 ku cilësohet:

Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.”;

Nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

#### Ndikimi/Efekti:

KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE “E” SHPK & “A.K” SHPK, në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet në shumën **960,500 lekë**, si diferencë midis ofertës më të ulët dhe më të lartë, në kushtet kur asnjë prej ofertuesve nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim dhe nga KVO është shpallur fituese OE me ofertën më të lartë.

#### Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore nga KVO

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

Për shkelje të nenit 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t’i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).

**Konkluzion:** Kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet, mbështetur në nenin 24 “Anulimi i një procedurë prokurimi”, pika 1, germa ç ku cilësohet: “1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: ...germa ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efincencë në shumën 960,500 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Anëtarët e KVO-së, të cilët kanë kualifikuar BOE në kundërshtim me nenin 24, 46 dhe 53 të LPP-së, si dhe me nenin 66 të VKM-së, duke kualifikuar dhe shpallur fitues pa plotësuar kërkesat për përmbushjen e kriterëve kualifikuese.

**2. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Këlcyrë”**

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Këlcyrë”		
Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 15.11.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 1, datë 15.01.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrimit nr. 2, datë 15.11.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	AQ, Jurist BI, Anëtar S.V., Anëtar	AQ, Kryetar E.L., Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 47,767,144 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 47,510,162 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 642,967 lekë
Data e hapjes së procedurës: 17.12.2018, ora 08. <sup>30</sup>	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit për vitin 2018.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 6 (gjashtë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S’kualifikuar: 4 (katër) e. Tërhequr: 1 (një) OE
Ankimime: Ankesa me nr. 2526, datë 26.12.2018 nga M SHPK (Shtojca 21); Ankesa me nr. 2550, datë 28.12.2018, nga OE K SHPK	Përgjigje ankesës nga AK: -Urdhër pezullimi datë 26.12.2018 Relacion, datë 27.12.2018; Përgjigje OE, nr. 2554, datë 28.12.2018 Urdhër pezullimi datë 28.12.2018; Relacion datë 28.12.2018 Përgjigje OE 2557, datë 28.12.2018	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: Ska

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave:** AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “Tender i hapur”, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 6 OE. Nga KVO sipas Procesverbalit datë 17.12.2018 është kryer hapja dhe shqyrtimi i ofertave dhe ka rezultuar se nga 6 OE pjesëmarrës në tender, 5 prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 1 OE i ka plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	K.C	-
2	BOE- “J” SHPK & “E.K.” SHPK	40,124,177
3	BOE- A.C. SHPK & K. SHPK	42,026,000
4	A. SHPK	43,724,658
5	BOE- “M” SHPK & “E” SHPK	44,992,242
6	E. SHPK & A.K. SHPK	47,510,162

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	K.C.	-
2	BOE- “J” SHPK & “E.K.” SHPK	40,124,177
3	BOE- A.C. SHPK & K. SHPK	42,026,000
4	A. SHPK	43,724,658
5	BOE- “M.” SHPK & “E.” SHPK	44,992,242

**Titulli i Gjetjes 2: Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.**

**Situata 1:** Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të s’ kualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

rezultoi se:

1. OE "K.C." SHPK, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. BOE "J." SHPK & "E.K." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- OE "J." SHPK nuk ka paraqitur vërtetim për pagesat e taksave dhe tarifave vendore, për aktivitetin e zhvilluar në Bashkinë Krujë, ku sipas Ekstraktit të QKB ka të hapur NIPT sekondar, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2.2.3 të DT "Kriteret e veçanta për kualifikim" dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore";

- OE "E.K." SHPK ka paraqitur vërtetim për pagesën e energjisë elektrike në kundërshtim me kërkesat e DST. Vërtetimi nr. 1381, datë 08.11.2018 i OSHEE nuk ka përfshirë pagesën e muajit të maturuar, në kundërshtim edhe me vendimin e ERE nr. 109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit më energji elektrike të klientëve jo familjarë", neni 9 ku cilësohet se: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar". Nga këqyrja në sistem e dokumentacionit rezultoi se OE "E.K." SHPK ka paraqitur vërtetimin nr. 1524, datë 11.12.2018, ku vërtetohet se ka paguar dhe detyrimet e muajit Nëntor, i cili është muaji i fundit i maturuar. KVO nuk i është referuar dokumentacionit të hedhur në SPE. Ky kriter është plotësuar nga OE.

3. BOE "A.C." SHPK & "K." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret si më poshtë:

- Operatori ekonomik ka përllogaritur gabim vlerën e ofertës ekonomike pa TVSH.

4. OE "A." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret si më poshtë:

- OE nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në "Kriteret e veçanta për kualifikim", pika 13 përsa i përket pajisjeve teknike që duhet të disponojë, sipas shtojcës nr. 10.

- OE nuk ka përmbushur kriterin përsa i përket Drejtuesit teknik, i cili duhet të jetë inxhinier ndërtimi, por që është paraqitur me diplomë inxhinier mekanik.

- Disa prej mjeteve janë paraqitur me dokumentacion jashtë afateve të vlefshmërisë së tyre.

5. BOE "M." SHPK & "E." SHPK

- Nuk ka paraqitur analizë çmimesh për të gjithë zërat e punimeve.

- Operatori ekonomik ka përllogaritur gabim vlerën e ofertës ekonomike pa TVSH. Vlera e ofertës ekonomike nuk përputhet me vlerën e preventivit. (44,992,24 lekë dhe 45,498,342 lekë).

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s' kualifikimin e 4 OE të mësipërm në përputhje me LPP, nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 dhe nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3.

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga OE i shpallur fitues BOE "E." SHPK & "A.K." SHPK dhe rezultuan këto mangësi:

- BOE, nuk ka paraqitur "Ofertën ekonomike" sipas Formularit të Ofertës Ekonomike Shtojca 1 e DT, në formular kërkohet që të paraqitet çmimi total i ofertës pa TVSH dhe me TVSH, si dhe Preventivi.

#### Situata 2:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Mosplotësimi i ofertës ekonomike sipas Shtojcës nr. 1, në të gjitha rastet e tjera nga KVO është konsideruar me të drejtë mosplotësim i kriterëve për kualifikim përcaktuar në DT, Udhëzime për ofertuesit Seksioni 1 "Hartimi i ofertës", ku cilësohet se, ofertat që nuk do të përgatiten sipas DT, do të refuzohen si të papranueshme.

- Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE, ka rezultuar se në Analizën e çmimeve të paraqitur nga BOE "E." SHPK & "A.K." SHPK, për përllogaritjen dhe analizën e çmimeve për 2 zëra punimesh, me numër analize 3.45/1, është aplikuar paga bazë orare, 138 lekë dhe me numër analize 3.643, është aplikuar paga bazë orare 125 lekë. Nga ana e KVO-së, aplikimi i pagës orare bazë më pak se 149 lekë, është konsideruar shkelje e VKM nr. 809/2018 "Për pagën minimale në shkallë vendi", ku paga bazë orare minimale është 149 lekë dhe zbatimi i saj është detyrim sipas Kodit të Punës, neni 19. Ky fakt nuk është evidentuar në këtë rast.

#### Kriteri:

KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "E." SHPK & "A.K." SHPK, në kundërshtim me LPP nenin 46 dhe 53 ku cilësohet:

*Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.”;*

*Nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e neni 54 të këtij ligji”.*

#### Ndikimi/Efekti:

KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE të mësipërm, në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë **në shumën 7,385,985 lekë**, si diferencë midis ofertës më të ulët dhe më të lartë, në kushtet kur asnjë prej ofertuesve nuk kanë plotësuar kriteret për kualifikim dhe nga KVO është shpallur fituese OE me ofertën më të lartë.

#### Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore nga KVO

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

Për shkelje të neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në neni 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t’i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).

**Konkluzion:** Kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet, mbështetur në neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa ç ku cilësohet: “1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:...germa ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

KVO ka kryer vlerësimin dhe s’ kualifikimin e BOE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë **në shumën 7,385,985 lekë**.



**KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

Anëtarët e KVO-së, të cilët kanë kualifikuar BOE në kundërshtim me LPP nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa ç; nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 duke kualifikuar dhe shpallur fitues OE pa plotësuar kërkesat për përmbushjen e kriterëve kualifikuese.

**3. Mbi procedurën me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara”**

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara”		
Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 27.07.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 1, datë 27.07.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. 2, datë 27.07.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	AQ, Jurist BI, Anëtar SV, Anëtar	AQ, Kryetar EL, Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 13,907,037 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 10,599,254 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 3,347,783 lekë
Data e hapjes së procedurës: 29.08.2018, ora 08. <sup>30</sup>	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit për vitin 2018. Fond i alokuar nga Ministria e Financave në kuadër të thirrjes së MF për dorëzimin e projekteve nga NJVV përmirësimit të kushteve të strehimit në total 16,688,445 lekë Viti 2018-6,657,378 lekë Viti 2019-	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 10 (dhjetë) OE b. Kualifikuar: 5 (pesë) OE c. S'kualifikuar: 5 (pesë) OE
Ankimime: Shkresa nr. 1917, datë 01.10.2018 (Shtojca 21)	Përgjigje ankesës nga AK: -Urdhri i pezullimit datë 01.10.2018; -Relacioni i Grupit të punës nr. 05.10.2018; -Kthim përgjigje OE me shkresë nr. 1978, datë 05.10.2018	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: S'ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave:** Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën “Tender i hapur”, në përputhje me LPP, nenin 27 “Kufijtë monetarë” dhe VKM nenin 8 “Kufijtë monetarë”. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 10 OE, nga të cilët është kualifikuar 5 OE dhe janë s’ kualifikuar 5 OE. Nga KVO sipas Procesverbalit datë 04.09.2018 është kryer hapja dhe shqyrtimi i ofertave dhe ka rezultuar se nga 10 OE pjesëmarrës në tender 5 prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 5 OE i kanë plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	G. SHPK	8,760,373
2	N. SHPK	10,256,710
3	J. SHPK	10,559,254
4	A. SHPK	10,705,046
5	C. SHPK	11,067,551
6	B. SHPK	11,408,510
7	B9. SHPK	12,172,383
8	2Z K.	12,280,339
9	BOE- A.F. SHPK & A. SHPK	13,768,261
10	R. SHPK	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	G. SHPK	8,760,373
2	N. SHPK	10,256,710
3	2Z K. SHPK	12,280,339
4	BOE- AF SHPK & A. SHPK	13,768,261



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

5	R. SHPK	-
---	---------	---

#### Titulli i Gjetjes 3: Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

##### Situata 1:

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të s' kualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:

1. OE "G." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- Nuk ka plotësuar kërkesat mbi stafin teknik sipas kërkesave në DT të përcaktuara në "Kriteret e veçanta për kualifikim", pika 5 dhe 6, për të përmbushur kriterin mbi stafin teknik. Referuar Listë pagesave të muajit janar 2017, inxh. Merko Sulaj ka punuar 1 ditë, Inxh Vladimir Nase ka punuar 22 ditë dhe inxh Theodhor Bello ka punuar 7 ditë, sipas listë pagesave të muajit Shkurt 2017, inxh. Merko Sulaj ka punuar 4 ditë, Inxh Vladimir Nase ka punuar 22 ditë dhe inxh Theodhor Bello ka punuar 4 ditë. Drejtuesi teknik ka punuar më pak se 87 orë në muaj, veprime ne kundërshtim me aktet rregullative të fushës.

- Nuk ka plotësuar kërkesat mbi makineritë e pajisjet sipas kërkesave të DT, për të përmbushur "Kriteret e veçanta për kualifikim", kriterin 7.a, pasi nuk ka paraqitur Leje transporti nga NJQV për mjetin "Autovinç DR 1230F";

- Nuk ka paraqitur Preventivin përmbledhës sipas kërkesave në DT.

2. OE-"N." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret si më poshtë:

- Nga ana e OE nuk është paraqitur analizë çmimesh dhe përshkrim të punëve, në kundërshtim me DT, kriteri 12 ku është cilësuar se: "OE duhet të paraqesë analizën e çmimeve. Mosparaqitja e tyre është kusht për s' kualifikim".

- Nuk ka plotësuar kërkesat mbi makineritë e pajisjet sipas kërkesave të DT, për të përmbushur kriterin 7 "Kriteret e veçanta për kualifikim", për Makineritë e pajisjet, pasi nuk ka paraqitur Leje transporti nga NJQV për mjetin "Autovinç SH 3894 A";

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s' kualifikimin e 2 OE të mësipërm në përputhje me LPP, nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 dhe nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3.

- Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga OE i shpallur fitues "J." SHPK dhe rezultuan këto mangësi:

Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE, ka rezultuar se në Analizën e çmimeve të paraqitur nga OE "J." SHPK, për përlllogaritjen dhe analizën e çmimeve për 3 zëra punimesh, konkretisht: An-3, është aplikuar paga bazë orare, 125 lekë; An-2, është aplikuar paga bazë orare 125 lekë dhe An-5, është aplikuar paga bazë orare 125 lekë.

Nga ana e KVO-së, aplikimi i pagës orare bazë në nivelin 125 lekë, është konsideruar shkelje e VKM nr. 809/2018 "Për pagën minimale në shkallë vendi", ku paga bazë orare minimale është 149 lekë dhe zbatimi i saj është detyrim sipas Kodit të Punës, neni 19.

##### Kriteri:

KVO, kualifikuar dhe shpallur fitues e OE "J." SHPK, në kundërshtim me LPP nenin 46 dhe 53 ku cilësohet:

Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.”;*

*Nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.*

**Ndikimi/Efekti:** KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm, në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë në shumën **1,798,881 lekë**, si diferencë midis ofertës më të ulët dhe ofertës të kualifikuar, në kushtet që kjo e fundit nuk ka plotësuar kriteret kualifikuese.

**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore nga KVO

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Për shkelje të nenit 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t’i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë në shumën **1,798,881 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Anëtarët e KVO-së, pasi kanë vepruar në kundërshtim me nenin 46 dhe 53 të LPP-së, si dhe me nenin 66 të VKM-së, duke kualifikuar dhe shpallur fitues OE "J." SHPK pa plotësuar kërkesat për përmbushjen e kriterëve kualifikuese. Gjithashtu, KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e elementëve përbërës së kostos së zërave të punimeve përsa i përket "pagës bazë minimale të aplikueshme".

#### 4. Mbi procedurën me objekt “Sistemim asfaltim Rrugët Goricë-Sukë etj.”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim Rrugët Goricë-Sukë etj.”		
Urdhër Prokurimi nr. ska, datë 24.12.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. ska, datë 24.12.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. ska, datë 24.12.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	AQ, Jurist BI, Anëtar SV, Anëtar	AQ, Kryetar EL, Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 37,211,972 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 30,294,476 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 6,917,496 lekë
Data e hapjes së procedurës: 04.02.2019, ora 08. <sup>30</sup>	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit për vitin 2018.	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 5 (pesë) OE b. Kualifikuar: 3 (tre) OE c. S'kualifikuar: 2 (dy) OE
Ankimime: Ska	Përgjigje ankesës nga AK: Ska	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: S'ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë

Punoi: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave:** Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën “Tender i hapur”, në përputhje me LPP, nenin 27 “Kufijtë monetarë” dhe VKM nenin 8 “Kufijtë monetarë”. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 5 OE. Nga KVO sipas Procesverbalit datë 04.02.2019 është kryer hapja dhe shqyrtimi i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

ofertave dhe ka rezultuar se nga 5 OE pjesëmarrës në tender 2 prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 3 OE i kanë plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	E. Company SHPK	27,009,935
2	S. SHPK	28,600,001
3	H. SHPK	30,294,476
4	B.B. SHPK	30,371,768
5	B9. SHPK	30,460,845

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	E. Company, SHPK	27,009,935
2	S. SHPK	28,600,001

#### Titulli i Gjetjes 4: Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

##### Situata 1:

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të s' kualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:

1. OE "E.Company" SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- Nga ana e OE, është aplikuar paga orare bazë nën nivelin minimal të lejuar. Për zërat e punimeve 3.46/1 është aplikuar paga orare 148 lekë dhe për zërin e punimeve 2.258, është aplikuar paga orare 125 lekë. Nga KVO është konsideruar shkelje e VKM nr. 809/2018 "Për pagën minimale në shkallë vendi", ku paga bazë orare minimale është 149 lekë dhe zbatimi i saj është detyrim sipas Kodit të Punës, neni 19.

Përsa i përket aplikimit të pagës orare nën nivelin minimal bëhet fjalë vetëm për një zë punimesh, (2.258).

- Nga ana e KVO-së, OE është s' kualifikuar sepse nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë mbi përmbushjen e kriterit të veçantë për kualifikim pika 10 e Shtojcës 12. OE ka paraqitur Kontratë qiraje me OE "E." SHPK, për marrje me qira të dy mjeteve autobetoniere me targa AA859AZ dhe AA674JC. Nga KVO është verifikuar se këto dy mjete nga OE "E." SHPK i janë dhënë me qira edhe OE të tjerë, konkretisht OE "A." SHPK dhe OE "T.D." SHPK.

Sa më sipër, duke qenë se përgjegjësia ligjore nuk është e OE qiramarrës, pjesëmarrës në këtë procedurë, por e OE qiradhënës, AK duhej t'i drejtohej për mendim APP-së, si organi i vetëm që këshillon dhe jep asistencë në lidhje me zbatimin e akteve ligjore në fushën e prokurimeve. Kjo referuar LPP neni 13, pika 2, germa d ku cilësohet: "në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi". KVO në argumentimin e saj i është referuar Vendimit të KPP-së nr. 43/2016, datë 22.01.2016, gjë e cila nuk është në përputhje me LPP. Vendimet e KPP-së janë rast pas rasti, ato nuk janë vendime unifikuese dhe detyrueshme për zbatim nga të gjithë AK në shkallë vendi. Referuar LPP, neni 19 në asnjë pikë dhe germë të tij nuk i atribuohet kjo kompetencë KPP-së.

2. OE-"S." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret si më poshtë:

- Nga ana e OE nuk është paraqitur analizë çmimesh dhe përshkrim të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

punëve, në kundërshtim me DT, kriteri 12 ku është cilësuar se: "OE duhet të paraqesë analizën e çmimeve. Mosparaqitja e tyre është kusht për s' kualifikim".

#### Situata 2:

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s' kualifikimin e 2 OE të mësipërm përgjithësisht në përputhje me LPP, nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga OE i shpallur fitues “H.” SHPK dhe rezultoi se ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

- Nga auditimi ka rezultuar se nga KVO nuk është evidentuar fakti se OE “H.” SHPK, rezulton debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë, sipas Njoftimit nr. 2077, datë 22.10.2018 në shumën 162,488 lekë, gjë të cilën e ka konsideruar mangësi për OE të tjerë ekonomikë.

#### Kriteri:

KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “H.” SHPK në kundërshtim me LPP nenin 46 dhe 53, të cituara në gjetjen nr. 1

#### Ndikimi/Efekti:

KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë në shumën 3,284,541 lekë, si diferencë midis ofertës më të ulët dhe ofertës të kualifikuar, në kushtet kur ofertuesi i kualifikuar nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim.

#### Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore nga KVO

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

Për shkelje të nenit 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t'i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, LPP, neni 46 pika 1 dhe nenin 53, pika 3, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë në shumën 3,284,541 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Anëtarët e KVO-së, pasi duhet të kishin vlerësuar më drejtë ofertën e OE “E.C. Company” SHPK, paraqitur me vlerën më të ulët, si dhe për kualifikimin e OE fitues “Hito” SHPK në kundërshtim me aktet ligjore.

### 5. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të Ujësjetit Bashkia Këlcyrë”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të Ujësjetit Bashkia Këlcyrë”		
Urdhër Prokurimi nr. ska, datë 04.07.2018	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. ska, datë 24.12.2018	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrimit nr. ska, datë 24.12.2018
Lloji i Procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim	AQ, Jurist BI, Anëtar AB, Anëtar (AKUK)	AQ, Kryetar L.V., Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 81,041,904 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 80,825,772 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 216,132 lekë
Data e hapjes së procedurës: 06.08.2018, ora 08. <sup>30</sup>	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit, miratuar me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4790/16, datë 23.05.2018 me vlerë të plotë 97,515,589 lekë Viti 2018-33,038,531 lekë Viti 2019-67,184,2018 lekë	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 4 (katër) OE b. Kualifikuar: 2 (dy) OE c. S' kualifikuar: 2 (dy) OE



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

	Supervizioni: 1,768,697 lekë Viti 2018-541,200 lekë Viti 2019-1,262,800 lekë	
Ankimime: Ska	Përgjigje ankesës nga AK: Ska	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: S'ka

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoj: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave:** Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën “Tender i hapur”, në përputhje me LPP, nenin 27 “Kufijtë monetarë” dhe VKM nenin 8 “Kufijtë monetarë”. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes dhe kanë marrë në pjesë në procedurë 4 OE. Nga KVO sipas Procesverbalit datë 13.08.2018 është kryer hapja dhe shqyrtimi i ofertave dhe ka rezultuar se nga 4 OE pjesëmarrës në tender 2 prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 2 OE i kanë plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE-“T” SHPK & “D. & CO & B.” SHPK	58,140,138
2	OE- “B.S.” SHPK	80,825,772
3	OE- “E.” SHPK	80,989,989
4	BO- “L.” SHPK & “SH.I” SHPK	80,969,538

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoj: KLSH

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	BOE- “2T” SHPK & “D. & CO & B.” SHPK	58,140,138
2	OE- “E.” SHPK	80,989,989

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të s’ kualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:

1. BOE “2T” SHPK & “D. & CO & B.” SHPK, është s’ kualifikuar nga KVO pasi njëri nga OE është tërhequr nga pjesëmarrja në këtë procedurë. Në këto kushte KVO ka veruar në përputhje me VKM neni 74 “**Bashkimi i operatorëve ekonomikë**”, pika 4, ku cilësohet: “*Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet*”.

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga OE i shpallur fitues dhe rezultoi se, ka plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.

Nr.	OE të kualifikuar	Vlera e Ofertës
1	OE- “B.S.” SHPK	80,825,772
2	BO- “L.” SHPK & “SH.I” SHPK	80,969,538

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm në përputhje me LPP, nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

**Nga Auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2019 ka rezultuar:**

**1. Mbi procedurën me objekt “Ndërtim i Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë”**

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Ndërtim i Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë		
Urdhër Prokurimi nr. S’ka datë 24.05.2019	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. S’ka datë	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. S’ka datë 24.05.2019
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	AQ, Jurist BI, Anëtar	AQ, Kryetar E.L., Anëtar





**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

	S.V., Anëtar	RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 151,169,770 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 150,720,070 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 449,700 lekë
Data e hapjes së procedurës: 26.06.2019, ora 08.30	Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit MFE dhe AKUK, për tu financuar si më poshtë: 2019-35,625,220 lekë 2020-53,437,829 lekë 2021-89,063,089 lekë	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 4 (katër) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S' kualifikuar: 3 (tre) OE
Ankimime: me nr. 1623, datë 30.07.2019	Përgjigje ankesës nga AK: -Urdhër pezullimi datë 30.07.2019; -Relacion TAK datë 30.07.019; -Përgjigje me shkresën nr. 1630, datë 30.07.2019; -Informacion për KPP nr. 1706, datë 21.08.2019; -Shkresë e AK për KPP dhe BOE; -Informacion i AK drejtuar KPP nr. 1840, datë 10.09.2019	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: -Vendim i KPP nr. 1380/1, datë 13.08.2019; -Kërkesë e KPP për AK nr. 1791, datë 06.09.2018; -Vendim i KPP nr. 670/2019, ku është vendosur mos shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga BOE.

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave:** Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën tender i “Hapur” me vlerë 151,169,770 lekë përcaktuar në përputhje me LPP, nenin 27 “Kufijtë monetarë” dhe VKM nenin 8 “Kufijtë monetarë” dhe që do të financohet në tre vite buxhetore (2019-2021), sipas shkresës së Ministrisë së Financave 22760/345, datë 28.02.2019.

Nga KVO është kryer hapja dhe vlerësimi i ofertave më datë 26.06.2019, si dhe është mbajtur Procesverbali përkatës. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë 4, nga të cilët 3 OE nuk i kanë plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 1 OE i ka plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE- “B.9” SHPK & “R.C” SHPK & “A.S.” SHPK & “Sh.” SHPK	123,292,128
2	BOE- “Er.” SHPK & “C.” SHPK	124,088,661
3	OE- “S.” SHPK	135,070,212
4	<b>BOE- “B.I.” SHPK &amp; “Hs.” SHPK</b>	<b>150,720,070</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	BOE- “B.9” SHPK & “R.C” SHPK & “A.S.” SHPK & “Sh.” SHPK	123,292,128
2	BOE- “Er.” SHPK & “C.” SHPK	124,088,661
3	OE- “S.” SHPK	135,070,212

**Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të s' kualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:**

1. BOE- “B.9” SHPK & “R.C” SHPK & “A.S.” SHPK & “Sh.” SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- BOE, nuk e ka paraqitur Formularin e ofertës sipas dokumentit standard, Shtojca nr. 1, plotësimi i të cilës është sqaruar për OE në DST “Udhëzime për operatorët”, pika 2.1 “Përlllogaritja e ofertës ekonomike”. AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përlllogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. Oferta ekonomike duhej të paraqitej si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

“Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””.

Mosplotësimi i ofertës ekonomike, sipas Shtojcës nr. 1, e bën këtë ofertë të papranueshme.

- Në analizat e çmimeve për disa zëra punimesh si: 3.47/c, 3.377, 2.258, 2.426/3 etj, ka përcaktuar pagë orare në shumën 125 lekë, ndërkohë që paga orare bazë e lejueshme është në shumën 149 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. (Etj.)

Nga ana e KVO-së është konsideruar si mosplotësim i kërkesave rasti kur BOE- “B.9” SHPK & “R.C” SHPK & “A.S.” SHPK & “Sh.” SHPK është aplikuar paga orare bazë 125.

- Kontrata e bashkëpunimit nuk është nuk është nënshkruar nga të gjithë OE, përse i përket preventivit ku janë përcaktuar ndarja e punimeve që do të realizohet nga secili OE, në kundërshtim me VKM neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” dhe DST.

2. BOE- “Er.” SHPK & “C.” SHPK, ka paraqitur kërkesë tërheqje, protokolluar në Bashki Këlcyrë me nr. 1524, datë 11.07.2019, në të cilën paraqiten arsyet e dorëheqjes nga kjo procedurë prokurimi.

3. OE- “S.” SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- OE, nuk e ka paraqitur Formularin e ofertës sipas dokumentit standard, Shtojca nr. 1, plotësimi i të cilës është sqaruar për OE në DST “Udhëzime për operatorët”, pika 2.1 “Përlllogaritja e ofertës ekonomike”. AK ka kërkuar që oferta të paraqitet në total pa TVSH dhe me TVSH, si dhe bashkëngjitur Preventivin për çdo zë punimesh me çmim, sasi dhe vlerë. Gjithashtu, ka gabime në përlllogaritjen e vlerës së ofertës me TVSH dhe pa TVSH. BOE ka paraqitur gabim vlerën e ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makineri e pajisje” dy herë. Oferta ekonomike duhet të paraqitet si shumë e vlerës së punimeve pa TVSH + vlerën e zërit “Makineri dhe pajisje”, referuar udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011 “për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””. Mosplotësimi i ofertës ekonomike, sipas Shtojcës nr. 1, e bën këtë ofertë të papranueshme.

Nga auditimi rezultoi se, Oferta ekonomike është paraqitur konform kërkesave të Shtojcës 1, si dhe DT “Udhëzime për ofertuesit”. KVO nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të këtij dokumenti (Shtojca nr.1).

- Nuk ka plotësuar kërkesën për paraqitje të licencës ku të përfshihet dhe kategoria NS-16C, për të përmbushur kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.2 të “Kritereve të veçanta për kualifikim”. Në SPE ka paraqitur kategorinë NS-16A.

- Nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në DST për paraqitjen e punëve të ngjashme në vlerën 50 % të një kontrate të vetme, ose shuma e kontratave të realizuara gjatë tre viteve të fundit të jetë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës. OE ka paraqitur kontratë të realizuar në shumën 51,167,755 lekë, vlerë e cila nuk plotëson kërkesat për përmbushjen e kriterit. (Etj.)

**Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE. Nga BOE “B.S.” SHPK & “Hs.” SHPK i shpallur fitues nuk rezultuan mangësi. Nga ana e OE janë plotësuar të gjitha kriteret e përgjithshme, të veçanta dhe kërkesat për plotësimin e specifikimeve teknike.**

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s’ kualifikimin e 2 OE të mësipërm dhe kualifikimin e BOE, në përputhje me LPP, nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

## 2. Mbi procedurën me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes Spitalit”

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Urdhër Prokurimi nr. S'ka datë 26.02.2019	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. S'ka datë 26.02.2019	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrin nr. S'ka datë 26.02.2019
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	AQ, Jurist BI, Anëtar S.V., Anëtar	AQ, Kryetar E.L., Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 29,165,301 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 29,048,539 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 116,762 lekë
Data e hapjes së procedurës: 01.04.2019, ora 08.30	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Këlcyrë, Vendimi nr. 03, datë 04.01.2019 2019-5,000,000 lekë 2020-e pa afat-30,000,000 lekë	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 2 (dy) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 1(një) OE
Ankimime: me nr. 1623, datë 30.07.2019	Përgjigje ankesës nga AK: -Urdhër pezullimi datë 30.07.2019; -Relacion TAK datë 30.07.019; -Përgjigje me shkresën nr. 1630, datë 30.07.2019; -Informacion për KPP nr. 1706, datë 21.08.2019; -Shkresë e AK për KPP dhe BOE; -Informacion i AK drejtuar KPP nr. 1840, datë 10.09.2019	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: -Vendim i KPP nr. 1380/1, datë 13.08.2019; -Kërkesë e KPP për AK nr. 1791, datë 06.09.2018; -Vendim i KPP nr. 670/2019, ku është vendosur mos shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga BOE.

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Mbi vlerësimin e ofertave:** Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën tender i “Hapur” me vlerë 29,165,301 lekë, përcaktuar në përputhje me LPP, nenin 27 “Kufijtë monetarë” dhe VKM nenin 8 “Kufijtë monetarë”. Nga KVO është kryer hapja dhe vlerësimi i ofertave më datë 01.04.2019, si dhe është mbajtur Procesverbali përkatës. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë 2 OE, që sipas vlerësimit të KVO-së, 1 OE nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 1 OE i ka plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE- "Sp." SHPK & "DP" SHPK	24,551,234
2	OE- "J." SHPK	29,048,539

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

#### Titulli i Gjetjes 5: Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

##### Situata 1:

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:

1. BOE-"Sp." SHPK & "DP" SHPK nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- OE, "DP" SHPK nuk plotëson kriterin për realizim të punëve të ngjashme në raport me % e pjesëmarrjes në Kontratën e bashkëpunimit.

- Nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e kriterit 6 të cilësuar në DT "Kriteret e veçanta për kualifikim". OE ka të punësuar mjekun e ndërmarrjes, i cili përveç diplomës duhet të paraqesë dhe Urdhrin e Mjekut, dokument i cili nuk disponohej.

- BOE nuk ka plotësuar kriterin 8, në lidhje me paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar në DT, për përmbushjen e kriterit në lidhje me punonjësit dhe stafin teknik.

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s' kualifikimin e OE të mësipërm në përputhje me LPP, nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

#### Situata 2:

OE i shpallur fitues "J." SHPK.

- Nga këqyrja dhe shqyrtimi i dokumentacionit në SPE ka rezultuar se OE "J." SHPK, në analizat e çmimeve për 6 zëra punimesh si: "Skarifikim shtresash asfalti ekzistues me makineri", "Prerjeje bime të vogla"; Spërkatje me emulsion bituminoz", "Pllaka guri"; "Shtresë zhavorri" dhe "Shtresë rëre", ka përcaktuar pagë orare në shumën 125 lekë, ndërkohë që paga orare bazë e lejueshme është në shumën 149 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" dhe Kodin e punës. Theksojmë se në disa raste nga vetë KVO është konsideruar mos përmbushje e kriteve për kualifikim.

#### Kriteri:

KVO, ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "J." SHPK, në kundërshtim me LPP nenin 46 dhe 53 të cituara më lart.

#### Ndikimi/Efekti:

KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, LPP, neni 46 pika 1 dhe nenin 53, pika 3, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet në shumën 4,497,305 lekë, si diferencë midis ofertës më të ulët dhe ofertës së kualifikuar dhe shpallur fituese, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim. Kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet.

#### Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore nga KVO

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

Për shkelje të nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" dhe nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave" të LPP-së, në nenin 72 "Kundërvajtjet administrative" të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t'i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 "Agjencia e Prokurimit Publik", pika 2 germa (g).

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s' kualifikimin e BOE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, LPP, neni 46 pika 1 dhe nenin 53, pika 3, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet në shumën 4,497,305 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Anëtarët e KVO-së, pasi kanë vepruar në kundërshtim me nenin 24, 46 dhe 53 të LPP-së, si dhe me nenin 66 të VKM-së, duke kualifikuar dhe shpallur fitues OE "J." SHPK pa plotësuar kërkesat për përmbushjen e kriteve kualifikuese.

### 3. Mbi procedurën me objekt "Skema Ujitëse Ballaban"

1. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Skema ujitëse Ballaban"		
Urdhër Prokurimi nr. S'ka datë 24.04.2019	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. S'ka datë 24.04.2019	Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas urdhrit nr. S'ka datë 26.02.2019
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur	AQ, Jurist BI, Anëtar S.V., Anëtar	AQ, Kryetar E.L., Anëtar RH, Anëtar
Fondi limit pa tvsh: 23,308,514 lekë	Oferta fituese pa tvsh: 29,048,539 lekë	Diferenca me fondin limit pa tvsh: 116,762 lekë
Data e hapjes së procedurës: 27.05.2019, ora 08.30	Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Këlcyrë, Vendimi nr. 03, datë 04.01.2019 2019-5,000,000 lekë 2020-e pa afat-30,000,000 lekë	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 5 (pesë) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: 4 (katër) OE
Ankimime: S'ka	Përgjigje ankesës nga AK:-	Përgjigje ankesës nga APP/KPP: -

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt "Auditim financiar dhe Përputhshmërie"

**Mbi vlerësimin e ofertave:** Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën tenderi të "Hapur" me vlerë 29,165,301 lekë, përcaktuar në përputhje me LPP, nenin 27 "Kufijtë monetarë" dhe VKM nenin 8 "Kufijtë monetarë". Nga KVO është kryer hapja dhe vlerësimi i ofertave më datë 03.06.2019, si dhe është mbajtur Procesverbali përkatës. Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë 5 OE, nga të cilët sipas vlerësimit të KVO-së, 4 OE nuk i ka plotësuar kriteret kualifikuese të përcaktuara në DT dhe 1 OE i ka plotësuar ato.

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "E.C. Company" SHPK & "J." SHPK	16,779,883
2	OE-M SHP	18,016,508
2	OE-EDK SHPK	18,388,934
4	OE-B9 SHPK	21,746,053
5	OE-H. SHPK	22,820,539

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

Nr.	OE të skualifikuar	Vlera e Ofertës
1	BOE "E.C. Company" SHPK & "J." SHPK	16,779,883
2	OE-M SHPK	18,016,508
2	OE-EDK SHPK	18,388,934
4	OE-B9 SHPK	21,746,053

#### Titulli i Gjetjes 6: Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

##### Situata 1:

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ofertave në SPE për OE të skualifikuar me vlerë më të ulët se OE i shpallur fitues, nga ku rezultoi se:

1. BOE- "E.C. Company" SHPK & "J." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- Në shtojcën 10 "Deklaratë mbi makineritë dhe pajisjet", OE ka deklaruar makineri dhe pajisje të cilat kanë rezultuar të jenë të angazhuara për realizimin e kontratës "Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes Spitalit" të lidhura, konkretisht: mjetet me targa FR6312B; FR3013D dhe Fadromë me goma AEMT21.

Nga këqyrja e dokumentacionit në dosjen e tenderit me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes Spitalit", është vërtetuar se OE "J." SHPK është shpallur fitues dhe makineritë i ka të deklaruara për realizimin e kësaj kontrate.

2. OE- "M." SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- Nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të veçantë për kualifikim pika 2.3.6 Shtojca 12 e DT. Është kërkuar Fabrikë prodhim betoni (në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi), në distancë jo më shumë se 50 km. Fabrika e betonit e paraqitur nga OE sipas Kontratës së qirasë me OE "Aliko Ndërtim" ndodhet në Gjirokastër në distancë mbi 50 km.

- Nuk ka përmbushur kriterin 2.3.6 përsa i përket mjeteve dhe pajisjeve që duhet të disponojë, pasi ka paraqitur Leje transporti nga NJQV, për llogari të vet dhe jo për të tretë.

3. OE- "EDK" SHPK, ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga procedura e prokurimit me anë të shkresës nr. 135, datë 18.06.2019.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

4. OE- "B9" SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim si më poshtë:

- Në analizat e çmimeve për disa zëra punimesh si: 3.2, 3.45/1, 3.47/1b, ka përcaktuar pagë bazë minimale orare në shumën 125 lekë, ndërkohë që paga bazë minimale orare e lejueshme është në shumën 149 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Ky veprim vjen në kundërshtim me aktet ligjore të fushës si me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 po ashtu edhe më Kodin e Punës, neni 19.

- Nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të veçantë për kualifikim pika 2.3.6 Shtojca 12 e DT. Është kërkuar Fabrikë prodhim betoni (në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi), në distancë jo më shumë se 50 km. Fabrika e betonit e paraqitur nga OE sipas Kontratës së qirasë me OE "Lushaku" SHPK ndodhet në Fier në distancë mbi 50 km.

**Konkluzion:** KVO ka kryer vlerësimin dhe s’ kualifikimin e 4 OE të mësipërm në përputhje me LPP, nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 dhe nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

#### Situata 2:

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur në SPE nga OE i shpallur fitues “H.” SHPK, i cili rezulton të jetë sipas kërkesave të DT, përveç sa më poshtë:

- Nga KVO, për vlerësimin e ofertave të OE në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë”, ka s’ kualifikuar nga procedura e prokurimit OE “Sh.” SHPK, dhe ka cilësuar: *“OE rezulton debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë, për vlerën 118,440 lekë për punime të pakryera në objektin “Rehabilitim i kanalit Ballaban”, lënë detyrim nga KLSH”.*

Përsa i përket kësaj kërkesë, rezulton se nga ana e KVO-së, pikërisht ky fakt nuk është konsideruar në vlerësimin e OE “H.” SHPK, i cili rezulton debitor kundrejt Bashkisë Këlcyrë, sipas Njoftimit nr. 2077, datë 22.10.2018 në shumën 162,488 lekë.

#### Kriteri:

KVO, ka s’ kualifikuar OE në përputhje me LPP, nenin 46 dhe 53 dhe ka kryer kualifikimin e OE “H.” SHPK të shpallur fitues, në kundërshtim me LPP nenin 46 dhe 53 të cituara më lart.

#### Ndikimi/Efekti:

KVO ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e OE të mësipërm në kundërshtim me aktet ligjore, LPP, neni 46 pika 1 dhe nenin 53, pika 3, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë në shumën **6,040,656 lekë**, si diferencë midis ofertës më të ulët dhe ofertës së kualifikuar dhe shpallur fituese, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim. Kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet.

#### Shkaku:

Mos zbatim i akteve ligjore nga KVO

#### Rëndësia:

E lartë

#### Rekomandime:

Për shkelje të nenit 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t’i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**Konkluzion:** KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “H.” SHPK, në kundërshtim me LPP, neni 46 pika 1 dhe nenin 53, pika 3, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efincencë në shumën 6,040,656 lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Anëtarët e KVO-së, pasi kanë vepruar në kundërshtim me nenin 24, 46 dhe 53 të LPP-së, si dhe me nenin 66 të VKM-së, duke kualifikuar dhe shpallur fitues OE “H.” SHPK pa plotësuar kërkesat për përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe kanë vepruar me dy standarde në vlerësimin e detyrimeve të pashlyera.

#### **Titulli i Gjetjes 7: Mbi qëndrimet me dy standarde në vlerësimin e OE nga KVO.**

##### **Situata 1:**

1. Në procedurën me objekt “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë” ka rezultuar: OE “Sh.” SHPK, sipas vlerësimit të KVO-së, rezulton debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë, për vlerën 118,440 lekë për punime të pakryera në objektin “Rehabilitim i kanalit Ballaban”, lënë detyrim nga KLSH. Pikërisht ky fakt, nuk është konsideruar kriter i pa plotësuar nga ana e KVO-së, për OE “H.” SHPK, i cili rezulton debitor kundrejt Bashkisë Këlcyre sipas Njoftimit nr. 2077, datë 22.10.2018 në shumën 162,488 lekë.

Konkretisht OE “H.” SHPK është shpallur fitues në dy procedura, konkretisht “Skema ujitëse Ballaban” dhe “Sistemim asfaltim Rrugët Goricë-Sukë etj.”

##### **Në këtë rast KVO ka vepruar me dy standarde.**

##### **Situata 2:**

2. Në procedurën me objekt “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë”, ka rezultuar:

- OE “Sh.” SHPK, ka dhënë dëshmi të rreme përsa i përket Shtojcës nr. 10 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe në proces” dhe Shtojcës nr. 11. Nga OE, nuk janë deklaruar kontratat ku është shpallur fitues për kryerjen e punëve publike me objekt “Sistemim i Ujërave të Lartë Fierzë dhe Margegaj” Bashkia Tropojë.

- OE “TD” SHPK, ka dhënë dëshmi të rreme përsa i përket Shtojcës nr. 10 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe në proces” dhe Shtojcës nr. 11. Nga OE, nuk janë deklaruar kontratat ku është shpallur fitues për kryerjen e punëve publike me objekt “Riparim i Rrugës Zenel Poçi” Bashkia Sarandë dhe “Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse” Bashkia Himarë.

- BOE “E” SHPK & “Alba Konstruksion” SHPK, (i shpallur fitues) nuk ka plotësuar pikërisht këtë kriter, por që nuk është evidentuar nga KVO. OE “E” SHPK, ka dhënë dëshmi të rreme pasi në Shtojcën nr. 10 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe ose në proces”, ka deklaruar kontratën me objekt “Rikonstruksion i Qendrës Kulturore Multifunktionale” Këlcyrë me vlerë 14,877,324 lekë me TVSH, ndërkohë që kjo kontratë është e mbyllur dhe realizuar gjatë periudhës 06.06.2017-06.09.2017. Ky fakt është konfirmuar edhe me anë të Shtojcës nr. 8 “Formular vlerësimi”, nga Bashkia Këlcyrë, e paraqitur nga OE “E” SHPK, si dokument për përmbushjen e kriterit 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i OE”, mbi punët e ngjashme të realizuara në procedurën që është në shqyrtim. Fakti që nga OE “E” SHPK, është deklaruar informacion i pasaktë, ose i rremë nuk është evidentuar nga



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

KVO, në këtë rast.

**KVO në vlerësimin e OE “TD” SHPK dhe OE “Sh.” SHPK, të njëjtën mangësi e ka etiketuar “është deklaruar informacion i pasaktë, ose i rremë” ndërsa në vlerësimin e OE “E” SHPK nuk e konsideron si të tillë.**

#### **Në këtë rast, KVO ka vepruar me dy standarde.**

#### **Situata 3:**

**3.** Në procedurën me objekt “Rikonstruksion i Urës në Qendër të Qytetit Këlcyrë” ka rezultuar se OE “Alba Konstruksion” SHPK, nuk ka përmbushur kërkesat për plotësimin e kriterit kualifikues mbi pagesën e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Nga OE është paraqitur vërtetim i cili konfirmon se nuk ka detyrime të pashlyera deri në 31 mars 2018, ndërkohë që procedura e prokurimit zhvillohet në muajin qershor 2018. Muaji i maturuar i fundit i takon muaji Prill 2018, i cili ka afat pagese deri në fund të muajit Maj 2018, referuar vendimit të ERE nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit më energji elektrike të klientëve jo familjarë”, neni 9 ku cilësohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”. Për rrjedhojë OE “Alba Konstruksion” SHPK duhet të paraqiste vërtetim mbi shlyerjen e detyrimeve deri në Prill 2018. Nga OE është paraqitur vërtetimi nr. 3532, datë 30.04.2018, ku cilësohet se detyrimet deri më Mars 2018 janë 0. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e DT, por edhe VKM neni 26 “Kontratat e punëve publike”, pika 7, germa c ku cilësohet: “...një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. **Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik...**”.

**Nga ana e KVO-së nuk është evidentuar ky fakt dhe e ka kualifikuar këtë OE.**

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Këlcyrë”, KVO ka s’ kualifikuar OE “Eral Konstruksion” SHPK, i cili ka paraqitur vërtetim për pagesën e energjisë elektrike në kundërshtim me kërkesat e DST. Vërtetimi nr. 1381, datë 08.11.2018 i OSHEE nuk ka përfshirë pagesën e muajit të maturuar, në kundërshtim edhe me vendimin e ERE nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit më energji elektrike të klientëve jo familjarë”, neni 9 ku cilësohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”. Nga këqyrja e dokumentacionit në SPE ka rezultuar se OE “Eral Konstruksion” SHPK ka paraqitur vërtetimin nr. 1524, datë 11.12.2018, ku vërtetohet se ka paguar dhe detyrimet e muajit Nëntor, i cili është muaji i fundit i maturuar, por që ka afat shlyerje deri më datë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

31.12.2018. KVO nuk i është referuar dokumentacionit të hedhur në SPE. Ky kriter është plotësuar nga OE, por KVO e ka konsideruar të paplotësuar, duke veruar në kundërshtim me vendimin e ERE.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Këlcyrë” ka rezultuar se OE A SHPK, sipas vërtetimit nr. 22627/1, datë 05.12.2018 ky OE, ka shlyer detyrimet deri më datë 31.10.2018. Sipas DT hapja e procedurës bëhet më datë 17.12.2018, për këtë fakt OE ka paraqitur shlyerjen e detyrimeve të muajit tetor, pasi muaji Nëntor 2018, referuar Vendimit të ERE nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit më energji elektrike të klientëve jo familjarë”, neni 9 ku cilësohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”, ka afat shlyerje deri me 31 dhjetor 2018. KVO ka vepruar në përputhje me vendimin e ERE.

#### Situata 4:

##### Në këtë rast, KVO ka vepruar me dy standarde.

4. Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Këlcyrë” ka rezultuar se BOE “E” SHPK & “AK” SHPK, ka paraqitur Ofertën ekonomike në kundërshtim me kërkesat e DT, Shtojca nr. 1. Mosplotësimi i ofertës ekonomike sipas Shtojcës nr .1, në të gjitha rastet e tjera nga KVO është konsideruar me të drejtë mosplotësim i kriterëve për kualifikim përcaktuar në DT, Udhëzime për ofertuesit Seksioni 1 "Hartimi i ofertës", ku cilësohet se ofertat që nuk do të përgatiten sipas DT, do të refuzohen si të papranueshme. Ky fakt nuk është evidentuar nga KVO.

Konkretisht, për këtë kriter të pa përmbushur është s’ kualifikuar BOE “AC” SHPK & “K” SHPK pjesëmarrës në këtë procedurë. Po kështu në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i Rrjetit të Jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë”, BOE “B.9” SHPK & “R.C” SHPK & “A.S.” SHPK & “Sh.” SHPK dhe OE “S.” SHPK janë s’ kualifikuar ndër të tjera edhe për faktin se nuk e ka paraqitur Formularin e ofertës sipas dokumentit standard, Shtojca nr. 1, plotësimi i të cilës është sqaruar për OE në DST “Udhëzime për operatorët”, pika 2.1 “Përlllogaritja e ofertës ekonomike”

#### Situata 5:

##### Në këtë rast, KVO ka vepruar me dy standarde.

5. Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Përgjithshme Këlcyrë”, ka rezultuar se në Analizën e çmimeve të paraqitur nga BOE "E" SHPK & “A” SHPK, për përlllogaritjen dhe analizën e çmimeve për 2 zëra punimesh me numër analize 3.45/1, është aplikuar paga bazë orare, 138 lekë dhe me numër analize 3.643, është aplikuar paga bazë orare 125 lekë. Ky fakt nuk është evidentuar nga KVO dhe BOE është kualifikuar dhe shpallur fitues.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara”, ka rezultuar se OE i shpallur fitues “J.” SHPK në Analizën e çmimeve për 3 zëra punimesh, konkretisht: An-3, është aplikuar paga bazë orare, 125 lekë; An-2, është aplikuar paga bazë orare 125 lekë dhe An-5, është aplikuar paga bazë orare 125 lekë. Ky fakt nuk është evidentuar nga KVO dhe BOE është kualifikuar dhe shpallur fitues.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes Spitalit”, nga këqyrja e dokumentacionit ka rezultuar se OE “J.” SHPK, në analizat e çmimeve për 6 zëra punimesh si: “Skarifikim shtresash asfalti ekzistues me makineri”, “Prerjeje bime të vogla”; Spërkatje me emulsion bituminoz”, “Pllaka guri”; “Shtresë zhavorri” dhe “Shtresë rëre”, ka përcaktuar pagë orare në shumën 125 lekë, ndërkohë që paga orare bazë e lejueshme është në shumën 149 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Kodin e punës. Ky fakt nuk është evidentuar nga KVO.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim Rrugët Goricë-Sukë etj.”, OE “E.C. Company” SHPK, është aplikuar paga orare bazë nën nivelin minimal të lejuar. Për zërat e punimeve 3.46/1 është aplikuar paga orare 148 lekë dhe për zërin e punimeve 2.258, është aplikuar paga orare 125 lekë. Nga KVO është konsideruar shkelje e VKM nr. 809/2018 "Për pagën minimale në shkallë vendi", ku paga bazë orare minimale është 149 lekë dhe zbatimi i saj është detyrim sipas Kodit të Punës, neni 19.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” për BOE- “B.9” SHPK & “R.C” SHPK & “A.S.” SHPK & “Sh.” SHPK, aplikimi në analizat e çmimeve (për disa zëra punimesh si: 3.47/c, 3.377, 2.258, 2.426/3 etj,) i pagës orare në shumën 125 lekë, ndërkohë që paga orare bazë e lejueshme është në shumën 149 lekë, është konsideruar veprim në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. (Etj.)

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Skema Ujitëse Ballaban” OE “B9” SHPK, nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim dhe është s’ kualifikuar ndër të tjera edhe për faktin se në analizat e çmimeve për disa zëra punimesh si: 3.2, 3.45/1, 3.47/1b, ka përcaktuar pagë bazë minimale orare në shumën 125 lekë, ndërkohë që paga bazë minimale orare e lejueshme është në shumën 149 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Ky veprim vjen në kundërshtim me aktet ligjore të fushës si me VKM nr. 809, datë 26.12.2018 po ashtu edhe më Kodin e Punës, neni 19. **Sa më sipër, KVO në tre raste nuk e evidenton këtë shkelje dhe në tre raste e konsideron shkelje. KVO vepron me dy standarde.**

**Kriteri:** LPP, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave” dhe VKM neni 66 “Shqyrtimi i ofertave”.

**Ndikimi/Efekti:** Vlerësimi i OE me dy standarde nga ana e KVO-së cenon trajtimin e barabartë të OE, duke vlerësuar dhe kualifikuar disa OE pa plotësuar të gjitha kërkesat për përmbushjen e kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT.

**Shkaku:** Veprime jo ligjore të KVO-së.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Për shkelje të nenit 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t’i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Konkluzion mbi pikën 4.3.3.

- Gjatë vitit 2018, janë zhvilluar 6 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit në shumën 187,066,669 lekë, nga të cilat u audituan 5 procedura me vlerë totale të fondit limit në shumën 184,094,723 lekë, duke mbuluar me auditim 98.4 % të fondeve. Vlera e kontratave të audituara për vitin 2018, rezulton në shumën 173,309,171 lekë, me një kursim në vlerë nominale kundrejt fondit limit në shumën 10,785,542 lekë, ose me një ulje në masën 5.8 %.
- Gjatë vitit 2019, janë zhvilluar 3 procedura prokurimi me vlerë totale të fondit limit në shumën 204,131,585 lekë, nga të cilat u audituan 3 procedura me vlerë totale të fondit limit në shumën 204,131,585lekë, duke mbuluar me auditim 100 % të fondeve. Nga auditimi rezultoi se vlera e kontratave të audituara për vitin 2019, rezulton në shumën 202,589,148 lekë, me një kursim në vlerë nominale kundrejt fondit limit në shumën 1,542,437 lekë, ose me një ulje në masën 0.75 %.
- Nga auditimi rezultoi se, në 6 procedura me vlerë totale të fondit limit në shumën 156,014,634 lekë, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga KVO, në kundërshtim me aktet rregullative është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet, në shumën **23,967,868 lekë, sipas Tabelës anekse nr. 4.5 “Efektet financiare”**  
Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të OE të shpallur fitues, në kundërshtim me LPP nenin 24, 46 dhe 53 dhe VKM neni 66. Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar efekt negativ, përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe efikasitet i fondeve publike. Ky konkluzion reflektohet edhe në të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, ku pothuajse në të gjitha rastet është shpallur fitues oferta më vlerën më të lartë, si dhe në diferencën midis fondit limit dhe vlerës së kontratës, ku në vitin 2018 paraqitet me ulje në masën 5.8 % dhe në vitin 2019 me ulje në masën 0.75 %.
- Gjithashtu, mbi vlerësimin e 5 kërkesave për përmbushjen e “Kritereve të veçanta për kualifikim” për disa OE nga ana e KVO-së, janë konsideruar shkelje dhe mos plotësim i tyre, ndërsa për disa OE nuk janë evidentuar dhe nuk janë konsideruara si të tilla, duke sjellë kualifikim të tyre pa plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

Tabela nr. 4.4 “Të dhëna mbi prokurimet e zhvilluara dhe audituara, viti 2018 & 2019”

Nr.	Emërtimi	Operatorët Ekonomikë			Renditja e fituesit
		Pjesëmarrës	Kualifikuar	Skualifikuar	
1	Rikonstruksion Ura në qendër të Qytetit Këlcyrë	5	1	4	5
2	Rikonstruksion i shkollës së Mesme Këlcyrë	6	1	5	6
3	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit	10	5	5	3
4	Sistemim asfaltim Rruga Sukë-Goricë, etj.	5	3	2	3
5	Rikonstruksion i Rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Këlcyrë	4	2	2	2
6	Rikonstruksion i Rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë	4	1	3	3
7	Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit	2	1	1	2
8	Skema ujitëse Ballaban Ujitja e fushës Ballaban	5	1	4	5
	<b>Totali</b>	<b>37</b>	<b>14</b>	<b>23</b>	

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë  
Punoi: KLSH

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.3.3. të Programit të auditimit), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/9, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 56-113. Mbi këtë pjesë të PRA u paraqitën observacionet nga KVO me nr. 3151, datë 15.12.2020, protokolluar në KLSH me nr. 612/6, datë 17.12.2020, sa më poshtë:**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### **Pretendimet e subjektit:**

- 1. Lidhur me procedurën e prokurimit me objekt ”Rikostruksioni i Urës në Qendër të Qytetit të Këlcyrës”.**
  - a. *Sipas grupit të auditimit në aktin e konstatimit citohet se operatori Alba Konstruksion sh.p.k nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen mbi pagesën e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike përkatësish muajin Prill 2018.*
- 2. Lidhur me procedurën “Rikostruksioni i Qendrës Multifunkionale Këlcyrë”**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se deklarimi si kontratë në proces është një lapsus. Paraqitja e kontratës të mësipërme si kontratë e ngjashme në procedurën objekt auditimi shoqëruar me dokumentacion si formular vlerësimi lëshuar nga Bashkia Këlcyrë, akt kolaudimi mbajtur më datë 14.12.2017, certifikata e marrjes në dorëzim datë 15.12.2017 si dhe faturat tatimore tregojnë qartazi që kjo kontratë ka përfunduar dhe për rrjedhojë deklarimi si punë në proces në tenderin e datës 11.06.2018 është një lapsus.
- 3. Për procedurën e prokurimit me objekt”Rikostruksioni i Shkollës të Mesme të Përgjithshme”.**
  - Lidhur me pretendimet e ngritur nga ana e grupit të auditimit KVO gjykon se pretendimet nuk qëndrojnë. Së pari referuar vërtetimit të energjisë të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “AK” SHPK, KVO ka konstatuar se vërtetimi i paraqitur nr.22627/1 datë 05.12.2018 dëshmon se operatori i sipërpërmendur ka shlyer detyrimet e muajit Tetor 2018. Duke qënë se data e zhvillimit të procedurës është 17.12.2018 operatori ekonomik ka dëshmuar pagesën e muajit Tetor 2018 (bashkëngjitur këtij materiali vërtetimi I OSHHE 22627/1 datë 05.12.2018 I paraqitur në sistemin elektronik.
  - Së dyti në lidhje me ofertën e paraqitur sipas shtojcës 1 sqarojmë se oferta është paraqitur konform rregullave të prokurimit publik, ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” si dhe sipas strukturës të preventivit të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Këlcyrë.
  - Në lidhje me një nga zërat e punimeve të përllorësitur nga operatorët ekonomikë BO”E” SHPK “AK” SHPK me pagë orare prej 125 lekësh ky pretendim nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet në raportin përfundimtar.
- 4. “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet të pafavorizuara,Bashkia Këlcyrë”.**
  - Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik J. SHPK grupi i auditimit shprehet se KVO nuk duhet të kualifikonte operatorin ekonomik për shkak se disa nga zërat janë përllorësitur me pagë orare 125 lekë. Referuar pretendimit të mësipërm KVO e ngritur për procedurën objekt auditimi pretendim nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet në raportin përfundimtar.
- 5. Për procedurën e prokurimit me objekt”Sistemim Asfaltim Rruga Sukë Podgoran Fushë,Rruga Goricë,Rruga Komarak e Vinokash rruga Gur Fshat Këlcyre, Rruga Rriban.”**
  - Në projektraportin e dërguar nga ana e KLSH-së lidhur me procedurën e sipërcituar shprehet se operatori ekonomik E.C., SHPK është skualifikuar për shkak se nuk ka përllorësitur pagën orare konform legjislacionit në fuqi si dhe për shkak se 2 automjete autobetoniere marrë më qera nga qeradhënësi Eurobeton i cili ia ka dhënë njëkohësisht edhe 2 operatorëve ekonomikë AV SHPK, si dhe TD SHPK. Në aktin e konstatimit arsyetohet se përgjegjësia ligjore nuk është e operatorit ekonomik qiramarrës por e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

operatorit ekonomik qiradhënës. Lidhur me pretendimin e mësipërm citojmë se zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së njetit, mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Ky i fundit nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratave respektive të qerasë të cilat janë lidhur rregullisht përpara noterit publik.

- Së dyti në aktin e konstatimit të mbajtur nga grupi i auditimit citohet se njëkohësisht operatori ekonomik H. SHPK (operatoir i shpallur fitues) rezulton debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë në vlerën 162,488 lekë sipas njoftimit të dërguar më datë 22.10.2018.

#### 6. Për procedurën “Rikonstruksioni i Rrugëve të Lagjes të Spitalit”

- Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “J.” SHPK grupi i auditimit shprehet se operatori ekonomik duhej skualifikuar për shkak se disa nga zërat janë paraqitur me pagë orare 125 lekë. Ky pretendim i ngritur nga ana e grupit të auditimit nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk duhet të përfshihet si shkelje në projektraport.
- Gjithashtu theksojmë se KVO nuk ka skualifikuar operatorët ekonomikë vetëm për një arsye skualifikimi por janë skualifikuar për një sërë arsyesh pasqyruar edhe në procesverbalin e vlerësimit dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se KVO ka vepruar me dy standarte.

#### 7. Për procedurën e prokurimit me objekt “Skema Ujitëse Ballaban”

- Lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “H.” SHPK citohet se operatori ekonomik është debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë sipas njoftimit nr. 2077, datë 22.10.2018 konkretisht në vlerën 162, 488 lekë. Lidhur me pretendimin e sipërcituar sqarojmë se çështja e operatorit ekonomik H. SHPK është ndjekur dhe nga organet e hetimit gjyqësor. Regjistrimi i këtij procedimi penal mbi bazën e kallëzimit të KLSH-se, pra investimi i saj dhe Gjykatës Përmet si organe të drejtësisë, automatikisht solli ndërprerjen e procedurës administrative të ndjekjes së arkëtimit të shumës sipas nenit 36 të KPC. *Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje që është duke u gjykuar nga gjykata si dhe ndjekjes po kështu u ndërpre edhe ndjekja e rrugës gjyqësore (padi civile) sepse sipas nenit 297/a të KPC, Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative; Pra, duke qenë se çështja e operatorit ekonomik H. SHPK është ndjekur nga prokuroria dhe gjykata e rrethit gjyqësor Përmet (për të cilën është vendosur pushimi i çështjes) atëherë Autoriteti Kontraktor nuk ka ndjekur arkëtimin e shumës të operatorit ekonomik H. SHPK në respekt kjo dhe të nenit 36 të KPC.*

- 8. Gjithashtu theksojmë se KVO nuk ka skualifikuar operatorët ekonomikë vetëm për një arsye skualifikimi por janë skualifikuar për një sërë arsyesh pasqyruar edhe në procesverbalin e vlerësimit dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se KVO ka vepruar me dy standarte.

#### Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Pretendimi i subjektit në lidhje me **pikën 1**, me shlyerjen e detyrimeve të OE “A.K.” SHPK, nuk pranohet, pasi sipas vendimit të ERE, OE, duhet të paraqiste shlyerjen e detyrimeve të muajit Prill, si muaji i fundit i maturuar, likuidimi i të cilit ka afat deri më 31.05.2018, pra para zhvillimit të procedurës në Qershor 2018.
2. Pretendimi i KVO-së, në lidhje me **pikën 2**, se është një lapsus nuk pranohet. Nga KVO nuk është videntuar ky fakt gjatë shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura, nuk është kërkuar sqarim nga OE, si dhe nuk është trajtuar si lapsus gjatë vlerësimit të procedurës, ndërkohë që për OE nga KVO është konsideruar paraqitje e informacionit të “rremë”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Në lidhje **pikën 3**, me shlyerjen e detyrimeve të energjisë nga OE “A.K.” SHPK, observacioni pranohet dhe është reflektuar në RPA. Observacionet e tjera në lidhje me paraqitjen e ofertës ekonomike dhe përlllogaritjen e pagës orare, më pak se 149 lekë në analizën e çmimeve, nuk pranohen, pasi nuk është paraqitur asnjë argument ligjor.
- Pretendimi i KVO, në lidhje me pretendimet e ngritura **në pikën 4, 5 dhe 6** nuk pranohen, pasi nuk është paraqitur asnjë argument ligjor për të justifikuar qëndrimin e saj, në lidhje me përlllogaritjen e pagës orare në analizën e çmimeve të paraqitura nga OE.
- Në lidhje **me pikën 7**, vlerësimin e OE “H.” SHPK, sqarojmë se ky OE, në ofrat e paraqitura ka plotësuar kriteret kualifikuese, përveç faktit se rezulton debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë. Ky fakt nuk është evidentuar nga ana e KVO-së, e cila në rastin e OE “Sh.” SHPK është treguar shumë ekzigjente, duke e skualifikuar nga gara për këtë fakt (debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë). Gjithashtu, sqarojmë se nga ana e KVO-së, nuk është paraqitur asnjë referencë mbi aktet e prokurorisë apo gjykatës, të cilat kanë trajtuar çështjen e OE “H.” SHPK, si dhe nuk kanë paraqitur asnjë dokumentacion mbi këtë çështje dhe pretendim të saj.
- Në lidhje **me pikën 8** dhe qëndrimet e KVO-së me dy standarde në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve kualifikuese nga ana e OE, nuk janë paraqitur argumente ligjore, por është justifikuar me faktin se ka patur edhe kriteret e tjera të paplotësuara nga OE. Në lidhje me këtë sqarojmë se, ligji dhe aktet rregullative janë të qarta në këtë trajtim, ku është theksuar se një OE kualifikohet pasi ka përmbushur të gjitha kriteret, pra mjafton dhe një i paplotësuar. Gjithashtu, KVO e cila në rastin e Bashkisë Këlcyrë është pothuajse e njëjta në të gjitha procedurat e kryera, ka vepruar në mënyrë të hapur me dy standarde në lidhje me vlerësimin e OE.

#### **4.3 Mbi auditimin e procedurave të prokurimit për mallra e shërbime**

Në zbatim të pikës 4.3 të programit, referuar Regjistrin të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimit publik, ka rezultuar se janë zhvilluar 3 procedura “Blerje mallrash” për periudhën 2018, 2019 dhe 01.01.2020-30.06.2020, me objekt “Blerje karburant”. Meqenëse numri i procedurave është i kufizuar dhe RA është vlerësuar i lartë, u audituan të tre procedurat e realizuara.

Tabela nr. 4.6 “Procedura blerje mallra dhe shërbime viti 2018-2020”

Nr.	Periudha	Vlera
1	2018	8,839,562
2	2019	8,716,586
3	2020	6,323,189

#### **4.3.1. Mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese.**

**Konkluzion:** Nga auditimi i kryer mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe hartimin e dokumenteve të tenderave me objekt “Blerje karburant”, për vitet 2018, 2019 dhe 01.01.2020-30.06.2020, si dhe mbi zbatimin e procedurave nga NJP ka rezultuar se, ka vepruar në përputhje me LPP dhe VKM nenin 57, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, pika 3. Kriteret ishin në përputhje me natyrën e shërbimit dhe vlerën limit të kontratës, dhe nuk përbënin pengesë për pjesëmarrjen e operatorë ekonomikë. NJP, ka mbajtur Procesverbalet përkatëse për miratimin e DT, të cilët janë të nënshkruar në çdo faqe nga NJP.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

**4.3.2. Nga auditimi i vlerësimit të OE, nga KVO ka rezultuar:**

1.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant për automjete 2018”		
1.Urdhër Prokurimi nr.1 datë 20.06.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. 1, datë 20.06.2018	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr.2 datë 20.06.2018
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedure e hapur”	1.AQ (Juriste e jashtme) 2.BI (inxhinier) 3.S.V. (Agronom)	1.A.L. ( kryetar) 2.AQ (anëtar) 3.RH (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,839,562 lekë	6.Oferta fituese: BOE “D.O.” sha & “E.O.” shpk Vlera marzh fitimi 16%.	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 16.07.2018 Ora 08.30	9.Burimi Financimit: Grant + të ardhura	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO
	14. Data e lidhjes së kontratës: 31.07.2018	15. Afati i kontratës Deri më 31.12.2018

2.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant për automjete 2019”		
1.Urdhër Prokurimi nr. datë 11.02.2019	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Urdhër nr. datë 11.02.2019	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. datë 11.02.2019
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedure e hapur”	1.AQ (Juriste e jashtme) 2.BI (inxhinier) 3.S.V. (Agronom)	1.E.L. ( kryetar) 2.AQ (anëtar) 3.RH (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,716,586 lekë	6.Oferta fituese: BOE “D.O.” sha & “E.O.” shpk Vlera marzh fitimi 18%.	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 07.03.2019 Ora 08.30	9.Burimi Financimit: Grant + të ardhura	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO
	14. Data e lidhjes së kontratës: 26.03.2019	15. Afati i kontratës Deri më 31.12.2018

3.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant për automjete 2020”		
1.Urdhër Prokurimi nr.1 datë 19.03.2020	3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kriterëve dhe specifikimeve teknike:	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër nr. datë 19.03.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Kërkesë për propozim”	1.AQ (Juriste e jashtme) 2. JN (inxhinier) 3.S.V. (Agronom)	1.RH ( kryetar) 2.AQ (anëtar) 3. SK (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,323,189 lekë	6.Oferta fituese: BOE “D.O.” sha & “E.O.” shpk Vlera marzh fitimi 18%.	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 07.04.2019 Ora 09.00	9.Burimi Financimit: Grant + të ardhura	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	12. Përgjigje ankesës nga AK Jo	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO
	14. Data e lidhjes së kontratës: 27.05.2020	15. Afati i kontratës Deri më 31.12.2020

Për vitet objekt auditimi, rezulton se për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburanti”, ka marrë pjesë vetëm 1 OE, konkretisht BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA, të cilët janë kualifikuar dhe shpallur fitues.

Viti	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
2018	BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA	16% marzh fitimi	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2019	BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA	18 % marzh fitimi	Kualifikuar dhe shpallur fitues
2020	BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA	19 % marzh fitimi	Kualifikuar dhe shpallur fitues



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Titulli i Gjetjes 1: Auditimi i vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit me objekt “Blerje karburanti” për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

##### Situata 1:

Në vlerësimin e ofertave për procedurën e vitit 2018, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA, duke mos plotësuar të gjitha kriteret.

- BOE nuk përmbush pikën 2.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit e cila kërkon paraqitjen e kopjeve të vërtetuara të bilancit të vitit 2017, ndërkohë që OE “D.O.” ka paraqitur vetëm bilancin e vitit 2016.

- OE “D.O.”, ka paraqitur Autorizimin për tregtimin me pakicë të karburanteve, kopje të pa noterizuar, në kundërshtim me kërkesën e vendosur në DST, e cila kërkon që të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale, ose kopje të noterizuara.

- BOE nuk përmbush pikën 2.3/f, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, e cila kërkon nga OE që shërbimin e furnizimit me karburant ta kryejnë nëpërmjet kartave elektronike. BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se disponon shërbimin me karta.

Në vlerësimin e ofertave për procedurën e vitit 2019, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA duke mos plotësuar të gjitha kriteret.

- BOE nuk përmbush pikën 2/d të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, e cila kërkon nga OE, paraqitjen e Vërtetimit që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

BOE ka paraqitur vërtetimet e lëshuara me datë 14.02.2019, në të cilin përkrahë se secili OE ka likuiduar detyrimet deri me datë 13.02.2019, pa përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2019. Në kushtet kur tenderi zhvillohet me datë 07.03.2019, është detyrim për marrjen pjesë në tendera likuidimi i faturës së maturuar që në rastin konkret rezulton të jetë ajo e Janarit 2019 e cila rezulton e pa paguar.

- OE “D.O.”, ka paraqitur Autorizimin për tregtimin me pakicë të karburanteve, kopje të pa noterizuar, në kundërshtim me kërkesën e vendosur në DST, e cila kërkon që të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale, ose kopje të noterizuara.

- BOE nuk përmbush pikën 2.3/f, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, e cila kërkon nga OE që shërbimin e furnizimit me karburant ta kryejnë nëpërmjet kartave elektronike. BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se disponon shërbimin me karta.

Në vlerësimin e ofertave për procedurën e vitit 2020, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “D.O.” SHPK & “E.O.” SHA duke mos plotësuar të gjitha kriteret.

##### Situata 3:

- OE “D.O.” SHPK, ka paraqitur Autorizimin për tregtimin me pakicë të karburanteve, policen e sigurimit si dhe vërtetimin teknik kopje të pa noterizuara, në kundërshtim kërkesën e vendosur në DST e cila kërkon që të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

- BOE nuk përmbush pikën 2.3/f, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, e cila kërkon nga OE që shërbimin e furnizimit me karburant ta kryejnë nëpërmjet kartave elektronike. BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se disponon shërbimin me karta.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar <i>Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1 germa (ç) Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:</i> <i>Nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;</i> <i>Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1 “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.”;</i> <i>Nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.</i></p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos kryerja e procedurës konform ligjit për prokurimit publik, duke kualifikuar OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese, mund të rrezikojë zbatimin me cilësi të Kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i akteve ligjore, rregullative dhe kritereve të përcaktuara në DT.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E lartë</b>
<b>Rekomandim</b>	Për shkelje të nenit 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të LPP-së, në nenin 72 “Kundërvajtjet administrative” të LPP-së, parashikon masa administrative dhe disiplinore, të cilat do t’i përcillen për vendimmarrje APP-së, në zbatim të LPP-së, neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”, pika 2 germa (g).

**Konkluzion:** Sa më sipër, BOE nuk ka plotësuar kriteret e vendosura në DT dhe në këto kushte KVO, nuk duhet të kishte kualifikuar në të tre vitet BOE “D.O.” SHPK dhe “E.O.” SHA, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO, duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** KVO, e përbërë nga z. A.L. (1 procedurë), z. AQ (3 procedura), znj. RH (3 procedura) si dhe znj. SK (1 procedurë).

Sa më sipër, është trajtuar në Akt konstatimi nr. 7 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/7, datë 18.09.2020 (referuar pikës 4.3 e Programit të auditimit), si dhe trajtuar në faqet 56-113 të PRA. Mbi këtë pjesë të PRA janë paraqitur nga KVO observacionet me nr. 3151, datë 15.12.2020, protokolluar në KLSH me nr. 612/6, datë 17.12.2020, sa më poshtë:

#### **Pretendimi i subjektit:**

Për vitin 2018: - KVO argumenton se gjetjet e KLSH nuk qëndrojnë, pasi OE “D.O.” SHPK ka paraqitur në sistemin elektronik bilancin e vitit 2017 konform kritereve të veçanta të kualifikimit. Në lidhje me pretendimin se nuk kanë paraqitur dokumentacion për të provuar se përmbush kriterin për kryerjen e shërbimit nëpërmjet kartave elektronike, KVO shprehet se BOE ka paraqitur në sistemin elektronik deklarata të nënshkruara dhe të vulosura me anë të së cilës deklarojnë se do të kryejnë furnizimin me anë të kartave elektronike. KVO citon nenin 62 të LPP, sipas të cilit “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.*

Sipas KVO, AK ka mjetet dhe kushtet për të monitoruar zbatimin e kontratës për tu siguruar se ajo realizohet nëpërmjet furnizimit të karburantit me karta elektronike.

Për vitin 2019: - KVO argumenton se gjetjet e KLSH nuk qëndrojnë, pasi autorizimi i lëshuar është paraqitur në formë origjinale. Në lidhje me pretendimin se nuk kanë paraqitur dokumentacion për të provuar se përmbush kriterin për kryerjen e shërbimit nëpërmjet kartave elektronike, KVO shprehet se BOE ka paraqitur në sistemin elektronik deklarata të nënshkruara dhe të vulosura me anë të së cilës deklarojë se do të kryejnë furnizimin me anë të kartave elektronike. KVO citon nenin 62 të LPP, sipas të cilit “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, *autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.*

Sipas KVO, AK ka mjetet dhe kushtet për të monitoruar zbatimin e kontratës për tu siguruar se ajo realizohet nëpërmjet furnizimit të karburantit me karta elektronike.

Për vitin 2020: - KVO argumenton se gjetjet e KLSH nuk qëndrojnë, pasi autorizimi i lëshuar është paraqitur në formë origjinale. Në lidhje me pretendimin se nuk kanë paraqitur dokumentacion për të provuar se përmbush kriterin për kryerjen e shërbimit nëpërmjet kartave elektronike, KVO shprehet se BOE ka paraqitur në sistemin elektronik deklarata të nënshkruara dhe të vulosura me anë të së cilës deklarojë se do të kryejnë furnizimin me anë të kartave elektronike. KVO citon nenin 62 të LPP, sipas të cilit “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, *autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.*

Sipas KVO, AK ka mjetet dhe kushtet për të monitoruar zbatimin e kontratës për tu siguruar se ajo realizohet nëpërmjet furnizimit të karburantit me karta elektronike.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Audituesit e KLSH sqarojnë se:

- Për procedurën e vitit 2018, argumenti i KVO se OE “D.O.” shpk, ka paraqitur bilancin e vitit 2017 nuk qëndron, pasi dokumenti i hedhur në SPE me nr. 39 “Bilanc Das Tatime (PDF)”, paraqet pasqyrat financiare të vitit 2016.

Në lidhje me pretendimin se BOE ka paraqitur deklaratë sipas të cilës marrin përsipër kryerjen e shërbimit me karta elektronike, audituesit sqarojnë se për kryerjen e këtij shërbimi, kërkohet që OE duhet të kryejë furnizimin me karburant të mjeteve nëpërmjet kartave elektronike. OE, duhet të provojë se disponon sistemin e kërkuar për të përmbushur kërkesën e vendosur në DT. (pika 2.3/f)

- Për procedurën e vitit 2019, argumenti i KVO se OE “D.O.” ka paraqitur autorizimin për tregtimin me pakicë të karburanteve në formë origjinale nuk qëndron, pasi nga SPE, rezulton se janë hedhur 2 dokumente, konkretisht dokumenti “AUT PAKICE (PDF)” i cili është kopje e pa noterizuar, si dhe dokumenti AUT PAKICE 2.pdf i cili është i paplotë dhe nuk ka vulën dhe nënshkrimin e lëshuesit të këtij dokumenti.

Në lidhje me pretendimin se BOE ka paraqitur deklaratë sipas të cilës marrin përsipër kryerjen e shërbimit me karta elektronike, audituesit sqarojnë se për kryerjen e këtij shërbimi, kërkohet që OE duhet të kryejë furnizimin me karburant të mjeteve nëpërmjet kartave elektronike. OE, duhet të provojë se disponon sistemin e kërkuar për të përmbushur kërkesën e vendosur në DT. (pika 2.3/f)

- Për procedurën e vitit 2020, argumenti i KVO se OE “D.O.” ka paraqitur autorizimin për tregtimin me pakicë të karburanteve në formë origjinale nuk qëndron, pasi nga SPE, rezulton se ky autorizim është hedhur në sistem me dokumentin “Dokumentet e pikës Këlcyrë (PDF)” dhe rezulton të jetë i pa noterizuar.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Në lidhje me pretendimin se BOE ka paraqitur deklaratë sipas të cilës marrin përsipër kryerjen e shërbimit me karta elektronike, audituesit sqarojnë se për kryerjen e këtij shërbimi, kërkohet që OE duhet të kryejë furnizimin me karburant të mjeteve nëpërmjet kartave elektronike. OE, duhet të provojë se disponon sistemin e kërkuar për të përmbushur kërkesën e vendosur në DT. (pika 2.3/f)

#### **4.3 Mbi auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.**

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2018 deri në 30.06.2020, rezultoi se janë zhvilluar 61 procedura, me fond limit pa TVSH në vlerën 11,881,707 lekë, dhe vlerë kontrate 10,124,034 lekë, me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,757,673 lekë.

Grupi i auditimit, vlerësoi për të audituar 36 procedura me fond limit 10,138,600 lekë, ose 85% e vlerës totale të fondit të prokuruar, referuar riskut të auditimit, të përcaktuar në planifikim dhe rishikuar gjatë fazës së auditimit në terren (nuk ka ndryshim).

Tabela nr. 4.7 “Procedurat e prokurimit (blerje të vogla) 01.01.2018-30.06.2020”

Periudha	Nr.	Vlera në Lekë			Të dhëna për numrin e pjesëmarrsve		Mbulimi me auditimit (vlerë)	
		Fondi limit pa tvsh	Fituesit pa tvsh	Diferenca nga fondi limit pa tvsh	Nr. pjesmarrë sve	Të s'kuali fikuar	Audituar	Pa audituar
01.10.2018-31.12.2018	27	4,843,832	4,184,705	659,127	446	151	4,187,117	656,715
01.01.2019-31.12.2019	26	4,345,690	3,643,515	702,175	426	150	3,335,698	1,007,522
01.01.2020-30.06.2020	8	2,692,185	2,295,814	396,371	194	95	2,615,785	76,400
<b>Gjithsej</b>	<b>61</b>	<b>11,881,707</b>	<b>10,124,034</b>	<b>1,757,673</b>	<b>1,066</b>	<b>396</b>	<b>10,138,600</b>	<b>1,740,637</b>

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga KBV, rezultoi se në përgjithësi janë zbatuar rregullat e vendosura në ligjin e prokurimit publik për blerjet e vogla, VKM dhe Udhëzimin përkatës. Çdo fillim viti është ngritur komisioni për blerjet e vogla me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, i cili ka funksionuar për gjithë vitin. Procedurat e prokuruar, janë parashikuar në regjistrin e parashikimeve të dorëzuar në APP. Në të gjitha rastet është nxjerrë urdhri i prokurimit, i cili mban firmën e titullarit, si dhe është shoqëruar me ftesën për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë.

**Mangësitë e konstatuara, janë trajtuar si më poshtë:**

**Titulli i Gjetjes 1: Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla) për periudhën 01.01.2018 deri në 30.06.2020.**

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se në procedurat e prokurimit për blerje të vogla, KBV në shumicën e procedurave, ka hartuar fondin limit duke bërë testimin e tregut, por pa referuar me dokumentacion përkatës gjurmën e këtij testimi (p.sh kërkesa zyrtare drejtuar operatorëve ekonomikë në fushën e prokuruar, si dhe përgjigjet zyrtare me çmimet që ofrojnë shërbimin apo blerjen e mallrave).

Gjithashtu, KBV, nuk ka firmosur faturat e shitjes për mallrat apo shërbimet e prokuruar, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në VKM apo Udhëzimet e APP.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59.  
Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 19.
- Ndikimi/Efekti:** Mos kryerja e procedurës konform kuadrit rregullator për prokurimet me vlerë të vogël.
- Shkaku:** Mosnjohje e ligjit, VKM dhe Udhëzimit përkatës për blerjet e vogla
- Rëndësia:** **E ulët**
- Rekomandim:** Për shkeljet e mësipërme, bazuar në nenin 37 të ligjit me nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, rekomandohet masa “Vërejtje” për punonjësit e mësipërm.

**Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:** KBV, i përbërë nga z. H.Sh., z. B.A., z. V.K. dhe znj. L.P.

#### **4.4. Auditim mbi zbatimin e kushteve në kontratave të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike.**

Për periudhën objekt auditimi janë lidhur 3 kontrata “Blerje karburant” me vlerë limit të tyre 23,879,337 lekë.

Nga Grupi i auditimit u audituan me zgjedhje 3 kontrata të realizuara për blerje mallarsh, për të cilat u auditua dosja e zbatimit të kontratës si dhe zbatimi i punimeve në terren. Konkretisht:

Sasia e karburantit është bërë hyrje sipas nevojave të paraqitura.

- Për vitin 2018, janë likuiduar 8,485,233 lekë pa TVSH, nëpërmjet 21 urdhra shpenzimesh. Diferenca mes vlerës së prokuruar dhe asaj të zbatuar është 354,329 lekë.
- Për zbatimin e kontratës së karburantit për vitin 2019, janë likuiduar 8,479,075 lekë pa TVSH, nëpërmjet 41 urdhra shpenzimesh. Diferenca mes vlerës së prokuruar dhe asaj të zbatuar është 237,510 lekë.
- Zbatimi i kontratës së karburantit për vitin 2020, e cila është në proces, janë likuiduar 2,432,383 lekë pa TVSH nëpërmjet 6 urdhra shpenzimesh.

Nga auditimi rezultoi se, urdhër shpenzimet ishin shoqëruar me të gjithë dokumentacionin bashkëngjitur. Likuidimi i faturave të karburantit është kryer në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, ku cilësohet:

*“5. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment. 6. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të livruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Likuidimi i blerje të vogla është kryer mbështetur në dokumentacionin justifikues, bashkëngjitur çdo urdhër shpenzimi.

#### **4.5. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues.**

##### **1. “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, Bashkia Këlcyrë**

**Titulli i Gjetjes 1: Mbi shtyrjen e punimeve dhe realizimin e kontratës, në mënyrë të paargumentuar teknikisht.**

**Situata:** Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1304, datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë, të përfaqësuar nga Titullari z. K.N. dhe Operatorit Ekonomik “H.” SHPK, me përfaqësues z. A.H., me licencë profesionale NZ 1246/9. Vlera e kontratës është 36,353,317 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 150 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

- **Për mbikëqyrjen e punimeve** të ndërtimit, sipas Urdhrit nr. 09, datë 10.06.2019, është caktuar dhe është lidhur kontrata me ing. S.Sh., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0894/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.

- **Për kolaudimin e punimeve** të ndërtimit, sipas Urdhrit nr. 10, datë 14.08.2020 është caktuar dhe është lidhur kontrata me ing. Kostandin Isufi, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0545/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.

- **Projekt preventivi:** Projekt preventivi i objektit është hartuar nga “Derbi-E” SHPK, në vitin 2008.

**Në dosje nuk administrohet leja e ndërtimit për këtë objekt.**

*Për mosveprimin e mësipërm, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor.*

**Zbatimi i punimeve:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 11.06.2019 dhe duhet të përfundonin në datën 11.11.2019, por kanë përfunduar me datë 14.08.2020, brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, ose **270 ditë më shumë se afati fillestar i përfundimit të kontratës.**

Është mbajtur procesverbal ndërmjet sipërmarrësit, mbikëqyrësit të punimeve dhe titullarit të institucionit për punimet që shtohen dhe hiqen në datën 25.09.2019.

Në aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit datë 11.06.2019, citohet që “...sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi merr në dorëzim objektin për realizimin e punimeve...”.

- Në amendamentin me nr. extra, datë 24.10.2019, është rënë dakord ndërmjet AK dhe Kontraktorit, që të shtyhet afati i përfundimit të punimeve, i përcaktuar në nenin 5 të kontratës (90 ditë), deri në datën 31.08.2020, ose 270 ditë nga afati kontraktual i përfundimit të punimeve. Kjo shtyrje është bërë pas pretendimit të sipërmarrësit të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

punimeve për kushte atmosferike jo të favorshme për kryerjen e punimeve sipas standardeve teknike në fuqi.

Nga verifikimi i ditarit të objektit dhe bazuar në afatin kontraktual të përfundimit të punimeve, sipas të cilit punimet duhet të përfundojnë në 11.11.2019, rezulton se ditari është mbajtur duke filluar në datën 13.06.2019 deri në datën 30.10.2019 dhe nga data 03.08.2020 deri në datën 14.08.2020, respektivisht me 76 ditë pune për periudhën e parë dhe 11 ditë pune për periudhën e dytë, ose gjithsej 87 ditë pune, **duke mos përmendura asnjë ditë me kushte jo të përshtatshme atmosferike**. Nisur nga sa më sipër, kërkesa dhe më pas miratimi nëpërmjet amendamentit, për 270 ditë shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, kur afati kontraktual është vetëm 150 ditë dhe në këtë afat është punuar 76 ditë, **është e palogjikshme dhe joligjore. Nga ana e AK nuk duhej pranuar kjo kërkesë dhe duhej bërë argumentimi teknik për numrin e ditëve që duhej shtyrë afati.**

**Kriteri:**

**Ndikimi/Efekti:**

Kontrata bazë, amendamentet, ditari i objektit dhe përmbajtja e tij. Shtyrje e punimeve në mënyrë të pajustificuar, gjë e cila ka sjellë mosrealizimin e objektit në afat dhe mos ofrimin e përmirësimit të infrastrukturës rrugore për popullatën e këtyre zonave.

**Shkaku:**

Nuk ka shkaqe dhe arsyeshme, të dokumentuara dhe justifikuese për shtyrjen e punimeve, ose përlllogaritje e gabuar e afatit të kryerjes dhe realizimit të punimeve, nga AK.

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandime:**

Titullari i Autoritetit Kontraktor, duhet të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësi dhe eliminimin e rasteve të tilla të shtyrjes së afateve kontraktuale të realizimit të punëve publike, në mënyrë të paragumetuar, të padokumentuar dhe të pambështetur në arsye teknike dhe ligjore.

**Konkluzion:** Autoriteti Kontraktor nuk duhet të kishte bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve më shumë se data 25.01.2020, ose 74 ditë më shumë se afati kontraktual i përfundimit të punimeve (150 ditë gjithsej sipas kontratës-76 ditë është punuar=74 ditë, nëse ditët e paevidentuara në ditarin e punimeve të kenë qenë ditë me kushte të papërshtatshme atmosferike).

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, mbajnë përgjegjësi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Përgjegjësi i Zyrës së Urbanistikës.

**Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

- Dokumentacioni teknik i zbatimit;
- Projekt preventivi,
- Situacioni përfundimtar,
- libri i masave, etj.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, Bashkia Këlcyrë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

14.Lidhja e kontratës nr. 1304 prot datë 10.06.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 36,353,317 lekë  OE fitues “H.” SHPK	16.Likuiduar deri dt 02.04.2020, 5,000,000 lekë me TVSH		
17- Situacioni Përfundimtar  -Vlera me tvsh 36,343,975 lekë  -Vlera pa tvsh 30,286,646 lekë	18.Afati i kontratës në dite  Parashikuar 150 ditë, Zbatuar 428 ditë.  Fillimi punimeve: 11.06.2019  Perfundimi punimeve : 14.08.2020	19. Zgjatja e kontratës  Nr. extra, datë 24.10.2019. Shtyrja e afatit deri në datë 31.08.2020 (9 muaj)		
20. Mbikëqyrësi i punimeve S.Sh.	Licenca Nr: MK 0894/1	Kontrata pa nr. prot, datë 10.06.2019		
21. Kolaudatori i punimeve K.I.	Licenca Nr: MK 0545/2	Kontrata pa nr prot, datë 14.08.2020		
22.Akt Kolaudimi datë 25.08.2020	23.Akt i marrjes në dorëzim pa datë Urdhëri nr. 11, datë 25.08.2020			

#### Titulli i Gjetjes 2:

**Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, Bashkia Këlcyrë, nga zbatuesi i punimeve OE “H” SHPK.**

#### Situata:

Nga verifikimi i librit të masave, konstatohet se ky dokument është i paplotë dhe jo në përputhje me UKM Nr.1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, sipas të cilit, një prej kolonave të librezës së masave është vendndodhja e punimit të kryer. Në librezën e masave, të administruar në dosjen teknike, gjatësitë e gërmimeve, të shtresave të ndryshme, të mureve, etj., janë me vendndodhje të papërcaktuar dhe jo sipas piketave të përcaktuar në vizatimet që shoqërojnë librin e masave, duke e bërë këtë dokument të palexueshëm dhe duke vështirësuar gjykimin objektiv të audituesit. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **591,263 lekë pa tvsh**, konkretisht:

Diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Strukturë monolite betoni C 16/20 për koka pusete” dhe “Strukturë monolite betoni C 12/15 me zgarë metalike 6 mm”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li><li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.</li><li>- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1304 prot datë 10.06.2019.</li><li>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, datë 10.06.2019.</li><li>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. prot, datë 14.08.2020.</li></ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Këlcyrë në shumën 591,263 lekë pa TVSH.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 591,263 lekë pa TVSH nga OE “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1304 prot datë 10.06.2019 me “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, <i>Bashkia Këlcyrë</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Konkluzion:** Vlera prej 591,263 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. S.Sh. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. K.I. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
3. Z. K.N. me detyrë Kryetar i Bashkisë Këlcyrë;
4. Z. J.N., me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.5 të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 9 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/14, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 56-113. Mbi këtë pjesë të PRA nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.**

## **2. “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë**

### **Titulli i Gjetjes 3: Mbi shtyrjen e punimeve dhe realizimin e kontratës.**

**Situata:** Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1046, datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë, të përfaqësuar nga Titullari z. K.N. dhe Operatorit





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Ekonomik “J.” SHPK, me përfaqësues z. J.B., me licencë profesionale NZ 1529/15. Vlera e kontratës është 34,858,247 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është **përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.**

- **Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit**, është caktuar dhe është lidhur kontrata pa nr. prot, datë 07.05.2019, me ing. S.Sh., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0894/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.

- **Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit**, është caktuar dhe është lidhur kontrata pa nr. prot, datë 15.06.2020, me ing. Taqo Niçka, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0740/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.

- **Projekt preventivi i objektit** është hartuar nga zyra e Urbanistikës së Bashkisë, në vitin 2018.

- **Leja e ndërtimit** për këtë objekt është marrë në datën 15.11.2019, ose 6 muaj pasi kanë filluar punimet.

*Për veprimin e mësipërm, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor.*

- **Zbatimi i punimeve:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, **sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 14.05.2019, duhet të përfundonin në datën 14.08.2019** dhe kanë përfunduar me datë 12.06.2020, pas amendamenteve të bëra për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve. **Nga 90 ditë sipas kontratës fillestare është realizuar për 390 ditë, ose për 300 ditë më shumë , konkretisht:**

- Në amendamentin me nr. extra prot, datë 07.08.2019, është rënë dakord ndërmjet AK dhe Kontraktorit, që të **shtyhet afati** i përfundimit të punimeve, i përcaktuar në nenin 5 të kontratës, deri në datën 07.01.2020, ose 140 ditë nga afati kontraktual i përfundimit të punimeve. Kjo shtyrje është bërë pas pretendimit të sipërmarrësit të punimeve për temperaturat e larta të ajrit, që bëhen pengesë për betonimet, si dhe pengesat që vijnë nga kontrata e furnizimit me ujë, që po kryhet në të njëjtin kohë dhe në të njëjtin kantier.

Nga verifikimi i ditarit të objektit dhe bazuar në afatin kontraktual të përfundimit të punimeve, sipas të cilit punimet duhet të përfundojnë në 06.08.2019, rezulton se deri në këtë datë është punuar 52 ditë pune. Diferenca e ditëve është cilësuar si “*ditë me temperatura shumë të larta dhe nuk lejohet betonimi në rrugë*” dhe “*Ndërprerje punimesh për të mundësuar punime të furnizimit me ujë*”. Gjithashtu, konstatohet se afati kohor 90 ditë pune, duke marrë në konsideratë ditët që nuk është punuar për shkaqet e mësipërme dhe “ditë shiu”, është realizuar në **datën 16.11.2019.**

**Nisur nga sa sipër, kërkesa dhe më pas miratimi nëpërmjet amendamentit, për 150 ditë shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve, kur afati kontraktual është vetëm 90 ditë dhe në këtë afat është punuar 52 ditë, janë të palogjikshme dhe jologjore. Nga ana e AK nuk duhej pranuar kjo kërkesë dhe duhej bërë argumentimi teknik për numrin e ditëve që duhej shtyrë afati.**

- Me argumentimin e mësipërm, nga ana e grupit të auditimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

gjykohen të papranueshme edhe amendamenti pa nr. prot, datë 07.01.2020, sipas të cilit miratohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 07.04.2020, ose **90 ditë të tjera**, me pretendimin se “...është bërë pezullimi i punimeve në periudhën nëntor – Dhjetor 2019, si pasojë e temperaturave të ulëta të ajrit...” (nga verifikimi i ditarit të punimeve në periudhën e pretenduar është punuar 28 ditë dhe nuk është punuar 22 ditë).

- Po kështu, dhe amendamenti pa nr. prot, datë 06.04.2020, sipas të cilit miratohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 16.06.2020, ose **70 ditë të tjera**, me pretendimin se “...është bërë pezullimi i punimeve në periudhën Mars 2020, si pasojë e pandemisë...” (nga verifikimi i ditarit të punimeve në periudhën e pretenduar (70 ditë) është pezulluar puna nga pandemia vetëm 40 ditë kalendarike).

Kontratat	Afati ditë	Data përfundimit	Shkaqet e shtyrjes	Ditë të punuara
Bazë	90	14.08.2019	-	52
Shtesa I	140	07.01.2020	Temp të larta të ajrit	28
Shtesa II	90	07.04.2020	Temp të ulta të ajrit	
Shtesa III	70	16.06.2020	Pandemia	
<b>Totali</b>	<b>390</b>		-	<b>90</b>

<b>Kriteri:</b>	Kontrata bazë, amendamentet, ditari i objektit dhe përmbajtja e tij.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Shtyrje e punimeve në mënyrë të pajustificuar, gjë e cila ka sjellë mosrealizimin e objektit në afat dhe mos ofrimin e përmirësimit të infrastrukturës rrugore për popullatën e këtyre zonave.
<b>Shkaku:</b>	Nuk ka shkaqe dhe arsyeshme, të dokumentuara dhe justifikuese për shtyrjen e punimeve, ose përlogaritje e gabuar e afatit të kryerjes dhe realizimit të punimeve, nga AK.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Titullari i Autoritetit Kontraktor, duhet të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e rasteve të tilla të shtyrjes së afateve kontraktuale të realizimit të punëve publike, në mënyrë të paragumtuar, të padokumentuar dhe të pambështetur në arsye teknike dhe ligjore.

**Konkluzion:** Autoriteti Kontraktor nuk duhet të kishte bërë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve më shumë data 16.11.2019, datë kur është përmbushur afati kontraktual i përfundimit të punimeve (90 ditë të punuara).

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, mbajnë me përgjegjësi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Përgjegjësi i Zyrës së Urbanistikës.

**Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

- Dokumentacioni teknik i zbatimit;
- Projekt preventivi;
- Situacioni përfundimtar;
- libri i masave, etj.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë**  
**me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë			
14. Lidhja e kontratës nr. 1046 prot datë 07.05.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 34,858,247 lekë OE fitues “J.” SHPK		
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 34,857,913 lekë -Vlera pa tvsh 29,048,261 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 403 ditë. Fillimi punimeve: 14.05.2019 Përfundimi punimeve : 12.06.2020	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti me nr extra prot, datë 07.08.2019, 150 ditë; Amendamenti me nr extra prot, datë 07.01.2020, 90 ditë; Amendamenti me nr extra prot, datë 06.04.2020, 70 ditë;	
20. Mbikëqyrësi i punimeve S.Sh.	Licenca Nr: MK 0894/1	Kontrata pa nr. prot, datë 07.05.2019	
21. Kolaudatori i punimeve Taqo Niçka	Licenca Nr: MK 0740/2	Kontrata pa nr. prot, datë 15.06.2020	
22. Akt Kolaudimi datë 22.06.2020	23. Akt i marrjes në dorëzim nuk është bërë		

**Titulli i Gjetjes 4:**

**Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, nga zbatuesi i punimeve OE fitues “J.” SHPK, për zërat e punimeve 2.4, 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 4.9, dhe 5.6.**

**Situata:**

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,951,600 lekë pa tvsh**. Konkretisht:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punimeve “FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë, çmimi”, “Shtresë asfaltobeton”, “Spërkatje me emulsion bituminoz 1 lt/m<sup>2</sup>”, “Shtresë stabilizanti t=10 cm”, “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm”, “Pllaka guri 40 x 40 cm ranor dhe gëlqeror për rrugë t=6-10 cm, çmimi” dhe “Shtresë rëre nën dhe mbi tubacione”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Kriteri:**

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1046 prot datë 07.05.2019.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, datë 07.05.2019.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr. prot, datë 15.06.2020.

<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Këlcyrë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,951,600 lekë pa TVSH nga OE fitues “J.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1046, datë 07.05.2019 me “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, <i>Bashkia Këlcyrë</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Konkluzion:** Vlera prej **1,951,600 lekë**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z. S.Sh. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. T.N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
3. Z. K.N. me detyrë Kryetar i Bashkisë Këlcyrë;
4. Z. J.N. me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.5 të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 10 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/13, datë 18.09.2020, si dhe është trajtuar në PRA faqe 56-113. Mbi këtë pjesë të PRA nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.**

### **3. “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë**

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1447, datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë, të përfaqësuar nga Titullari z. K.N. dhe Operatorit Ekonomik “H.” SHPK, me përfaqësues z. AH, me licencë profesionale NZ 1246/9. Vlera e kontratës është 27,384,647 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 130 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

- **Për mbikëqyrjen e punimeve** të ndërtimit, sipas aktit pa nr. prot, datë 01.07.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me ing. Kostandin Isufi, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0545/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.

- **Për kolaudimin e punimeve** të ndërtimit, me kontratën pa nr prot, datë 11.11.2019 është emëruar nga AK, L.Th., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0255/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 0 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- **Projekt preventivi:** Projekt preventivi i objektit është hartuar nga “S.R.” SHPK, në vitin 2015. Në dosje nuk administrohet leja e ndërtimit për këtë objekt.

- **Zbatimi i punimeve:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 02.07.2019 dhe kanë përfunduar me datë 11.11.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Është mbajtur procesverbal ndërmjet sipërmarrësit, mbikëqyrësit të punimeve dhe titullarit të institucionit për punimet që shtohen dhe hiqen (7,717,508 lekë, ose 31% e të gjithë objektit) në datën 10.06.2017. Ndryshimet e miratuara tregojnë se projekti i hedhur në tender le dyshime që është i pa azhurnuar, apo jocilësor.

#### Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit;
- Projekt preventivi;
- Situacioni përfundimtar;
- libri i masave, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë			
14. Lidhja e kontratës nr. 1447 prot datë 01.07.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 27,384,647 lekë OE fitues “H.” SHPK		
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 27,383,851 lekë -Vlera pa tvsh 22,819,876 lekë	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 130 ditë, Zbatuar 130 ditë. Fillimi punimeve: 02.07.2019 Përfundimi punimeve : 11.11.2019		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve K.I.	Licenca Nr: MK 0545/2	Kontrata pa nr. prot, datë 01.07.2019	
21. Kolaudatori i punimeve L.Th.	Licenca Nr: MK 2928/3,	Kontrata pa nr prot, datë 11.11.2019	
22. Akt Kolaudimi datë 13.11.2019	23. Akt i marrjes në dorëzim datë 19.11.2019		

**Titulli i Gjetjes 5:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë, nga zbatuesi i punimeve OE “H” SHPK, për zërat e punimeve A,3, A.5 dhe B.3.

**Situata:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,280,596 lekë pa tvsh**. Konkretisht:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmim kanali tokë e zakonshme”, “Beton C16/20 veshje kanal betoni” dhe “Gërmim kanali tokë e zakonshme”, për pasojë vlera e kësaj difference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: <ul style="list-style-type: none"><li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li><li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.</li><li>- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1447 prot datë 01.07.2019.</li><li>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr. prot, datë 01.07.2019.</li><li>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit pa nr prot, datë 11.11.2019.</li></ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Këlcyrë.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>	Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,280,596 lekë pa TVSH nga OE “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1447, datë 01.07.2019 me “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**Konkluzion:** Vlera prej **1,280,596 lekë**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Z. K.I. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. L.Th. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4.5 të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 11 datë 18.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/12, datë 18.09.2020, si dhe trajtuar në PRA faqe 56-113. Mbi këtë pjesë të PRA nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.**

#### **5. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.**

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe Manualin e Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve, si dhe Regjistrin Institucional të Zbatimit të rekomandimeve”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 67, datë 23.06.2020.

#### **Dokumentacioni i kërkuar dhe vënë në dispozicion nga subjekti:**

- Shkresa përcjellëse e KLSH-së nr. 248/10, datë 29.06.2018 “Dërgim Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet, për auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë”;
- Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm të KLSH-së;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Akt verifikimi nr. 7, datë 28.02.2019 i mbajtur nga Grupi i Auditimit të KLSH, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1337, datë 03.12.2018, Autorizimit mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve nr. 1337/7, datë 04.12.2018 dhe protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 519, datë 28.02.2019. i KLSH mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve;
- Shkresa e Bashkisë Këlcyrë nr. 581, datë 11.03.2019 “Dërgohet Akt verifikimi nr.7”;
- Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë nr. 75, datë 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e programit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së”;

**Nga Grupi i Auditimit u audituan nën çështjet e mëposhtme:**

#### **5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.**

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

##### **Titulli i Gjetjes 1: Mbi hartimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH**

###### **Situata 1:**

-Nga auditimi rezultoi se, Kryetari i Bashkisë Këlcyrë ka nxjerrë Urdhrin nr. 75, datë 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e programit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së” të përbërë nga:

R.A., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Këlcyrë

V.K., me detyrë Shefe e Degës së Financës

RH, me Detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksa;

BI, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës.

**në tejkallim të afateve të përcaktuara** në ligjin nr.154/2014.

Shkresa përcjellëse e KLSH për dërgim Raporti Përfundimtar Auditimi dhe Rekomandime me nr. 248/10, datë 29.06.2018, është protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 1364, datë 04.07.2018, ç’ ka do të thotë se afati i fundit për dërgimin e përgjigjes mbi programin/planin e masave për zbatimin e rekomandimeve është 25.07.2018. Ky urdhër ka dalë 36 ditë më vonë.

###### **Situata 2:**

-Gjithashtu, **Grupi i punës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për hartimin e programit** për masat që duhet të merren për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë edhe pse me vonesë.

Sa më sipër, nga Bashkia Këlcyrë nuk është dërguar në KLSH, programi (plan veprimi) mbi masat që duhet të ndërmerren nga subjekti, mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

###### **Kriteri 1:**

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në lidhje me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, germa (j), ku cilësohet: *“të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*ditëve nga data e marrjes së kërkesës”;*

<b>Kriteri 2:</b>	- Urdhri e Kryetarit të Bashkisë nr. 75, datë 31.08.2020, pika 3 ku cilësohet: “Grupi i punës do të hartojë programin dhe të marri masat për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe njoftimin me shkrim drejtuar KLSH-së, sipas afateve të përcaktuara”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Moszbatimi i afateve dhe mos hartimi i planit të masave, ka sjellë nivele të ulëta të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.
<b>Shkaku:</b>	Mosveprim i Titullarit të Bashkisë Këlcyre si dhe i Grupit të punës të ngarkuar për hartimin e plan veprimit, ku duhet të përcaktoheshin personat përgjegjës si dhe afatet për shqyrtimin dhe realizimin e rekomandimeve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Do të ri kërkohej zbatimi i rekomandimeve, si dhe dërgimi i informacionit në KLSH brenda afateve ligjore.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

- Titullari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N., për nxjerrjen në tejkallim të afateve të Urdhrit për ngritjen e komisionit, si dhe për mos ndjekjen e veprimtarisë së komisionit në zbatim të këtij urdhri dhe mos dërgim të informacionit në KLSH;
- Grupi i punës për moszbatimin e Urdhrit të Kryetarit nr. 75, datë 31.08.2018, i përbërë nga:
  - R.A.
  - V.K.
  - RH
  - BI.

#### **5.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.**

<b>Titulli i Gjetjes 2:</b>	<b>Mbi zbatimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH (6-Muaj)</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezultoi se, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 248/10, datë 29.06.2018, ka dërguar Bashkisë Këlcyrë, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Shkresën përcjellëse me rekomandimet e lëna. Sipas ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Këlcyrë duhet të raportojë me shkrim mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve <b>brenda 6-muajsh</b> nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Nga auditimi ka rezultuar se nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk është zbatuar ky detyrim ligjor, pasi nuk ka raportuar me shkrim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
<b>Kriteri:</b>	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”, ku cilësohet: <ol style="list-style-type: none"><li>1. Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.</li><li>2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të</li></ol>





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.*

<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve.
<b>Shkaku:</b>	Mos hartimi i planit të masave, ku të përcaktoheshin rekomandimet e KLSH-së, strukturat përgjegjëse, personat përgjegjës për ndjekejen e tyre dhe afatet përkatëse, ka sjellë edhe mungesën e raportimit mbi nivelin e zbatimit të tyre.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Do të ri kërkohet zbatimi i rekomandimeve, si dhe dërgimi i informacionit në KLSH brenda afateve ligjore.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Titullari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N., i cili nuk ka realizuar detyrimin ligjor në lidhje me raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve në KLSH.

#### **5.3. Mbi raportimin periodik në Këshillin Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.**

<b>Titulli i Gjetjes 3:</b>	<b>Mbi raportimet e subjektit Bashkia Këlcyrë në KB</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Këlcyrë, nuk ka raportime në Këshillin Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditi i jashtëm (KLSH), referuar ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
<b>Kriteri:</b>	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, ku cilësohet: “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve
<b>Shkaku:</b>	Mosveprim nga ana e Titullarit të Bashkisë Këlcyrë.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandime:</b>	Titullari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH, por dhe nga struktura të tjera si APP, të auditimit të mëparshëm dhe të auditimeve të mëpasshme.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Titullari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N., i cili nuk ka realizuar detyrimin ligjor në lidhje me raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve në Këshillin Bashkiak.

**Konkluzion mbi pikën 5.1, 5.2 dhe 5.3:** Bashkia Këlcyrë, përsa i përket hartimit të plan veprimt për masat e marra, afatet dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe dërgimin e tij brenda afatit 20 ditor; hartimin e informacionit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe dërgimin në KLSH brenda afatit 6 mujor, si dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të tyre në Këshillin Bashkiak, nuk ka marrë asnjë masë për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara ligjin 154/2014 dhe ligjin nr. 68/2017.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Për sa është trajtuar më lart (pika 5.1; 5.2; 5.3, të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 1 datë 04.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/1, datë 04.09.2020, si dhe trajtua në PRA faqe 113-137. Mbi këtë pjesë të PRA nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.

#### 5.4. Mbi statusin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, evaduar me shkresën nr. 248/10, datë 29.06.2018, është kryer edhe auditimi tematik sipas Programit të Auditimit nr. 1337, datë 03.12.2018, për të cilin është mbajtur Akt verifikimi datë 28.02.2019, protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 519, datë 28.02.2019. Rezultatet përsa i përket statusit të zbatimit të rekomandimeve deri 30.06.2020, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5.1 “Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i rekomandimeve	Rekomandime të dhëna	Pranuar				Pa pranuar
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar	
Masa organizative	14	4	4	1	5	0
Masa shpërblim dëmi	11				11	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	2			2		0
Masa Administrative APP 9 Masa gjobë 2 Masa disiplinore	11		2		9	0
Masa disiplinore	6	3	3			0

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë

Punoi: KLSH

**Nga auditimi i statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm deri më 30.06.2020, duke marrë në konsideratë dhe rezultatet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nga KLSH sipas Programit të Auditimit nr. 1337, datë 03.12.2018, niveli i zbatimit të tyre paraqitet :**

**Titulli i Gjetjes 4: Mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve**

**Situata 1: A/1 & A/2 “Masa organizative”:**

Nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar 11 “Masa organizative”, si rezultat i auditimit të kryer, si dhe 3 Masa organizative, si ri kërkim i zbatimit të rekomandimeve të lënë nga auditimi i mëparshëm.

Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë, nga 14 masa organizative ka pranuar plotësisht masat e rekomanduara, pasi nuk është dërguar në KLSH, asnjë informacion për kundërshtim të tyre, si dhe nuk është paraqitur asnjë argument ligjor, shkresor apo verbal për mospranim të tyre edhe gjatë procesit auditues në terren.

Nga auditimi ka rezultuar se janë zbatuar plotësisht 4 masa; janë zbatuar pjesërisht 4 masa; është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 5 masa.

**Situata 2: B/1 “Masa për shpërblim dëmi”:**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) “Të drejtat e KLSH” dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **38,657,994 lekë**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 38,657,994 lekë, si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë, nga 11 masa shpërblim të dëmit ekonomik në vlerën 38,657,994 lekë, të pranuar dhe për të cilat kanë dalë njoftimet nga Titullari, nuk janë kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar asnjë vlerë. Nga auditimi ka rezultuar se nuk ka asnjë argumentim ligjor, për mos arkëtimin e dëmit si dhe nga subjektet dhe punonjësit e atakuar nuk është kryer ankimim në Gjykatën Administrative, për kundërshtim të shpërblimit prej tyre, të dëmit ekonomik të ngarkuar.

Tabela nr. 5.2 “Përmbledhëse mbi zbatimin e masës shpërblim dëmi ekonomik”

Nr.	Emërtimi	Dëmi në vlerë/lekë
1	Rekomanduar për shpërblim dëmi ekonomik	38,657,994
2	Pranuar për shpërblim vlera	38,657,994
3	Nxjerrë njoftimet nga titullari për vlerën	38,657,994
4	Kontabilizuar vlera	0
5	Arkëtuar vlera	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Këlcyrë/KLSH

Punoi: KLSH

### Situata 3:

Për shkeljet e konstatuara në auditimin e mëparshëm, janë dhënë masa disiplinore dhe administrative për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të ngarkuara me ligj.

Nga auditimi ka rezultuar se nga 8 masa disiplinore të rekomanduara nga KLSH deri më 30.06.2020, janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa disiplinore, nga 9 masa administrative për 9 punonjës të dërguar APP, ka dalë vendimi i APP-së ku është vendosur gjobë për 9 punonjës, por nuk është zbatuar për asnjë prej tyre nga ana e Bashkisë Këlcyrë, pasi nuk janë kontabilizuar dhe arkëtuar gjobat e vendosura nga APP. Nga ana e subjektit janë pranuar gjobat e vendosura nga APP, pasi kanë dalë Njoftimet, si dhe nga ana e personave të atakuar përsa i përket gjobave të vendosura nga APP nuk ka ankimime në Gjykatën Administrative, për rrjedhojë nuk ka asnjë argument ligjor për mos kontabilizim dhe mos arkëtim të tyre në **vlerën totale 1,400,000 lekë**.

### Kriteri:

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”, ku cilësohet:

1. Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, ku cilësohet: “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

- Ndikimi/Efekti:** Mos shqyrtimi dhe moszbatimi i masave të rekomanduara në KLSH, sjell pasoja për subjektet. Moszbatimi i tyre çon në përsëritjen e të njëjtave shkelje dhe mos përmirësim të situatës.
- Shkaku:** Neglizhencë e Titullarit të Institucionit, si dhe mosfunksionim i Grupit të Punës të ngarkuar për ndjekjen e rekomandimeve të KLSH-së.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandime:** Do të ri kërkohet zbatimi i të gjitha rekomandime të cilat nuk janë zbatuar, si dhe për të cilat nga subjekti i audituar nuk janë sjellë argumente mbi mos zbatueshmërinë e tyre.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N., në cilësinë e titullarit të institucionit dhe të NA, si dhe znj. V.K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe në cilësinë e NZ.

**Konkluzion mbi pikën 5.4.** Bashkia Këlcyrë, përsa i zbatimit të rekomandimeve paraqitet në nivele të ulëta, sidomos për masat me efekte financiare “Masa shpërblim dëmi”, ku nga e gjithë shuma e rekomanduar për shpërblim rezulton se, nuk është kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar asnjë vlerë, pavarësisht se kanë dalë njoftimet nga Titullari i Institucionit.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 5.4 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 1 datë 04.09.2020, protokolluar në subjekt me nr. 2003/1, datë 04.09.2020, si dhe është trajtuar në PRA faqe 113-137. Mbi këtë pjesë të PRA nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.**

(Në mënyrë analitike të gjitha masat e rekomanduara nga auditimi i mëparshëm dhe statusi aktual i tyre, janë pjesë e aneksit nr. 5.4 “Mbi statusin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”).

#### **6. Të tjera (Shyrtim ankese)**

Shtetasi, z. H.Sh., banor i Bashkisë Këlcyre, ka paraqitur ankimim në KLSH, protokolluar me nr. 847, datë 09.09.2020. Ankimuesi pretendon se, nga ana e Bashkisë Këlcyrë, nuk është ekzekutuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet nr. 220, datë 11.07.2011, për trajtim të bashkëshortes së tij, të ndjerës znj. A.Sh. me tokë bujqësore, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën.

Nga auditimi i kësaj çështjeje (e cila ishte lënë rekomandim edhe në auditimin e mëparshëm), nga ana e Bashkisë Këlcyrë, na u vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni, në lidhje me vendimin gjyqësor, shqyrtimin e tij, korrespondencën e Bashkisë jo vetëm me shtetasin H.Sh., por dhe me institucione të tjera, si Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, Prefektin e Qarkut Gjirokastrë, Zyrën e Bashkëqeverisjes në Kryeministri etj. Për periudhën 2010-2012, Bashkia Këlcyrë, lidhur me çështjen e ndarjes së tokave bujqësore, ka pasur 5 çështje gjyqësore me qytetarët, në të cilat ka qenë palë e paditur. Të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

gjitha çështjet gjyqësore kanë pasur të njëjtin objekt, detyrimin e Bashkisë të trajtojë me tokë bujqësore qytetarët, sipas ligjit 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

Vendimi nr. 220, datë 11.07.2011, për trajtimin me tokë bujqësore të qytetares A.Sh., nuk është zbatuar, pasi në dispozitivin e vendimit të gjykatës është cilësuar: “...që trajtimi i saj, për pajisje me akt të marrjes në pronësi të tokës të bëhet në përputhje me certifikatën familjare më datë 01.08.1991”. Sipas certifikatës familjare znj. A.Sh. rezulton të jetë banore në Këlcyrë, Përmet. Për rrjedhojë, ky rast nuk mund të trajtohet sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” me ndryshime. Nga ana e Bashkisë Këlcyrë i është kthyer përgjigje Z. H.Sh. me shkresat nr.1432, datë 03.07.2019, nr. 1236, datë 18.06.2018, nr. 801, datë 20.06.2017, përgjigje Këshillit të Qarkut me shkresën nr. 337, datë 17.02.2020, Zyrës së Bashkëqeverisjes në Kryeministri me shkresën nr. 290, datë 07.02.2018, etj.

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### A. PËRMIRËSIME LIGJORE

**Situata 1.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik ka rezultuar se, “Manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të cilat bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 28 “Metodat e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2, shërbejnë si bazë për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, **nuk kanë reflektuar në analizën teknike të zërave të punimeve në ndërtim, ndryshimet në pagën bazë orare minimale (zë i kostos) në shkallë vendi, e cila në vitin 2018, sipas VKM nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", rezulton të jetë jo më pak se 149**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**lekë/orë.** Kjo ka sjellë që paga bazë orare minimale e aplikuar në hartimin e preventivave nga Autoriteti Kontraktor, të jetë 125 lekë/ora, bazuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” si dhe në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar pika 3.1, cilësohet: *Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" (pika 9). Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv.*

**Situata 2:** Autoritetet Kontraktore, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës ju referohen çmimeve përmbledhëse të përcaktuara në manual dhe analizave teknike të manualeve përkatëse, ndërsa në vlerësimin e ofertave të Operatorëve Ekonomikë (OE) pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, rezulton se s’kualifikohen për faktin, që në Analizat e zërave të punimeve, marrin si referencë pagën orare bazë minimale referuar manualeve përkatëse të vitit 2015, me argumentin se paga minimale bazë orare përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe për vitin 2018 rezulton të jetë jo më pak se 149 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1. Rekomandim:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duhet të marrë masa për përditësimin e Manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, duke marrë për bazë si zë të kostos, për shpenzime punëtorie, pagën bazë minimale orare në fuqi, të miratuar me VKM-të përkatëse dhe të detyrueshme për zbatim, sa herë që kjo pagë pëson ndryshime.

**1.2. Rekomandim:** Agjencia e Prokurimit Publik (APP), deri në përditësimin e manualeve, duhet të nxjerrë udhëzime dhe të orientojë autoritetet kontraktore, për mënyrën se si duhet të veprojnë në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës për punimet në ndërtim. APP, duhet të orientojë në lidhje me referencën e pagës bazë orare minimale, duhet të përcaktojë, pagën orare, së cilës, duhet t’i referohen OE, në paraqitjen e analizës së çmimeve për çdo zë punimesh, a) pagës bazë orare minimale të miratuar në shkallë vendi, apo b) pagës bazë orare të cilës i referohet VKM nr. 629, datë 15.07.2015 dhe së cilës i referohen autoritetet kontraktore, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

**Menjëherë**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, si dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre në fund të viteve ushtrimore 2018 dhe 2019.

Sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2018, ka rezultuar që llogaria 212 “Ndërtime dhe rikonstruksione” është rritur për shumën 6,675,337 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

vepra ujore” është rritur për shumën 150,447,389 lekë, ndërsa sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2019, llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është rritur për shumën 66,600,470 lekë. Sipas dokumentacionit të verifikuar, këto vlera përfaqësojnë shpenzime kapitale, të papërfunduara, të pakolauduara dhe të pamarrë në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë, ç’ ka do të thotë, se janë investime në proces dhe jo investime të kapitalizuara. Për rrjedhojë regjistrimi i tyre në kontabilitet, në debi të llogarive 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe jo në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.2. Rekomandimi:** Nga ana e Përgjegjëses së Zyrës së Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë, të bëhen sistemimet kontabël si më poshtë:

- Sistemim në kontabilitet i llogarisë 212 “Ndërtime e Konstruksione” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **6,675,377 lekë**, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit pasardhës, duke bërë veprimin kontabël në debi të llogarisë 231 dhe kredi të llogarisë 212;

-Sistemim në kontabilitet i llogarisë 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” për shumën **150,477,389 lekë** në vitin 2018 dhe **66,600,470 lekë** për vitin 2019, në debi të llogarisë 231 dhe në kredi të llogarisë 213.

#### **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i analitikëve të llogarisë 202 “Studime e kërkime” konstatohet se, gjendja në fund të vitit 2018 dhe vitit 2019, për nëntë studime e projekte, të trashëguara nga Njësia Ballaban, paraqitet në vlerën zero lekë, (sipas Tabelave anekse nr. 3.2 dhe 3.3 “Studime dhe projekte të pa kontabilizuara”, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). Kjo situatë ka sjellë që AAGJMM, të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (llogaria 230 “Studime dhe kërkime”) të mos paraqesin “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Këlcyrë, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi. Duke qenë se këto aktive të trashëguara janë paraqitur me vlerë zero, nuk janë bërë hyrje në magazinë.

Gjithashtu, është evidentuar se disa AAGJM, si “Ndërtesa e konstruksione”, (sipas Tabelave anekse nr. 3.4 dhe 3.5, trajtuar faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit) në fund të vitit 2019, janë paraqitur me vlera të ulëta (nën 100,000 lekë), vlera këto, jo reale në krahasim me vlerat e tregut për aktivet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2019, pika 105.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

#### **2.1. Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Bashkisë, Nëpunësit Autorizues si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për vlerësimin e aktiveve jo materiale, bërjen hyrje në magazinë të tyre, si dhe rivlerësimin e aktiveve materiale, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi.

#### **Gjashtë muaj**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, për vitet 2018 dhe 2019, nuk janë përfshirë në inventarizim llogaritë: 210 “Toka, troje, terrene”; 211 “Pyje Plantacione”; 212



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

“Ndërtesa e Konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”; 215 “Mjete transporti” dhe aktivet afatshkurtra, si dhe për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, me të dhënat mbi, datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu, është evidentuar se për vitin 2018, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve, si dhe nuk disponohet asnjë dokumentacion, Urdhër i Kryetarit, për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2018.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

#### **3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Këlcyrë, konkretisht:

- Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrimit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
- Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”.

#### **Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë, sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), më datë 02.11.2016 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime SHA, Këlcyrë, e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij...”. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 21,259,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 21,259,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Këlcyrë, në Ujësjetllës Kanalizime SHA, Këlcyrë, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar të viteve 2018 dhe 2019, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Mos pasqyrimi i vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 21,259,000 lekë, në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, përbën deformim të informacionit financiar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të Ujësjetllës Kanalizime SHA, Këlcyrë, me vlerë kontabël **21,259,000 lekë**, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

#### **Me mbylljen e Pasqyrave**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se, në fund të viteve ushtrimore 2018 dhe 2019, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është në vlerën 6,078,720 lekë, e cila analitikisht përfaqëson debitorë për penalitete dhe kamatëvonesa, vlerë e cila nuk është e saktë. Në asnjë rast, nuk janë evidentuar në llogaritë analitike si për vitin 2018 dhe 2019, debitorët për taksat dhe tarifatat vendore. Sipas rakordimit me zyrën e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Këlcyrë, detyrimet e evidentuara për vitet 2018 dhe 2019, janë dërguar me shkresat përcjellëse me nr. 259, datë 01.02.2019 për vitin 2018 dhe nr. 331, datë 14.02.2020, për vitin 2019, Zyrës së Financës dhe sipas tyre, detyrimi paraqitet në vlerën 53,051,426 lekë në vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019. Për rrjedhojë nuk është pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe në kundër partinë llogaritë e klasës 7, vlera prej 53,051,426 lekë për vitin 2018, dhe vlera prej 60,386,981 lekë për vitin 2019, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke e debituar për vlerën 53,051,426 lekë për vitin 2018 dhe 60,386,981 lekë për vitin 2019. Gjithashtu, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit” të vitit në vazhdim.

#### Me mbylljen e Pasqyrave Financiare

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 6,714,053 lekë për vitin 2018 dhe 7,622,212 lekë për vitin 2019. Në mënyrë analitike kjo llogari ka përfshirë në debi, gjendjet e llogarive kreditore të detyrimeve 42 “Detyrime ndaj personelit”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” dhe 435 “Sigurime Shoqërore” për secilin vit përkatës. Nga ana tjetër janë analizuar dhe kontratat e investimeve si dhe financimi i këtyre angazhimeve sipas PBA-së 2017-2018-2019, trajtuar në Tabelën anekse nr. 3.6 “Mbi financimin e pritshëm nga buxheti”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për sa i përket të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyrë, për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit, në lidhje me këto angazhime të ndërmarra, gjatë vitit 2017, 2018 dhe 2019, konstatohet se bazuar në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32 e tij, ky kontabilizim nuk është bërë, gjë që ka sjellë mos pasqyrimin e detyrimeve të buxhetit kundrejt Bashkisë Këlcyrë, për shumën 69,955,690 lekë në vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë në vitin 2019, në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” për shumën 69,955,690 lekë për vitin 2018 dhe për shumën 237,523,073 lekë për vitin 2019. Veprimet sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.

#### Me mbylljen e Pasqyrave Financiare



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, pas analizimit të të gjitha kontratave të lidhura për investime kapitale, sipas Tabelës anekse nr. 3.7 “Detyrimet e prapambetura” faqe nr. 58 e Raportit Përfundimtar të Auditimit, paraqitja e detyrimeve të prapambetura në kontabilitet, nuk është vlerën e saktë.

Në Bilancin Kontabël për vitin 2018 dhe 2019 gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në vlerën 0 lekë dhe kundër partia 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2018 në vlerën 386,712 dhe për vitin 2019 në vlerën 630,628 lekë, ç’ ka do të thotë se, detyrimi i prapambetur lindur nga shpenzimet kapitale në vitet 2018 dhe 2019, nuk është pasqyruar. Kjo ka sjellë, mos pasqyrimin e saktë të gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 6,052,070 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2018 dhe 4,335,775 lekë, për vitin financiar të mbyllur 2019.

Këto llogari, gjithashtu nuk paraqesin drejtë gjendjen e tyre për vitin 2019, për shkak edhe të mos njohjes së detyrimit që ka lindur në vitin 2019 (referuar datës së faturës), por që janë likuiduar (lëvizja cash) në vitin 2020, për vlerën 20,109,193 lekë.

Në rastet e mësipërme, është shkelur një nga parimet kryesore të kontabilitetit “të drejtat dhe detyrimet e konstatuara”, pra evidentimi i shpenzimeve në kontabilitet në momentin kur ndodh ngjarja.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

#### **7.1. Rekomandimi:**

- Nga Bashkia Këlcyrë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën **6,052,070 lekë**, diferencë e vitit financiar të mbyllur 2018 dhe **4,335,775 lekë** diferencë e vitit financiar të mbyllur 2019, si dhe të sistemohet në kontabilitet vlera prej **20,109,193 lekë** e faturave të cilat janë likuiduar në vitin 2020, por që detyrimi ka lindur në vitin 2019, në llogaritë përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm”.
- Nga ana e Bashkisë Këlcyre, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportim i cili aktualisht nuk është real.

#### **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e kryerjes së shpenzimeve, me objekt investimet kapitale të vitit 2018 dhe 2019 rezultoi se, në përgjithësi faturat tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, kanë datë lëshimi të mëvonshme nga data e situacionit përkatës. Paraqitja e faturave tatimore, në data të mëvonshme nga datat e situacioneve të punimeve, është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, gjë për të cilën parashikohet penalitet për investitorët, për mospagim në afat të TVSH-së, i cili arrin vlerën e 455,084 lekë, sipas Tabelës anekse nr. 3.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Kjo shumë konsiderohet një e ardhur (jo tatimore) e munguar në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi i transaksioneve lidhur me shpenzimet e investimeve, për periudhën objekt auditimi, janë evidentuar raste, ku dokumentacioni i paraqitur për justifikimin e shpenzimeve, ka rezultuar i paplotë, konkretisht janë paraqitur nga investitorët situacione pa data. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar neni 7, 12, dhe 18 si dhe UKM nr. 1



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, pranimi i dokumentacionit vërtetues të parregullt dhe të pa plotë, është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4, pika 26, me neni 6 të UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 35 dhe 36, është përgjegjësi e nëpunësit zbatues.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 39-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1. Rekomandimi:** Nga Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Këlcyrë, të merren masa që likuidimi i shpenzimeve të kryhet bazuar në dokumentacion të plotë, autorizues dhe vërtetues të shpenzimit kapital. Nga Nëpunësi Autorizues të dërgohet shkresë në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, ku të vihet në dijeni për gjendjen e debitore të subjekteve “ROSI” SHPK me NIUS J69102223E dhe “B.S.” SHPK, me NIUS K71412003A, shkaktuar si rezultat i mospagimit në afat të TVSH-së, në vlerën **455,084 lekë**.

#### Menjëherë dhe vijimësi

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin e Programeve Buxhetore Afatmesme (PBA) ka rezultuar se Bashkia Këlcyrë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37; UMF nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, shtojca 5; UMF nr. 22, datë 30.07.2017 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, shtojca 1; UMF nr. 6/3, datë 10.07.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” dhe UMF nr. 7, datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, kapitulli 1.

*Mbi programimin e PBA-së 2018-2020; 2019-2021 dhe 2020-2022 është konstatuar se:*

- Nga ana e Titullarit të Institucionit, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS);
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda muajit dhjetor të viteve paraardhëse;
- Nga Kryetari i Bashkisë nuk është paraqitur për shqyrtim dhe miratim raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda datës 15 Mars (të vitit paraardhës);
- Nuk janë miratuar nga Këshilli Bashkiak, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Nuk janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe nuk është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile;
- Nuk është dërguar brenda datës 1 Qershor 2017 në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dokumenti i programit buxhetor afatmesëm (PBA 2018-2020);
- Nuk janë miratuar në Këshillin Bashkiak, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (të vitit paraardhës);
- Nga Njësitë shpenzuese të Bashkisë, nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore të rishikuara, si dhe nga Njësia Përgjegjëse për buxhetin në Bashkinë Këlcyrë, nuk janë kryer analizat e kërkesave buxhetore;
- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak programi buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor brenda datës 25 dhjetor (të vitit paraardhës).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS-së, si dhe Nëpunësi Zbatues, për zbatimin e të gjitha procedurave ligjore, për programimin e buxheteve vjetore dhe afatmesme, duke



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

krijuar grupet e punës sipas projekteve të financimit, duke ndjekur dhe zbatuar kalendarin e programimit të buxhetit, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

#### Menjëherë dhe vijimësi

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se treguesit buxhetor të planifikuar dhe miratuar për periudhën objekt auditimi, paraqiten në nivele të ulëta realizimi. Kështu, është evidentuar nivel i ulët i realizimit të planit të të ardhurave, ku për vitin 2018, paraqiten me realizim në masën 67 % kundrejt planit dhe për vitin 2019, paraqiten me realizim në masën 51 % kundrejt planit.

Viti	Të ardhura të veta-000/lekë				Shpenzimet buxhetore-000/lekë			
	Plan	Fakt	Diferenca	%	Plan	Fakt	Diferenca	%
2018	19,386	13,115	-6,271	67	394,861	363,438	-31,423	92
2019	20,047	10,290	-9,757	51	378,868	356,362	-22,506	94

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta, gjë e cila ka ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë, duke shtuar riskun për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, në cilësinë e Titullarit dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa, që gjatë procesit të planifikimit të PBA-ve dhe buxheteve vjetore, të mbështeten në analiza të hollësishme mbi kapacitetet ekonomike, financiare dhe resurset e territorit nën administrim, për një planifikim sa më objektiv dhe real të të ardhurave, me qëllim mos krijimin e diferencave të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, gjë e cila shoqërohet me marrje angazhimesh për kryerje shpenzimesh, si dhe mos likuidim të tyre për shkak të mungesës së likuiditetit.

#### Në vijimësi

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Këlcyrë ka trashëguar dhe ka krijuar detyrime të prapambetura për periudhën objekt auditimi, të cilat nuk kanë gjetur pasqyrim real në planifikimin e buxheteve vjetore, në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe udhëzimet standarde për zbatimin e buxheteve të njësive të qeverisjes së përgjithshme, konkretisht:

- Në vitin 2017, është prokuruar objekti: “Rijetëzim i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër” me vlerë 148,783,112 lekë me TVSH, me burim financimi nga FZHR, ku likuidimi i këtij investimi në 31.12.2017 paraqitet në vlerën 37,227,210 lekë dhe likuidimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën prej 107,222,064 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin 2018 dhe 2019 është në vlerën prej 4,333,838 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.
- Në vitin 2018, është prokuruar objekti: “Rikonstruksion i urës në qendër të qytetit Këlcyrë” me vlerën 4,943,420 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e veta, ku likuidimi i këtij investimi në 31.12.2018 paraqitet në vlerën 3,240,550 lekë. Detyrimi i mbetur për vitin ushtrimor 2018 është në vlerën prej 1,702,870 lekë, detyrim i cili nuk është planifikuar në PBA 2018-2020 si dhe në Planin e buxhetit të vitit 2019.
- Në vitin 2018 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë, me nr. ekzekutimi 64 datë 14.11.2018, me vlerë 150,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2019 dhe PBA 2019-2021.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Në vitin 2019 rezulton se, vendimi gjyqësor i lindur si detyrim në Bashkinë Këlcyrë me nr. ekzekutimi 1249 datë 28.10.2019, me vlerë 429,000 lekë, nuk është njohur si detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019, si dhe nuk paraqitet si detyrim në Planin e Buxhetit të vitit 2020 dhe PBA 2020-2022.
- Gjithashtu, është konstatuar se në vitin 2019, është prokuruar objekti “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit” me vlerë 34,858,247 lekë me TVSH dhe objekti “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran” me vlerë 36,353,317 lekë me TVSH, me burim financimi nga të ardhurat e Bashkisë, pa miratuar si objekt në Këshillin e Bashkisë.  
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

#### **11.1. Rekomandimi:**

- Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të buxheteve vjetore, të planifikojë mbulimin me buxhet, së pari për detyrimet e papaguara dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.
- Gjatë zbatimit të buxheteve vjetore, për investimet që financohen nga të ardhurat e veta të merret paraprakisht miratimi në Këshillin Bashkiak, të zbatohen të gjitha procedurat ligjore bazuar në udhëzimet vjetore dhe standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxheteve vjetore.

**Në vijimësi**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi subjektet, që ushtrojnë aktivitet në shtrirjen territoriale administrative të Bashkisë Këlcyrë të regjistruara në QKB (referuar të dhënave të Tabelës nr. 2.3.2 “Gjendja e subjekteve të regjistruara”, faqe 30 e RPA), konstatohen se për vitet objekt auditimi, ka 5 regjistrime të reja dhe 45 subjekte mbyllje aktiviteti, nga të cilat: Për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 201 subjekte (184 subjekte të biznesit të vogël, 17 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione), për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 163 subjekte (142 subjekte të biznesit të vogël, 21 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera e institucione).

Kjo situatë faktorizohet jo vetëm nga niveli i ulët ekonomik i Bashkisë Këlcyrë, por dhe nga puna e pa mjaftueshme e strukturave të Sektorit të Tatim Taksave, pasi:

- Nuk janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj, për të rritur sigurinë e informacionit që disponojnë, nisur nga fakti se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon program kompjuterik të licencuar dhe të mbrojtur.
- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe kontrollit fizik të dokumentacionit rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, nuk është administruar në dosjet e bizneseve që janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, deklarata tatimore vjetore mbi xhiron e parashikuar vjetore.
- Nga informacioni i marrë nëpërmjet intervistimit dhe auditimi fizik i dokumentacionit, rezulton se nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, mbi xhiron e subjekteve, ku mbi bazën e këtyre të dhënave aplikohen dhe taksat vendore sipas llojeve të biznesit (fizik/juridik).
- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se, 36 subjekte të biznesit të vogël, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Bashkinë Këlcyrë dhe Njësitë Administrative, Sukë, Ballaban, Dishnice, nuk janë regjistruar në QKB, kjo ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për detyrimin e këtyre subjekteve që të regjistrohen në QKB, por është mjaftuar vetëm me evidentimin e tyre.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 41 dhe nenin 121, pika 1 germa b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

#### **12.1. Rekomandimi:**

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet, nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të paregjistruar në QKB.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, duhet të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

**Menjëherë**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi aktivitetin e agjentëve tatimorë për të ardhurat që arkëtohen dhe kalojnë në Bashkinë Këlcyrë, u konstatua se nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore, midis Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë dhe Agjentëve Tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja Dega Gjirokastër, nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji (brenda datës 5 të çdo muaji), për llogari të Bashkisë Këlcyrë nisur nga fakti se, në vitet 2018 dhe 2019 nuk ka asnjë arkëtim. Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, në lidhje me Tatim Fitimin e Thjeshtuar, nuk janë mbajtur rregullisht në fund të çdo muaji dhe nuk ka informacion sa subjekte duhet të paguajnë dhe sa jo, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 70 pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

#### **13.1. Rekomandimi:**

- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë, sipas llojit të taksës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë, si dhe të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë.
- Të krijohet baza e të dhënave për subjektet, tarifatat dhe taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera dhe të kryejë rakordimet në fund të çdo muaji, sipas formularit përkatës, të miratuar nga Ministria e Financave.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është evidentuar realizim i ulët i të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana e Bashkisë Këlcyrë, gjë e cila flet për punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve, sjell si pasojë që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018 dhe në buxhetin e vitit 2019, të mbeten pa burim financimi, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin. Konkretisht:

- Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 19,386,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 13,115,000 lekë, ose **68 % me një diferencë në vlerën 6,271,000 lekë.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 20,047,000 lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën 10,290,000 lekë, **ose 51%, me një diferencë në vlerën 9,757,000 lekë.**
- Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër vjen në ulje, ku për vitin 2018, paraqitet në shumën 13,115,000 lekë, ndërsa në vitin 2019 paraqitet në shumën prej 10,290,000 lekë **ose më pak në shumën prej 2,825,000 lekë ose 12% më pak.** Kjo tregon punë pamjaftueshme të administratës së tatimit taksave të Bashkisë Këlcyrë në menaxhimin e të ardhurave si në fazën e planifikimit po ashtu dhe të realizimit të tyre.
- Mos evidentimi dhe regjistrimi i debitorëve realë, nga Zyra e Financës, mos arkëtimi i detyrimeve debitore, gjithashtu ka sjellë mungesë të ardhurash për Bashkinë Këlcyrë.
- Përsa më sipër, faktorët që kanë ndikuar në realizimin e të ardhurave janë:
- Nga të dhënat ka rezultuar se, nuk është mbajtur akt-rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor.
- Gjithashtu dhe në fazën e planifikimit nuk është marrë në konsideratë numri i subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.
- Nga verifikimi rezulton se, nuk është rakorduar (çdo 6-muaj) me Drejtorinë e Tatimeve të Qarkut Gjirokastër, për realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, në cilësinë e agjentit tatimor.
- Të ardhurat nga taksat kombëtare, për vitin 2018, nuk janë planifikuar, kjo tregon për mos njohje të burimeve dhe resurseve që ka Bashkia Këlcyrë, si dhe mos njohja e kuadrit ligjor që rregullon përfitimin e njësive vendore nga këto taksa.
- Taksa e mjeteve të përdorura, është planifikuar sipas të dhënave historike, pra nuk ka një data bazë të saktë, për numrin e mjeteve në përdorim që gjenden në territorin e Bashkisë Këlcyrë.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj.) në Bashkinë Këlcyrë, të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Nga auditimi rezulton se nuk është kryer rakordim me zyrat e gjendjes civile nga ana e Sektorit të Tatimit Taksave Vendore për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë.
- Realizimi i të ardhurave nga arkëtimi i detyrimeve të debitorëve të ndryshëm është në shumën 0 lekë, për të dy vitet objekt auditimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve dhe bashkëpunimin me struktura të tjera si: Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Tatimeve Gjirokastër, Zyrën e Gjendjes Civile, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, etj me qëllim:

- Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllën ose regjistrohën, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
- Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;
- Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Këlcyrë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

#### Menjëherë

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor është miratuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve 1.7-2.5 herë më shumë, se afati fillestar i përfundimit të punimeve, pa patur asnjë argument teknik të besueshëm.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**15.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa, për nxjerrjen e përgjegjësive në rastet e shtyrjes së afatit të zbatimit të kontratave në mënyrë të pa argumentuar teknikisht, si dhe për ndjekjen në kohë të zbatimit të kontratave, në mënyrë që të respektohet afati i përfundimit të punimeve, duke aplikuar penalitete për kontraktorin në rast të shkeljes së afatit, si dhe për vënien e objekteve në kohë në efikasitet të plotë, për arritjen me sukses të impaktit tek qytetarët.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë, nuk administrohej leja e ndërtimit, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 39, “Leja e ndërtimit”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratave me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim Rruga “Sukë Podgoran Fushë”, Rruga “Goricë”, Rruga “Komarak e Vinokash”, Rruga “Gur Fshat Këlcyrë” dhe Rruga “Riban””, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi”, Bashkia Këlcyrë dhe me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”,





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Bashkia Këlcyrë, rezultuan diferenca në volume dhe për pasojë dëm ekonomik, ndërkohë që vlera e kontratave të mbikëqyrjes dhe kolaudimit së punimeve ishin të gjitha 0 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**17.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Këlcyrë të analizohen shkaqet që kanë shkaktuar diferenat në volume gjatë zbatimit të punimeve në këto objekte dhe në rast të neglizhencës së mbikëqyrësve dhe kolaudatorëve, për shkak të dhënies së shërbimit pa kosto, të merren masa që të vlerësohet kostoja e këtyre shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi dhe të bëhet prokurimi i këtyre fondeve, me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve me përgjegjësi të lartë profesionale.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese dhe miratimin e DT, u evidentuan mangësitë e mëposhtme:

- Në "Kriteret e veçanta për kualifikim", përsa i përket numrit të punonjësve dhe stafit teknik, që duhet të disponojë operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës, nga ana e NJP në asnjë prej procedurave, nuk është dhënë asnjë argument, mbi përcaktimin e numrit të nevojshëm të punonjësve dhe të stafit teknik, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2;

- Përsa i përket përmbushjes së kriterit mbi punët e të njëjtës natyrë apo ngjashme të realizuar në sektorin privat, në të gjitha procedurat, është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin Lejen e ndërtimit për objektin e realizuar. Kjo kërkesë, nuk ka të bëjë me qëllimin e përmbushjes së këtij kriteri, nga OE në garë, si dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nenin 26 pika 6 germa b;

- Në procedurat e prokurimit, përsa i përket dokumentimit që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për mjetet e transportit dhe lejet që duhet të disponojnë, nga NJP nuk është përcaktuar qartë dokumentacioni i kërkuar, për përmbushjen e këtij kriteri. Në DT, është kërkuar që të paraqitet "Leje transporti që lëshohet nga njësi vendore", ndërkohë që duhet të cilësonin saktë këtë kërkesë duke kërkuar "Leje transporti për përdorim për të tretë", veprim në kundërshtim me VKM, neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**18.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor (AK), konkretisht Njësia e Prokurimit (NJP) në përcaktimin e kriterëve kualifikuese, duhet të:

- analizojë, argumentojë dhe përcaktojë kriteret e veçanta kualifikuese në përputhje me objektin e kontratës, madhësinë dhe kompleksitetin e saj, të qarta dhe të kuptueshme për operatorët ekonomikë, si dhe për çdo rast, duhet të japë shpjegime në procesverbalin përkatës, që mbahet për këtë qëllim;

- shmangin vendosjen e kërkesave, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk kanë të bëjnë me përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

#### Në vijimësi

**19. Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Këlcyrë, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", konkretisht:

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

- Nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2018, 2019 dhe 2020 edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.
- Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit, ky pozicion rezulton të jetë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune.
- Bashkia Këlcyrë, nuk ka miratuar në strukturë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, strukturë kjo e rëndësishme për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve, por edhe për mbrojtjen e territorit.
- Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.
- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se përgjithësisht, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës, por ishte mjaftuar vetëm me Urdhrin e emërimit të nxjerrë nga Titullari.
- Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, të hartohet strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Plotësimin e pozicioneve vakante si: Përgjegjës i zyrës së Burimeve Njerëzore dhe pozicionin e Juristit të njësisë, Auditues të brendshëm, Inspektorë të kontrollit të territorit, si pozicione të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit në mënyrë ligjore.
- Ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme.
- Hartimin dhe plotësimin e gjitha dosjeve të punonjësve me kontratën individuale të punës, konform përcaktimeve të “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë”.
- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjës të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

#### Brenda 3 (tre) muajve.

**20. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë, nuk ka një strukturë funksionale të auditit të brendshëm, pavarësisht caktimit në organikë të një pozicioni për auditues. Ky pozicion rezulton vakant për gjithë periudhën e auditimit. Titullari i institucionit, në mungesë të Njesisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka lidhur marrëveshje me njësi tjera publike të cilat kanë njësi auditit të brendshëm, si dhe kapacitete të nevojshme për kryerjen e auditit të brendshëm në sektorin publik, veprime në kundërshtim me ligji nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10 germa (a) dhe (c) dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, neni 6 germa (a).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 9-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**20.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.

#### Menjëherë

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, ka rezultuar se:

- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, ka nxjerrë Urdhrin nr. 75, datë 31.08.2018 “Për ngritjen e komisionit për hartimin e programit të punës dhe zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së” në tejkallim të afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Shkresa përcjellëse e KLSH për dërgim Raporti Përfundimtar Auditimi dhe Rekomandime me nr. 248/10, datë 29.06.2018, është protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 1364, datë 04.07.2018, ç’ ka do të thotë se afati i fundit për dërgimin e përgjigjes mbi programin/planin e masave për zbatimin e rekomandimeve është 25.07.2018. Ky urdhër ka dalë 36 ditë më vonë. Gjithashtu, Grupi i punës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për hartimin e programit për masat që duhet të merren për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë edhe pse me vonesë. Nga Bashkia Këlcyrë, nuk është dërguar në KLSH, programi (plan veprimi) mbi masat që duhet të ndërmerren nga subjekti, mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (j);
- Mbi zbatimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH, nga auditimi rezultoi se, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 248/10, datë 29.06.2018, i ka dërguar Bashkisë Këlcyrë, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Shkresën përcjellëse me rekomandimet e lëna. Bashkia Këlcyrë, duhet të raportojë me shkrim mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 6-muajsh, nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Bashkia Këlcyrë nuk e ka zbatuar këtë detyrim ligjor, pasi nuk ka raportuar me shkrim në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”;
- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë, nuk ka bërë raportime në Këshillin Bashkiak, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditit i jashtëm (KLSH), referuar kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**21.1. Rekomandim:** Nga ana e Këshillit Bashkiak të analizohet gjendja e konstatuar në këtë auditim, të nxirren përgjegjësitë si dhe t'i kërkohej Kryetarit të Bashkisë, që të raportojë rregullisht, mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

**Menjëherë e vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, ka rezultuar se:

- Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 14 “Masa organizative”, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 4 masa; janë zbatuar pjesërisht 4 masa; është në proces zbatimi 1 masë dhe **nuk janë zbatuar 5 masa.**
- Në auditimin e mëparshëm, janë rekomanduar 11 masa shpërblim dëmi, në vlerën 38,657,994 lekë, të pranuar dhe për të cilat kanë dalë njoftimet nga Titullari. Nga auditimi rezultoi se, **nuk janë kontabilizuar dhe nuk është arkëtuar asnjë vlerë.** Nga Bashkia Këlcyrë, nuk është paraqitur asnjë argumentim ligjor, për mos arkëtimin e dëmit, si dhe nga subjektet dhe punonjësit e atakuar, nuk është kryer ankimim në Gjykatën Administrative, për kundërshtim të shpërblimit prej tyre, të dëmit ekonomik të ngarkuar.
- Për shkeljet e konstatuara në auditimin e mëparshëm, janë dhënë masa disiplinore dhe administrative për t'u zbatuar nga strukturat përkatëse të ngarkuara me ligj. Nga auditimi ka rezultuar se nga 6 masa disiplinore, të rekomanduara nga KLSH dhe 2 masa disiplinore, të dhëna nga APP deri më 30.06.2020, janë zbatuar plotësisht 5 masa dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa disiplinore.
- Në auditimin e mëparshëm, KLSH i është drejtuar APP-së, për dhënien e masave administrative për 7 punonjës. Nga APP, ka dalë vendimi nr. 109, datë 16.11.2018, protokolluar në Bashkinë Këlcyrë me nr. 2264, datë 20.11.2018, për vendosjen e gjobave për 9 punonjës dhe masa disiplinore për dy punonjës. Nga auditimi ka rezultuar se janë zbatuar masat disiplinore të dhëna nga APP për dy punonjës, por nuk është zbatuar asnjë prej 9 masave administrative “gjobë” për 9 punonjës. Nga ana e subjektit janë pranuar gjobat e vendosura nga APP, pasi kanë dalë Njoftimet e titullarit për personat përkatës, si dhe nga ana e personave të atakuar, përse i përket gjobave të vendosura nga APP, nuk ka ankimime në Gjykatën Administrative, për rrjedhojë nuk ka asnjë argument ligjor për mos kontabilizim dhe mos arkëtim të tyre në vlerën totale 1,400,000 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 113-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**22.1. Rekomandim:** Këshilli Bashkiak, të marrë në analizë rezultatet e auditimit mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë, pasi për shkak të moszbatimit të tyre, **edhe në auditimin e radhës janë evidentuar shkelje, mangësi, si dhe veprime, në kundërshtim me kriteret e vlerësimit, të cilat janë të përsëritura.** Nga ana e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Këlcyrë, t'i kërkohej Kryetarit të Bashkisë, marrja e masave për shqyrtimin, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e mëparshëm, të cilat rezultojnë të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht, të trajtuara rast pas rasti, në mënyrë të hollësishme në Aneksin nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

## **C.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 98-102; Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 21-33 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 93, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Këlcyrë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 16,342,059 lekë** si më poshtë:

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nga Bashkia Këlcyre dhe Njësitë Administrative, për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, nuk është vepruar në përputhje me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr.170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar kapitulli II, kapitullit III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II pika 1, germa b dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa shtresa dhe ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015”, pasi ka mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Këlcyrë dhe Njësitë Administrative (Dishnice, Sukë dhe Ballaban), **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 11,000,000 lekë.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë, të marrë masa **për arkëtimin e detyrimit prej 11,000,000 lekë**, për 4 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë për tregtimin e karburanteve, kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti D.O., për vlerën prej 2,200,000 lekë.
- Subjekti E SHPK, për vlerën prej 4,400,000 lekë.
- Subjekti DF.P., për vlerën prej 3,300,000 lekë.
- Subjekti A.C. SHPK, për vlerën prej 1,100,000 lekë.

### Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, me vlerë të kontratës (me TVSH) 34,858,247 lekë dhe kontraktor subjektin “J.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,951,600 lekë pa TVSH, në zërat “FV pusëtë plastike 40x40x40, kapak të fortë, çmimi”, “Shtresë asfaltobeton”, “Spërkatje me emulsion bituminoz 1 lt/m<sup>2</sup>”, “Shtresë stabilizanti t=10 cm”, “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=15 cm”, “Pllaka guri 40 x 40 cm ranor dhe gëlqeror për rrugë t=6-10 cm, çmimi”, “Gërmim dheu me krahë, kat IV, çmimi” dhe “Shtresë rëre nën dhe mbi tubacione”. Veprimet e mësipërme janë në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1046, datë 07.05.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “J.” SHPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,951,600 lekë pa TVSH**, nga kontraktori “J.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr. 1046, datë 07.05.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve të lagjes së spitalit”, Bashkia Këlcyrë, vlerë e cila përfaqëson, dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 27,384,647 lekë, me kontraktor “H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,280,596 lekë pa TVSH në zërat e punës “Gërmim kanali tokë e zakonshme” dhe “Beton C16/20 veshje kanal betoni”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1447, datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe kontraktorit “H” SHPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,280,596 lekë pa TVSH** nga kontraktori “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas Kontratës me nr. 1447, datë 01.07.2019, me objekt “Skema ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdimi” Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën për ngritje kantier ndërtimi (investime publike), tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit deri në 5 milionë lekë, tarifë për ngritje kantier ndërtimi tarifë pastrimi për subjektet fituese të investimit mbi 5 milionë lekë, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Njësisive Administrative në vartësi. Nga përlllogaritjet e kryera rezulton se nuk janë aplikuar tarifat për kantier ndërtimi dhe pastrimi për 9 subjekte ndërtimi (sipas Tabelës nr.2.3.10 “Tarifat për subjektet me investime mbi 5 milionë lekë”, faqe 38 Raportit Përfundimtar të Auditimit), në vlerën totale prej 1,615,000 lekë. Vlera prej **1,165,000 lekë**, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave për kantier ndërtimi dhe tarifë pastrimi, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Këlcyrë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **1,165,000 lekë** si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifat e pastrimit për 9 subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë.

**4.2. Rekomandim:** Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, të merren masat, që në çdo rast, subjektet përpara nisjes efektive të veprimtarisë, sipas vendndodhjes të objektit të kontratës, të kryejnë aplikimin për regjistrimin e hapjes së vendit të ushtrimit të veprimtarisë.

**Menjëherë**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban, Bashkia Këlcyrë, me vlerë të kontratës (me TVSH) 36,353,317 lekë, me kontraktor “H” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 591,263 lekë pa TVSH në zërat e punës “Strukturë monolite betoni C 16/20 për koka pusete”, “Strukturë monolite betoni C 12/15 me zgarë metalike 6 mm”, “Shtresë çakulli 15 cm” dhe “Shtresë çakulli mbeturinë kave t=10 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1304, datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë dhe OE “H” SHPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Këlcyrë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **591,263 lekë pa TVSH** nga kontraktori “H” SHPK, në cilësinë e sipërmarrjes në kontratën me nr. 1304, datë 10.06.2019, me objekt “Sistemim asfaltim rruga Sukë Podgoran Fushë, Rruga Goricë, Rruga Komarak e Vinokash, Rruga Gur Fshat Këlcyrë, Rruga Riban”, Bashkia Këlcyrë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përlllogaritjen e vlerës limit të kontratave, rezultoi se vlera limit e kontratës, për procedurën me objekt “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë” është përlllogaritur 803,300 lekë më shumë. Kjo për shkak se nga preventivuesi dhe Grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, i përcaktuar me Urdhrin datë 24.05.2019 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nuk është zbatuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime pika 3.1, për zërin e punimeve 2.197 “Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese katrama”. Për këtë zë punimesh sipas Manualit nr. 2, çmimi është 1,232 lekë/njësi, ndërsa nga preventivuesi dhe Grupi i punës është përlllogaritur 12,312 lekë/m<sup>2</sup>, pra 11,080 lekë/m<sup>2</sup> më shumë. Diferenca për gjithë sasinë është 803,300 lekë (72.5 m<sup>2</sup> \* 11,080 lekë/m<sup>2</sup>=803,300 lekë). Nga auditimi i procedurës ka rezultuar se diferenca midis ofertës fituese dhe vlerës limit të kontratës është 449,700 lekë. Sa më sipër, diferenca në shumën 353,600 lekë midis vlerës së fondit limit të përlllogaritur më tepër dhe diferencës së ofertës fituese kundrejt vlerës limit të kontratës, konsiderohet dëm ekonomik (803,300-449,700=353,600 lekë) dhe duhet të shpërblehet nga shkaktarët e këtij dëmi, Grupi i punës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK), të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **353,600 lekë**, nga z. SV dhe BI, si personat përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, referuar Urdhrit të Titullarit të AK, datë 24.05.2019 “Komisioni i ngarkuar për përlllogaritjen e fondit limit”.

**Menjëherë**

## C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2019, detyrimet ndaj Bashkisë Këlcyrë, janë në vlerën gjithsej **60,386,981** lekë. Kjo gjendje debitoare është krijuar nga **220** subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për vlerën



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

**22,853,022** lekë, (e pa kontabilizuar), dhe **3,360** familje për detyrime të pa përlllogaritura për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **37,533,959** lekë. Nga krahasimi i të dhënave midis vlerës së detyrimeve të pashlyera sipas të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave Vendore, me vlerën që paraqet Sektori i Financës në pasqyrat financiare, (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”) nuk paraqet vlerën reale të detyrimeve. Sipas bilancit të vitit 2018, detyrimet janë në shumën 6,078,000 lekë, e pandryshuar edhe në bilancin e vitit 2019, dhe sipas përlllogaritjeve të bëra nga Grupi i Auditimit referuar të dhënave të marra nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, gjendja reale e debitorëve është në vlerën prej 60,386,981 lekë, pra konstatohet një diferencë e dukshme në vlerën prej **54,308,981 lekë, vlerë kjo e cila është e pa kontabilizuar.**

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për 48 bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

-Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 220 subjekte debitorë (fizik/juridik) në vlerën **22,853,022 lekë**, janë aktiv 172 subjekte ose 78% e totalit të debitorëve të evidentuar, të cilët nuk kanë paguar taksë dhe tarifa.

Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Këlcyrë, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe **asnjë procedurë tjetër**, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezultoi e dështuar, sidomos për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë të marrë masat për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, **për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 220 subjekte për vlerën 22,853,022 lekë dhe 3,360 familje për vlerën gjithsej 37,533,959 lekë**, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare;
- T'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se, **në 6 procedura**, sipas Tabelës anekse nr. 4.5 “Efektet financiare”, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në kundërshtim me aktet rregullative, është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet, **në shumën 23,967,868 lekë**. Efektet negative, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të Operatorëve Ekonomikë (OE) të shpallur fitues, në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

procedure prokurimi” nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. OE, janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DT, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i AK, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kontratës, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT. Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar paligjshme në prokurimin e fondeve publike, me pasojë përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1. Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e “Kriterëve të veçanta për kualifikim”, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të vendosura në DT.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatohet se ka mospërputhje të theksuar midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar, sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në Bashki, për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për dy vitet 2018 dhe 2019, është në shumën 4,950,000 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 1,417,000 lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, planifikimi për vitet 2018 dhe 2019, duhej të ishte në shumën 10,854,000 lekë dhe për vitin 2020 duhej të ishte në shumën 5,904,500 lekë. Sa më sipër, rezulton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, është planifikuar më pak e ardhura nga këto taksa e tarifa për vlerën 9,914,750 lekë, në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 12-39 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **9,914,750 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë.

**Menjëherë**

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

**D.1.** Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruara në dokumentet e auditimit (Aktkonstatime, Projektraport Auditimi dhe Raport Përfundimtar Auditimi), mbështetur në nenet 13 “Agjencia e Prokurimit Publik” dhe 72 “Kundërvajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

administrative” dhe bazuar në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 punonjës si më poshtë:

**1. Z. AQ:** Për shkeljet e konstatuara në 9 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”, konkretisht:

- Në vitin 2018, “Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit” me vlerë limit të kontratës në shumën 13,907,037 lekë, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së; “Rikonstruksion Ura në qendër të Qytetit Këlcyrë” me vlerë limit të kontratës në shumën 4,166,666 lekë, në cilësinë e anëtarit të KVO-së; “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme Këlcyrë”, me vlerë limit të kontratës në shumën 47,767,144 lekë, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së; “Sistemim asfaltim Rruga Sukë-Goricë, Podgorie, Fushë, Komarak, Vinok” me vlerë limit të kontratës në shumën 37,211,972 lekë, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së, si dhe në 2 procedura prokurimi, të zhvilluara në vitin 2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit”, me vlerë limit të kontratës në shumën 29,653,301 lekë, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së dhe në procedurën e prokurimit me objekt “Skema ujitëse Ballaban Ujitja e fushës Ballaban”, me vlerë limit të kontratës në shumën 23,308,514 lekë, në cilësinë e Kryetarit të KVO-së.
- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së për tre procedura prokurimi me objekt “Blerje karburant për automjete”, të zhvilluara në vitin 2018, me vlerë limit të kontratës në shumën 8,839,562 lekë; në vitin 2019 me vlerë limit të kontratës në shumën 8,716,586 lekë dhe në vitin 2020, me vlerë limit të kontratës në shumën 6,323,189 lekë.

**2. Znj. RH,** në cilësinë e anëtares së KVO-së, në 9 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”, konkretisht:

- Në vitin 2018, me objekt “Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit” me vlerë limit të kontratës në shumën 13,907,037 lekë; “Rikonstruksion Ura në qendër të Qytetit Këlcyrë” me vlerë limit të kontratës në shumën 4,166,666 lekë; “Rikonstruksion i shkollës së Mesme Këlcyrë”, me vlerë limit të kontratës në shumën 47,767,144 lekë; “Sistemim asfaltim Rruga Sukë-Goricë, Podgorie, Fushë, Komarak, Vinok” me vlerë limit të kontratës në shumën 37,211,972 lekë, si dhe në 2 procedura prokurimi, të zhvilluara në vitin 2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit”, me vlerë limit të kontratës në shumën 29,653,301 lekë dhe “Skema ujitëse Ballaban Ujitja e fushës Ballaban”, me vlerë limit të kontratës në shumën 23,308,514 lekë.
- Për tre procedura prokurimi me objekt “Blerje karburant për automjete”, të zhvilluara në vitin 2018, me vlerë limit të kontratës në shumën 8,839,562 lekë, në cilësinë e anëtares së KVO-së; vitin 2019 me vlerë limit të kontratës në shumën 8,716,586 lekë, në cilësinë e anëtares së KVO-së dhe në vitin 2020, me vlerë limit të kontratës në shumën 6,323,189 lekë, në cilësinë e Kryetares së KVO-së.

**3. Z. E.L.,** në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në 6 procedura prokurimi me objekt “Punë publike”, dhe “Blerje mallrash”, konkretisht:

- Në vitin 2018, me objekt “Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit” me vlerë limit të kontratës në shumën 13,907,037 lekë; “Rikonstruksion i shkollës së Mesme Këlcyrë”, me vlerë limit të kontratës në shumën 47,767,144 lekë; “Sistemim asfaltim Rruga Sukë-Goricë, Podgorie, Fushë, Komarak, Vinok” me vlerë limit të kontratës



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

në shumën 37,211,972 lekë, si dhe në 2 procedura prokurimi, të zhvilluara në vitin 2019 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të Lagjes së Spitalit”, me vlerë limit të kontratës në shumën 29,653,301 lekë dhe “Skema ujitëse Ballaban Ujitja e fushës Ballaban”, me vlerë limit të kontratës në shumën 23,308,514 lekë.

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në procedurën e prokurimit të zhvilluar në vitin 2019 me objekt “Blerje karburant për automjete”, me vlerë limit të kontratës në shumën 8,716,586 lekë.

#### Shkeljet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konsistojnë:

1. Në 6 procedura me vlerë totale të fondit limit në shumën 156,014,634 lekë, si rezultat i vlerësimit të ofertave nga KVO, në kundërshtim me aktet rregullative është shkaktuar përdorim i fondeve pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet, në shumën 23,967,868 lekë.

Efektet financiare negative, sipas Tabelës anekse nr. 4.5 “Efektet financiare negative”, janë shkaktuar si rezultat i kualifikimit të OE të shpallur fitues, në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku cilësohet: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese”* dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, ku cilësohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e neni 54 të këtij ligji”*.

Diferenca midis OE me ofertën më të ulët dhe OE të shpallur fitues, në kushtet kur asnjë prej tyre nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, është konsideruar efekt negativ, përdorim pa efektivitet ekonomikitet dhe efikasitet i fondeve publike, si rezultat i veprimeve jo ligjore të KVO-së.

2. Për gjykime dhe vlerësim të OE me dy standarde, ku për të njëjtin dokumentacion të paraqitur nga OE të ndryshëm, për plotësimin e të njëjtave kërkesave për përmbushjen e kriterëve kualifikuese nga ana e KVO-së janë mbajtur qëndrime të ndryshme, duke kualifikuar apo shkualifikuar OE. Kështu, në 5 raste, të trajtuara hollësisht në faqet 94-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbi vlerësimin e kërkesave për përmbushjen e “Kritereve të veçanta për kualifikim” dokumentacioni i paraqitur dhe hedhur në SPE, për disa OE nga ana e KVO-së, është konsideruar i pasaktë, i paplotë duke i evidentuar si shkaqe të s’kualifikimit të tyre, ndërsa për disa OE, nuk janë evidentuar dhe nuk janë konsideruar si të tillë, duke sjellë kualifikim të tyre, pa plotësuar kriteret e përcaktuara në DT.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**D.2.** Shkeljet e konstatuara në hartimin e Projekt Buxheteve Afatmesme (PBA) dhe buxheteve vjetore, mangësitë e theksuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në mosfunksionimin e njësisë së auditit të brendshëm, mungesën e procedurave për mirë administrimin e aseteve, për periudhën objekt auditimi, përbëjnë shkelje nga ana e Z. K.N., në cilësinë e Titullarit të Njësisë Publike, Bashkia Këlcyre, referuar ligjit nr. 10296,



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”

datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime, Kreu II “Përgjegjshmëria menaxheriale”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 1. Sa më sipër, bazuar në Kreu V “Dispozita të fundit dhe kalimtare”, neni 29 “Kundërvajtjet administrative” dhe në nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Nëpunësit të Parë Autorizues**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me këto shkelje.

#### **E. MASA DISIPLINORE**

**Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta.**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 “Masa disiplinore” të Kodit të punës në Republikën e Shqipërisë, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, që të vlerësojë shkeljet dhe masën disiplinore për punonjësit si më poshtë:

- 1. Znj. V.K.**, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe Buxhetit, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për shkeljet e konstatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin financiar për vitet 2018 dhe 2019.
- 2. Znj. RH**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në mos evidentimin e subjekteve taksapaguese (fizike/juridike); mos planifikim real të të ardhurave; mos menaxhim të duhur dhe efikas të këtij sektori në drejtim të vjeljes së të ardhurave, ndjekjes së debitorëve, etj.
- 3. Z. H.Sh., Z. B.a, Z. V.K dhe Znj. L.P.**, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Blerjeve të Vogla, për shkelje të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP-së nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Për sa më sipër është hartuar ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

#### **Lista e shkurtimeve:**

- Kontrolli i Lartë i Shetit	<b>KLSH</b>
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë	<b>MFE</b>
- Agjencia e Prokurimeve Publike	<b>APP</b>
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës	<b>ASHK</b>
- Vendim i Këshillit të Ministrave	<b>VKM</b>
- Udhëzim i Ministrit të Financave	<b>UMF</b>
- Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	<b>SHPK</b>
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit	<b>SKK</b>
- International Standards Supreme Audit Institution	<b>ISSAI</b>
- Projekt Buxheti Afatmesëm	<b>PBA</b>
- Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	<b>MFK</b>



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **Raport Përfundimtar Auditimi mbi Auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë me objekt “Auditim financiar dhe Përputhshmërie”**

- |                                      |               |
|--------------------------------------|---------------|
| - Komisioni i Vlerësimit të Ofertave | <b>KVO</b>    |
| - Njësia e Prokurimit                | <b>NJP</b>    |
| - Operatorë Ekonomikë                | <b>OE</b>     |
| - Autoriteti Kontraktor              | <b>AK</b>     |
| - Projektraport Auditimi             | <b>PRA</b>    |
| - Raport Përfundimtar Auditimi       | <b>RPA</b>    |
| - Tatim mbi Vlerën e Shtuar          | <b>TVSH</b>   |
| - Grupi i Menaxhimit Strategjik      | <b>GMS</b>    |
| - Aktivitet Afatgjatë Jo Materiale   | <b>AAGJJM</b> |
| - Aktivitet Afatgjatë Materiale      | <b>AAGJM</b>  |